



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

RAPORT
I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2018

Prill 2019

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zonja e zotërinj Deputetë,

Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit paraqitet në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni 148/b shkronja “d” i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104 i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në vend gjatë vitit 2018 dhe objektivat për vitin 2019.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit Evropian, prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit dhe strategjinë afatmesme të prokurorisë 2018-2020.

Për të garantuar sukses në luftën e përbashkët kundër krimit, ka ende shumë për të bërë dhe për këtë nevojitet bashkëpunimi ndër-institucional i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale dhe i strukturave shtetërore, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe integritetit në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë.

Duke ju siguruar se organi i prokurorisë do të vijojë luftën efektive kundër kriminalitetit, ju paraqesim Raportin për Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2018:

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit	6
Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve të Komisionit European.....	6
Zbatimi i Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018”.....	27
Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq.....	33
 II. Analiza e treguesve të kriminalitetit.....	36
2.1 Volumi i punës në hetim	36
2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....	37
2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë në pesë vitet e fundit	38
2.4. Procedime penale të regjistruara sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë	47
2.5. Koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë bazuar në sistemin statistikor të prokurorisë.....	50
2.6. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....	51
2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	52
2.8 Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal.....	53
2.9 Analiza e veprave penale sipas strukturës së kodit penal.....	59
Krime kundër njerëzimit.....	59
Krime kundër jetës të kryera me dashje.....	59
Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi.....	69
Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje.....	70
Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia.....	75
Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës.....	76
Krime seksuale.....	79
Vepra penale kundër lirisë së personit.....	85
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.....	89
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.....	95
Vepra penale kundër lirisë së besimit.....	100
Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.....	101
Mashtrimet.....	111
Shkatërrimi i pronës.....	117
Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.....	126
Vepra penale në veprimtarite bankare dhe financiare.....	129
Krime në fushën e doganave.....	131
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet.....	138
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë.....	142

Falsifikimi i dokumenteve.....	146
Vepra penale në fushën e falimentimit.....	151
Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit.....	151
Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës.....	155
Vepra penale kundër mjedisit.....	159
Krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera.....	163
Vepra me qëllime terroriste.....	165
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur, organizata kriminale.....	166
Krime kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.....	168
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik.....	174
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.....	180
Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave.....	196
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë.....	201
Vepra penale kundër drejtësisë.....	208
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.....	215
Veprat penale të korrupsionit.....	216
Krimi kibernetik.....	225
Trafiqet e paligjshme.....	229
Veprat penale që lidhen me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve.....	235
2.10 Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave penale.....	241
2.11 Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite.....	243
2.12 Të dhëna për të pandehurit	250
III. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....	262
3.1 Ekstradimet.....	263
3.2 Letërporositë.....	268
3.3 Njohjet e vendimeve penale.....	272
3.4 Transferimet e procedimeve penale.....	274
3.5 Transferimet e personave të dënuar.....	275
3.6 Urdhrat e arrestit ndërkombëtar.....	276
3.7 Skuadrat e Përbashkëta Hetimore.....	277
IV Garantimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike	279
V. Ngarkesa e punës së prokurorive për vitin 2018.....	282

VI. Përmbledhje e analizës financiare.....	301
VII. Prioritetet në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019.....	305

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018

Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Prokuroria përbëhet nga¹:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm (95/2016);
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- ç) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve.

Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2018 në luftën kundër kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë në mënyrë të sintetike, kanë qenë²:

I. Prioritetet, rekomandimet dhe aktiviteti

1. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian

Prokuroria e Përgjithshme me administrimin e Rezolutës së Kuvendit datë 20.09.2018 dhe në përmbushje të detyrimit të parashikuar në lidhjen 3 pika 5 të Vendimit të Kuvendit nr.49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, përcolli Rezolutën pranë gjithë prokurorive dhe ndërmori masat e nevojshme për hartimin e Planit të Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së datës 20.09.2018 “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2017”. Plani i veprimit, u është përcjellë gjithë prokurorive me detyrimin për të implementuar masat e parashikuara në planin e veprimit, masa këto, të nxjerra në përputhje me Rezolutën dhe duke detajuar rekomandimet e saj. Në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës, konstatohet se gjithë strukturat përgjegjëse të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, kanë raportuar për masat e marra në zbatimin e tyre.

¹ Bashkëlidhur struktura dhe organika e prokurorisë, miratuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.22, datë 07.2.2019 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme”.

² Renditur sipas kërkesave të Rezolutës së Kuvendit datë 20.09.2018

i) Në zbatim të rekomandimit “*Rritja e numrit të hetimeve në tërësi dhe në veçanti hetimeve proaktive kundër krimit të organizuar, korrupsionit në nivel zyrtarësh të lartë dhe të mesëm, funksionarëve të sistemit të drejtësisë, të zgjedhurve në nivel qendror dhe vendor*”, gjatë vitit 2018, janë arritur rezultatet si më poshtë:

Lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të tjera të rënda

Lufta ndaj krimit ekonomik e financiar, pastrimit të parave, terrorizimit, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ka qenë dhe mbetet prioritet i punës tonë në bashkëpunim me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit veçanërisht për identifikimin, hetimin dhe goditjen e rrjeteve kriminale që qëndrojnë pas tyre. Për këto arsye, në strategjinë e saj afatmesme 2018-2020, prokuroria ka përcaktuar si objektiv forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional me autoritetet vendase dhe të huaja, si në nivel operacional ashtu dhe nëpërmjet përgjigjes në kohë e me efikasitet letërkërkesave të autoriteteve të huaja.

Në muajin shkurt 2018, ashtu siç ju është bërë e ditur, u nënshkrua një marrëveshje ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, anëtarëve të grupeve të strukturuar kriminale, aseteve dhe të ardhurave të tyre të paligjshme, si dhe rritjen e efektivitetit në hetimet penale dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve. Në zbatim të kësaj marrëveshje, Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr.1 datë 20.02.2018, “Për krijimin e seksioneve të posaçme” në prokurorinë për krime të rënda dhe në 9 (nëntë) prokurori të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në këtë kuadër, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë kanë zhvilluar takime e analiza me institucionet ligjzbatuese, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë hetimore dhe arritjen e rezultateve sa më të larta në luftën e përbashkët kundër kriminalitetit. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese ka ndikuar në rritjen e numrit të referimeve të kallëzimeve për vepra penale në vitin 2018³ dhe në shkëmbimin e shpejtë të informacionit në kuadrin e hetimeve proaktive me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit.

Sa i përket rritjes së numrit të hetimeve proaktive, gjatë vitit 2018 janë kryer hetime duke përdorur teknikat speciale të hetimit, në kuadrin e 64 procedimeve për veprat penale në fushën e trafikeve të paligjshme, pastrimit të parave apo krimeve të tjera të rënda. Prokurorët kanë pasur rol aktiv, si në regjistrimin e procedimeve, dhënien e autorizimeve ose mbi kërkesën e tyre me vendime gjyqësore është autorizuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes të zbatimit të tyre. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose

³ Gjatë vitit 2018 rezulton të jenë regjistruar në prokurori 46892 kallëzime e referime për vepra penale, ose me rritje 0,64 % krahasuar me vitin 2017.

ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 122 personave të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale.

Sa i përket treguesve statistikorë, për vitin 2018, rezulton se janë regjistruar 41 procedime për veprën penale që parashikon nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”, ndërkohë 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me rritje rreth 2,5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale.

Lidhur me trafikun e qenieve njerëzore, në vitin 2018 për veprën penale “Trafikimi i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal janë regjistruar 17 procedime penale, ndërkohë 1 procedim është dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2017 me ulje prej 29 % të numrit të procedimeve të regjistruara. Ndërsa, për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, janë regjistruar 5 procedime penale, ndërkohë 1 procedim penal është dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 16 % e numrit të procedimeve të regjistruara.

Sa i përket “Trafikimit të armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, në vitin 2018 janë regjistruar 11 procedime penale, ndërkohë 3 procedime janë dërguar për gjykim ose krahasuar në vitin 2017 me rritje rreth 2 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale.

Lidhur me hetimet për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të përvetësimit të parave që rrjedhin nga veprimtaria kriminale të parashikuara nga nenet 287, 287/a e 287/b të Kodit Penal, në vitin 2018 janë regjistruar gjithsej 269 procedime penale, ndërkohë janë dërguar për gjykim 23 procedime penale. Ndërsa, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, janë regjistruar 257 procedime, ndërkohë 17 procedime janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2017 me ulje prej 16 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër.

Në lidhje me luftën kundër terrorizmit të dhënat statistikore të vitit 2018, për veprën penale “Financimi i terrorizmit” të parashikuar nga neni 230/a i Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 33 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër.

Lufta kundër korrupsionit

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga Rezoluta, në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017 për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, kemi rritje të numrit të procedimeve të regjistruara, ndërsa për veprat e tjera penale në këtë fushë ka ulje të numrit të procedimeve. Sipas të dhënave statistikore evidentohet se ka një ulje prej 37 %

të numrit në total të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, dhe rritje prej 63,83 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje prej 10,71 % e numrit të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 dhe një rritje prej 20,83 % e numrit të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë. Në uljen e këtij numri të procedimeve të regjistruara, çmojmë se kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e reformës ligjore dhe institucionale, ashtu dhe efektet parandaluese nga goditja dhe rritja e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë për këtë grup veprash penale në fushën e korrupsionit.

Numrin më të lartë në procedimet e regjistruara për veprat penale të korrupsionit për vitin 2018 e zë vepra penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, e konkretisht në masën 43 % të tyre, ndërsa për vitin 2017 kjo vepër përbënte 22 % të totalit të procedimeve për korrupsion. Procedimet e regjistruara për këtë vepër janë rritur nga 61 procedime në vitin 2017, në 74 procedime në vitin 2018 ose me rritje 21 % të procedimeve të regjistruara.

Në lidhje me korrupsionin në sistemin e drejtësisë gjatë vitit 2018, janë regjistruar 3 procedime penale për nenin 319 të Kodit Penal dhe 29 procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, ndërsa 2 procedime për këtë vepër janë dërguar për gjykim. Ndërsa në vitin 2017 për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka regjistruar 1 procedim penal dhe për veprën penale të parashikuar ne nenin 319/ç të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka regjistruar 14 procedime penale, ndërkohë 1 çështje penale është dërguar në gjykatë.

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga Rezoluta, lidhur me rritjen e hetimeve proaktive për veprat penale kundër korrupsionit, gjatë vitit 2018 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të teknikave të posaçme të hetimit në kuadrin e 93 procedimeve penale, ndërkohë 30 procedime i përkasin prokurorisë për krime të rënda dhe 63 procedime i përkasin prokurorive të tjera ose krahasuar me vitin 2017 me shifra në rritje 14,4 %. Kjo veprimtari ka shërbyer në ndalimin e 73 personave (të arrestuar në flagrancë apo ndaluar) si të dyshuar për përfshirjen në kryerjen e veprave penale, të korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës, ndërkohë 14 persona/autorë të dyshuar i përkasin kompetencës të prokurorisë për krime të rënda dhe 59 persona/autorë të dyshuar, në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Ndërkohë, janë filluar kryesisht nga prokuroria 21 çështje për vepra që lidhen me abuzimin me funksionin publik, ku peshën kryesore e përbëjnë procedimet që lidhen me shpërdorimin e detyrës, për të cilën janë filluar kryesisht 8 çështje, korrupsioni pasiv i funksionarëve të sistemit të drejtësisë për të cilët janë filluar kryesisht 5 çështje dhe korrupsioni pasiv i

personave që ushtrojnë funksione publike, për të cilët janë filluar kryesisht nga prokurori 4 çështje.

Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutës për këtë tregues, e konsiderojmë të zbatuar detyrimin për faktin se në uljen në tërësi të numrit të procedimeve të regjistruara për këto grup veprash, çmojmë se kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e reformës ligjore dhe institucionale, ashtu dhe efektet parandaluese nga goditja dhe rritja e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë për këtë grup veprash penale.

Me gjithë arritjet, referuar raporteve ndërkombëtare për këtë grup veprash penale në Shqipëri në vitin 2018, në vështrimin institucional të prokurorisë kërkohet dhe synohet forcimi dhe rritja e mëtejshme e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për thellimin dhe intensifikimin e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimeve në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë, si të krimit të organizuar dhe ekonomik brenda vendit dhe lidhjeve të tij jashtë vendit, ashtu dhe të korrupsionit në nivele qendrore e vendore dhe lidhjeve të tij me krimin, duke sekuestruar pasuritë dhe produktet e veprimtarisë kriminale të tyre.

ii) Në lidhje me rekomandimin, “*Rritja e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi të narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike*”, rezultatet e vitit 2018 përmbledhen si vijon:

Lufta kundër narkotikëve

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga Rezoluta për rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e narkotikëve, gjatë vitit 2018 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të teknikave të posaçme të hetimit në kuadrin e 250 procedimeve penale, ndërkohë 104 procedime i përkasin prokurorisë për krime të rënda dhe 146 procedime i përkasin prokurorive të tjera. Kjo veprimtari ka shërbyer në parandalimin e 275 personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar si të dyshuar për përfshirjen në kryerjen e veprave penale në fushën e narkotikëve, ndërkohë 151 persona/autor të dyshuar i përkasin kompetencës të prokurorisë për krime të rënda dhe 124 persona/autor të dyshuar në kompetencë të prokurorive pranë gjykatëve të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Të dhënat statistikore lidhur me veprat penale në fushën e narkotikëve në vitin 2018 tregojnë se, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal janë regjistruar 1127 procedime, ndërkohë 447 procedime janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 5,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal janë regjistruar 292 procedime penale, ndërkohë 46 procedime janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 22 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

Lidhur me veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në vitin 2018, janë regjistruar 105 procedime penale, ndërkohë janë dërguar në gjykatë 39 procedime ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 46 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër.

Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutës për këtë tregues, e konsiderojmë të zbatuar detyrimin për faktin se në uljen në tërësi të numrit të procedimeve të regjistruara për këto grup veprash, kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel qendror dhe vendor në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, ashtu dhe efektet parandaluese, si nga sekuestrimi i sasive të konsiderueshme të drogës së kultivuar dhe të kapur gjatë vitit 2018, ashtu dhe goditja e vazhdueshme e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

Me gjithë arritjet, referuar raporteve ndërkomtare për këtë grup veprash penale në Shqipëri në vitin 2018 në vështirimin institucional të prokurorisë kërkohet dhe synohet rritja e mëtejshme e bashkëpunimit ndërinstytucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për intensifikimin e hetimeve proaktive dhe përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimeve në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë, si të grupeve kriminale që udhëheqin kultivimin e kanabisit dhe tranzitimin e kokainës dhe heroinës brenda vendit dhe lidhjeve të tyre jashtë vendit, ashtu dhe sekuestrimin e konfiskimin e pasurive dhe produkteve të veprimtarisë kriminale të tyre.

iii) Në lidhje me rekomandimin, “*Rritja e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë kriminale e organizuar, sipas ligjit antimafia*”, rezultatet e vitit 2018 përmbledhen si vijon:

Hetimet pasurore

Në përmbushje të objektivave të saj strategjike, Rezolutës së Kuvendit, rekomandimeve të Komisionit Evropian, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për kryerjen e hetimeve pasurore sistematike, në datë 20.11.2018, Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr.6/2018, “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, me synim unifikimin e zbatimit të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” ndaj personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin, korrupsionin, pastrimin e produkteve të veprës penale etj, si dhe për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.

Sa i përket zbatimit të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë*”, i ndryshuar, për vitin 2018, janë trajtuar 774⁴ raste të hetimit pasuror nga të cilët, për 13 referime pasurore është vendosur mosfillimi, ndërsa pjesa tjetër e materialeve pasurore janë mbartur për vitin 2019.

Për vitin 2018, rezultojnë se janë pranuar nga gjykata 7 kërkesa për sekuestrim dhe 4 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara. Pasuritë objekt i këtyre vendimeve janë apartamente, troje, automjete me vlera të konsiderueshme. Kryesisht, veprat penale që ka shërbyer si indicie për hetimin pasuror kanë qenë ato të pastrimit të parave dhe trafikimit të narkotikëve. Në një rast prokuroria ka kërkuar në gjykatë dhe është pranuar kërkesa për sekuestrimin e pasurisë së një subjekti të dënuar në shkallë të parë për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 6/2018 më sipër, seksionet e ngritura për hetimin e Krimin Ekonomik, Financiar e Kibernetik dhe Seksionet e Posaçëm në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale⁵ kanë kërkuar dhe nga gjykatat është vendosur sekuestro preventive të sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale dhe/ose të produkteve të veprës penale.

Sa i përket kryerjes së hetimeve sistematike pasurore dhe rritjes së numrit të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara, është e rëndësishme të theksohet se në të gjitha rastet e hetimit penal të korrupsionit, hetimi financiar kryhet në mënyrë paralele dhe të detyrueshme. Në vitin 2018, në një rast, është vendosur sekuestrimi sipas ligjit antimafia mbi pasuritë e një subjekti të dënuar në shkallë të parë për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

Në kuadër të zbatimit të Rezolutës për këtë tregues, konstatohet zbatimi pjesërisht i detyrimit të rekomanduar, për faktin se bashkëpunimi ndërinstitutional me agjencitë e përfshira në zbatimin e ligjit antimafia nuk ka qenë në nivelin e duhur sa i përket cilësisë së referimeve, ashtu dhe pamjaftueshmërisë së kapaciteteve për kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve për zbulimin, identifikimin dhe sekuestrimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria e krimin të organizuar me qëllim konfiskimin e tyre.

Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutës, referuar edhe raporteve ndërkombëtare për Shqipërinë në vitin 2018 kërkohet dhe synohet rritja e cilësisë dhe efektivitetit në bashkëpunimin ndërinstitutional me agjencitë e përfshira në zbatimin e ligjit antimafia, si në funksion të rritjes cilësore të referimeve në prokurori, ashtu

⁴ Në këtë shifër përfshihen edhe materialet e mbartura nga vitet e tjera.

⁵ Shih, nenet 274-276 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me nenin 36 e vijues të Kodit Penal.

dhe për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve për zbulimin, identifikimin dhe sekuestrimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria e krimit të organizuar dhe korrupsioni me qëllim konfiskimin e tyre

iv) Lidhur me rekomandimin, *“Garantimi i ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e reja që priten të krijohen, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në procesin e vlerësimit profesional dhe hetimin disiplinor të prokurorëve”*, gjatë vitit 2018 rezultoi se:

Garantimi i ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar

Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve janë angazhuar maksimalisht dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore për të ndihmuar në përshpejtimin e procesit të rivlerësimit profesional të prokurorëve në kuadër të rivlerësimit kalimtar të tyre. Në zbatim të nenit 43 e vijues të ligjit nr.84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* dhe të neneve 160 pika 2 shkronja “d”, 171 pika 4 e vijues të ligjit nr.96/2017 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* në prokuroritë e të gjitha niveleve janë marrë të gjithë masat e nevojshme për të siguruar/garantuar ndihmën për organet e rivlerësimit në përmbushjen e detyrave të tyre në procesin e vlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit.

Në vitin 2018, prokurorët e grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive përkatëse janë angazhuar në procedurën e hedhjes së shorteve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin profesional të 118 prokurorëve e drejtuesve të prokurorive. Kështu, deri në 28 dhjetor 2018 ka përfunduar shorti për vlerësimin profesional për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesit e prokurorive të apeleve dhe drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, Drejtuesit dhe Prokurorët e Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, prokurorët e Prokurorisë për Krime të Rënda, prokurorët e Prokurorive të Apeleve Tiranë, Shkodër, Durrës, Gjirokastrë e Korçë dhe prokurorët e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Kavajë, Kurbin, Tropojë, Pukë, Kukës, Burrel e Dibër, si dhe pjesërisht (shorti) për prokurorët në Prokuroritë e Shkallës së Parë Tiranë, Shkodër, Krujë e Vlorë.

Prokuroritë e të gjitha niveleve, krahas ngarkesës së punës në ushtrimin e funksioneve të tyre, kanë koordinuar me shpejtësi e korrektësi me Grupin e Punës të ngritur në Prokurorinë e Përgjithshme për dërgimin e informacioneve dhe dosjeve për vlerësimin profesional të secilit prokuror, drejtues apo zëvendësdrejtues të shortuar.

Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka dorëzuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit gjithësej 83 raporte të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues të rivlerësimit kalimtar. Në dhjetor 2018 me krijimin dhe konstituimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP) 35 praktika në proces ndjekje me prioritet në grupin e punës të

Prokurorisë së Përgjithshme janë dërguar/transferuar për kompetencë në Këshill për hartimin e raporteve të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues të rivlerësimit kalimtar. Aktualisht, në procesin e rivlerësimit kalimtar kanë kaluar dhe janë konfirmuar në detyrë 19 prokurorë, ndërsa për 21 prokurorë është vendosur shkarkimi nga detyra, prej të cilëve 15 prokurorë janë të pezulluar në pritje të shqyrtimit të ankimit tyre në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA).

Në kuadrin e kësaj veprimtarie të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve/prokurorëve dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.188 datë 04.03.2015 “*Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit*” prokurorët në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë janë angazhuar edhe me kryerjen e verifikimeve të nevojshme për kërkesat e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), duke iu dërguar përgjigje/informacione për subjektet përkatëse.

Në kuadrin e ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë dhe parapërgatitjes së procesit të zgjedhjes së anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr.68, datë 23.02.2018 ngriti grupin e punës për hartimin e projektregullores për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe projekturdhrit për miratimin e fletës tip të votimit në përputhje me ligjin nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”. Këto akte u përgatitën në bashkëpunim me ekspertët e Projektit EURALIUS, për t’ia propozuar për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve.

Në këtë kuadër, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve/ kandidatëve, më datë 11 dhjetor 2018, Prokurori i Përgjithshëm thirri dhe organizoi Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve, e cila miratoi Rregulloren që i shërbeu realizimit të një procesi transparent dhe korrekt votimi për përzgjedhjen e kandidatëve. Në përfundim, Komisioni i Votimit shpalli fitues 6 anëtarët prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zgjedhja e të cilëve mundësoi krijimin e këtij organi/institucioni të rëndësishëm kushtetues të qeverisjes së prokurorëve që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e tyre.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të rekomandimit të Rezolutes më sipër, rezulton se është zbatuar detyrimi i Rezolutës për garantimin e ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke kontribuar për ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me zgjedhjen e anëtarëve nga radhët e prokurorëve.

Në këtë kuadër, shkarkimi nga detyra e rreth 50 % të prokurorëve në procesin e rivlerësimit kalimtar, na obligon institucionalisht që në kuadrin e bashkëpunimit me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës të merren masat e duhura për të planifikuar në kohë zëvendësimin e tyre me magjistratë/prokurorë sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit

organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

v) Lidhur me rekomandimin, “*Forcimi i bashkëpunimit mes prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin efektiv të metodave speciale të hetimit për dokumentimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimeve të rënda*”, gjatë vitit 2018 rezultoi se:

Forcimi i bashkëpunimi ndërinstitucional me policinë gjyqësore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese.

Lufta ndaj krimit ekonomik e financiar, pastrimit të parave, terrorizimit, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, janë tejet parësore dhe për këtë kërkohen masa të koordinuara, veçanërisht për sa i përket identifikimit të rrjeteve kriminale që qëndrojnë pas tyre. Për këto arsye, në strategjinë afatmesme 2018-2020 të miratuar prej saj, Prokuroria ka përcaktuar si objektiv forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me autoritetet vendase dhe të huaja, si në nivel operacional, ashtu dhe nëpërmjet përgjigjes në kohë e në mënyrë efikase lidhur me trajtimin e letërkërkesave të autoriteteve të huaja.

Në këtë kuadër, në muajin shkurt 2018 u nënshkrua një marrëveshje ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Brendshme, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, anëtarëve të grupeve të strukturuar kriminale, aseteve dhe të ardhurave të tyre të paligjshme, si dhe rritjen e efektivitetit në hetimet penale dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, edhe gjatë vitit 2018 ka vijuar bashkëpunimi efektiv i prokurorisë me agjencitë ligjzbatuese në nivel qendror dhe vendor.

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë kanë zhvilluar takime e analiza me institucionet ligjzbatuese, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë hetimore dhe arritjen e rezultateve sa më të larta në luftën e përbashkët kundër kriminalitetit. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese ka ndikuar në rritjen e numrit të referimeve të kallëzimeve për vepra penale në vitin 2018⁶, rritjen e efektshmërisë së hetimeve proaktive me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit, si dhe në shkëmbimin e shpejtë të informacionit me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit.

⁶ Gjatë vitit 2018 rezultoi të jenë regjistruar në prokurori 46892 kallëzime e referime për vepra penale, ose me rritje 0,64 % krahasuar me vitin 2017.

Nga ana tjetër, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, krahas rezultateve kanë raportuar edhe problematika ku mund të veçohen: mungesa e strukturave të specializuara për të kryer vëzhgime, filmime, fotografime dhe përgjime ambientale, numër i ulët i oficerëve të policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe hetimeve pasurore, mungesë e cilësisë së materialeve të referuara, lëvizje të shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore pranë komisariateve dhe drejtorive, referime për disa vepra pa u marrë më parë masa administrative, megjithëse vetë ligji penal e kërkon paraprakisht marrjen e kësaj mase, si dhe referime në prokurori nga policia për grup vepra penale të cilat ndiqen me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë.

Në kuadrin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera gjatë vitit 2018, drejtuesit e prokurorive kanë bashkërenduar me drejtuesit e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave për zbardhjen e fakteve penale në fushën e mjedisit dhe parandalimin e dëmtimeve në mjedis. Në këtë kuadër, të dhënat statistikore në vitin 2018 për grup veprat penale kundër mjedisit, evidentojnë se, ka tregues në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara në masën prej 14,35 % krahasuar me vitin 2017, ashtu dhe është rritur numri i procedimeve të dërguara në gjykatë në masën prej 73,33 % krahasuar me vitin 2017. Gjithashtu, të dhënat lidhur me të pandehurit për këtë grup veprash penale të krahasuara me vitin 2017 evidentojnë tregues në rritje prej 54,64 % e numrit të pandehurve të regjistruar, rritje prej 82 % e numrit të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe rritje rreth 2,3 herë e numrit të pandehurve të dënuar nga gjykata.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutes, e konsiderojmë të zbatuar detyrimin për këtë tregues, për faktin se në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel qendror dhe vendor, përgjithësisht është rritur efektshmëria në zbulimin, goditjen dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në këtë fushë, duke nënvizuar nevojën e përmirësimit, si për rritjen e cilësisë së këtij bashkëpunimi, ashtu dhe rritjen e efektivitetit në bashkëpunimin ndërinstytucional në të ardhmen.

vi) Lidhur me rekomandimet, “*Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë e huaja ligjbatuese, me qëllim luftën ndaj krimit të organizuar dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave; si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave që konstatohen nga Progresraporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA - ve, lidhur me problematikat e krimit të organizuar në Shqipëri... për parandalimin e krimeve kompjuterike që përdoren për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale, si dhe ato për qëllim të financimit të terrorizmit*”, gjatë vitit 2018 rezulton se:

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe bashkëpunimit me agjencitë ligjbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për grupet e strukturuar kriminale, Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr.2 datë 18.06.2018 me

synim për të përmirësuar koordinimin e informacionit dhe ndjekjen e tij në çështjet e ekstradimit për jashtë. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, të dhënat statistikore për periudhën Janar – Dhjetor 2018, evidentojnë se janë trajtuar:

- Ekstradime nga jashtë - 171 subjekte⁷;
- Ekstradime për jashtë - 128 subjekte;
- Letërporositë nga jashtë - 668 letërporosi;
- Letërporositë për jashtë - 782 letërporosi;
- Njohjet e vendimeve penale të huaja - 48 kërkesa;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit - 11 kërkesa;
- Transferimet e procedimeve nga jashtë - 20 raste;
- Transferimet e procedimeve për jashtë - 14 procedime penale;
- Transferimet e personave të dënuar nga jashtë - në 4 raste;
- Transferimet e personave të dënuar për jashtë - 10 raste.

Gjatë vitit 2018 prokuroria, gjithashtu ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 256 subjekte dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 63 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar.

Vlerësojmë të theksojmë se, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, krahas volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, gjatë vitit 2018 ka trajtuar në kohë reale edhe 401 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase dhe ato të huaja.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave nga autoritetet e huaja për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuuese apo për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë, theksojmë se, Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2018 i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda **30 raste**, për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre shtetasve, brenda objektit të nenit 3, pika 1/d (*fusha e zbatimit*) dhe nenin 8/1 (*verifikimet paraprake*) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe krijimit të marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Në datë 28.04.2018 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetit Suedezi të Prokurorisë, ku synohet bashkëpunimi në fushën e drejtësisë penale për të miturit, përfshirë rishikim/zbatim

⁷ Të pandehur ose të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

legjislacioni, mekanizma dhe struktura organizative, forcim i kapaciteteve: trajnim dhe udhëzime.

Në datë 26.09.2018 u nënshkrua në Sofje, Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Republikës së Bullgarisë dhe Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë.

Në maj 2018, Republika e Shqipërisë ka miratuar në parim marrëveshjen e bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it. Nënshkrimi dhe ratifikimin së fundi i kësaj marrëveshjeje, është konsideruar nga Prokuroria si një kontribut i madh në rritjen e efikasitetit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër kriminalitetit.

Veç sa më sipër, gjatë vitit 2018 janë nënshkruar 3 marrëveshje për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, në kuadër të çështjeve penale të regjistruara për veprën penale të *“Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike”*. Objekti i veprimtarisë së skuadrave të përbashkëta hetimore, përfshin kryerjen e veprimeve hetimore në territoret e dy Shteteve Palë të Marrëveshjes, ndër të cilat përmenden:

- Identifikimi i aktiviteteve dhe strukturave të organizatave kriminale;
- Identifikimi i roleve përkatëse të anëtarëve të organizatës, furnizuesve të lëndëve narkotike dhe pritësve të tyre;
- Identifikimi i vendeve të kultivimit dhe depozitimit të lëndëve narkotike si dhe mjetet dhe mënyrat e përgatitjes dhe maskimit/fshehjes;
- Verifikimi i mënyrës së transportit dhe gatishmërisë së mjeteve që përdoren për transportin e tyre;
- Verifikimi i ekzistencës së financuesve eventuale të trafikut të lëndëve narkotike si dhe mënyrat e riinvestimit të të ardhurave të mëdha të siguruara, duke treguar dhe emra përkatës.

Gjithashtu është në proces nënshkrimi një marrëveshje e katërt për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore me Italinë, e cila do të koordinohet nga Eurojust-i. Po kështu, dy nga skuadrat e cituara më lart janë ngritur dhe do të realizojnë aktivitetet e miratuara me mbështetjen e Eurojust-it.

Përveç sa më sipër, me mbështetjen e Misionit EURALIUS në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur grup pune për hartimin e një udhëzimi të përgjithshëm në lidhje bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën e krimit kibernetik.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutes për këto rekomandime, i konsiderojmë të zbatuara detyrimet për faktin se të dhënat dhe angazhimi ynë institucional, evidentojnë rritjen e treguesve të kësaj veprimtarie dhe forcimin e besimit institucional të prokurorisë në marrëdhënie me partnerët ndërkombëtarë.

Me gjithë arritjet, referuar raporteve ndërkomtare për Shqipërinë në vitin 2018 në vështirimin institucional të prokurorisë synohet rritja e mëtejshme e bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore të huaja, si për të shkëmbyer informacion lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit.

vii) Lidhur me rekomandimin, *“Ashpërsimi i politikës penale për masat e sigurisë dhe të dënimit kundër: krimit të organizuar, korrupsionit, dhunës në familje, krimeve kundër jetës, pastrimit të parave, krimit ekonomik dhe financiar, armëmbajtjes pa leje, krimit që lidhet me procesin zgjedhor, personave përsëritës në krim, krimit mjedisor”*, gjatë vitit 2018 rezulton se:

Ashpërsimi i politikës penale për krime serioze

Prokuroria gjatë vitit 2018 ka ndjekur një politikë të ashpër penale për të pandehurit që dyshohen për kryerjen e veprave penale të krimit të organizuar dhe kjo pasqyrohet në të dhënat konkrete lidhur me kërkesat për masat e sigurimit personal, ku 99,5 % janë kërkesa për caktimin e masës të sigurimit “arrest në burg” dhe në kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, ku të gjitha janë për caktimin e dënimit me burg, prej të cilave: 92 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 3 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 5 % e kërkesave për caktimin e dënimit me burgim të përgjeshëm.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale korruptive, kërkesat e prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal 80 % janë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 49 % janë për caktimin e dënimit me burgim dhe në masën 51 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale kundër jetës të kryera me dashje, 91 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 10 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, në masën 10 % janë për caktimin e dënimit me burgim në minimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete, 41 % janë për caktimin e dënimit me burgim në marzhin mesatar, 28 % janë për caktimin e dënimit me burgim në maksimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete, 7 % e kërkesave është për caktimin e burgimit të përgjeshëm dhe 4 % e tyre për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Sa i përket kërkesave për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, nga prokurorët është kërkuar në 3 raste burgim i përjetshëm, në 3 raste burgim në maksimumin e marzheve me burgim të parashikuar nga ligji për këtë vepër, në 1 rast burgim në mesataren e marzheve. Ndërsa në rastet kur këto vepra penale kanë mbetur në fazën e tentativës, në 3 raste është kërkuar caktimi i dënimit me burgim në minimumin e marzheve me burgim të parashikuar nga ligji për këtë vepër.

Sa i përket politikës penale, për dhunën në familje prokurorët në 85,6 % të numrit të personave të dyshuar/akuzuar për kryerjen e kësaj vepre penale kanë kërkuar caktimin e masave të sigurimit personal “arrest në burg”.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale të armëmbajtjes pa leje, 82 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 12 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, në masën 11 % janë për caktimin e dënimit me burgim në minimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete, 50 % janë për caktimin e dënimit me burgim në marzhin mesatar, 1 % janë për caktimin e dënimit me burgim në maksimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete dhe në masën 26 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, 80 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 22 % janë për caktimin e dënimit me burgim në minimumin e parashikuar nga ligji, në masën 34 % janë për caktimin e dënimit me burgim në marzhin mesatar të dënimit, në masën 14 % janë për caktimin e dënimit me burgim në maksimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale dhe në masën 30 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale në fushën e tatimeve, 42 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 29 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, 31 % për caktimin e dënimit me burgim dhe në masën 40 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e krimeve në fushën e doganave, 55 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 36 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, 24 % për

caktimin e dënimit me burgim dhe në masën 40 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale kundër mjedisit, 60 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 43 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, në masën 11 % janë për caktimin e dënimit me burgim dhe në masën 46 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutes, e konsiderojmë të zbatuar detyrimin për politikën e dënimit dhe caktimin e masave të sigurimit, për faktin se treguesit evidentojnë ashpërsimin e politikës së kërkesave të prokurorëve për caktimin e dënimit dhe masave të sigurimit për grupveprat penale të konsideruara serioze edhe sipas rekomandimit në Rezolutën e Kuvendit.

viii) Lidhur me rekomandimin, *“Ndjekja e një politike penale më të butë ndaj të miturve, grave, personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe zhvillimin e hetimeve të shpejta, me qëllim shkurtimin e kohës së hetimit”*, gjatë vitit 2018 rezulton se:

Ndjekja e një politike penale më të butë ndaj të miturve dhe grave.

Në kuadrin e zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, i hyrë në fuqi me datë 1 Janar 2018, të këtij rekomandimi, si dhe udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.5/2018, prokurorët, në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin dhe me viktimë apo dëshmitar të mitur kanë garantuar të drejtat dhe liritë e tyre duke u siguruar pjesëmarrja e psikologut gjatë hetimit, si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore në ngarkim të tyre. Në çdo rast, prokurori i seksionit për hetimin e krimit të kryer nga të miturit ka njoftuar pa vonesë prindërit ose përfaqësuesit ligjorë të tyre, duke ju përmbajtur parimit më të lartë të interesit të të miturit. Vlen të përmendet se, nga seksioni për të mitur është pasur kujdes që të procedohet në sa më pak raste me arrestime apo ndalime me subjekt procedural të mitur, duke i kryer hetimet ndaj tyre në gjendje të lirë dhe/ose me masa sigurimi të lehta si “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”. Masa e sigurimit “Arrest në burg” është caktuar vetëm në raste specifike dhe të rralla për të mitur që kanë kryer vepra penale të rënda, ose që kanë qenë përsëritës në kryerjen e veprave penale. Është bërë kujdes që kohëzgjatja e afatit të hetimeve në çështjet me të mitur të shkurtohet dhe kryerja e veprimeve hetimore të kryhet në mënyrë të përshejtuar. Në masat e dënimit, prokurorët e seksionit për të miturit në prokurori kanë bërë kujdes në kërkimin e dënimeve të lehta apo aplikimin e dënimeve alternative dhe prokurorët kanë filluar kërkimin për aplikimin e shmangies së të miturve nga

dënimi, duke pasur parasysh riedukimin dhe riintegrimin e tyre, si dhe parandalimin e kryerjes të veprave penale nga të miturit.

Të dhënat tregojnë se janë regjistruar 423 procedime penale dhe 481 të mitur si të pandehur/ persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Vjedhja e pasurisë përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit, e konkretisht nga 39 % e të pandehurve të mitur. Një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 27 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt”. Rezulton se rreth 15 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit e për vepra penale lidhur me narkotikët, rezultojnë 4 % e të pandehurve të mitur të regjistruar. Për veprat penale lidhur me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve janë regjistruar 3,5 % e të pandehurve të mitur.

Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin rezulton se janë dërguar për gjykim 235 çështje dhe janë pushuar 128 çështje, ndër të cilat 76 % janë pushuar duke u caktuar ndaj të miturit masa alternative e shmangies dhe 2 % me ndërmjetësim.

Krahas arritjeve, në zbatimin e parashikimeve ligjore të reja më sipër në praktikë janë hasur dhe problematika që mund të sjellin pasoja për procesin, siç janë mungesa e institucioneve që Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon për vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar, mungesa e institucioneve që sigurojnë ndihmën juridike falas për të miturit në konflikt me ligjin ose viktimat, rregullimi me akt nënligjor i shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake të kryera nga prokurorët.

Sa i përket ndjekjes penale të veprave penale kundër fëmijëve, martesës e familjes, të parashikuara nga Seksioni IX i Kodit Penal, në vitin 2018 treguesit statistikorë evidentojnë se janë regjistruar 1349 procedime penale dhe 1050 procedime penale janë dërguar për gjykim që krahasuar me vitin 2017 numri i procedimeve të regjistruara për këtë grupveprash penale rezulton me ulje 7,73 %.

Dhuna në familje zë peshën më të lartë të procedimeve në këtë grup veprash, rreth 89,62 %, e konkretisht 1209 procedime penale të regjistruara ose ulje prej 7,71 % krahasuar me vitin 2017. Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë vepër në vitin 2018 është 42,12. Prokuroria ka hetuar me shpejtësi e përparësi këtë vepër penale ku konstatohet se 1007 procedime penale janë dërguar në gjykatë.

Sa i përket keqtrajtimit të të miturve, nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 30,23 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, ku janë regjistruar 56 procedime penale dhe janë dërguar 19 procedime penale për gjykim.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutes për një politikë më të butë dënimi dhe caktimi të masave të sigurimit, e konsiderojmë të zbatuar këtë detyrimin për faktin se, prokurorët kanë zbatuar një politikë penale më të butë në caktimin e dënimit dhe masave të sigurimit ndaj kësaj kategorie subjektesh, të mitur, gra, apo persona me aftësi të kufizuara të proceduar penalisht.

ix) Lidhur me rekomandimin, “*Ndjekja në vazhdimësi e rasteve që referohen në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me qëllim sigurimin e pastërtisë së figurës së punonjësve publikë*”, gjatë vitit 2018 rezulton se:

Garantimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me qëllim sigurimin e pastërtisë së figurës së punonjësve publikë

Prokuroria e Përgjithshme në cilësinë e organit që në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe Vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016, ka kryer verifikim të thelluar të të kaluarës kriminale të funksionarëve publikë, edhe për vitin 2018, si dhe ka vijuar punën intensivisht në funksion të qëllimit dhe frymës së ligjit. Për këtë qëllim, ka bashkëpunuar me organet ligjzbatuese brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për sigurimin e informacionit të domosdoshëm që garanton verifikim të thelluar dhe për të evidentuar të gjitha rastet kur funksionarit publik duhet t’i ndalohej të ushtrojë funksionet e tij publike.

Gjithashtu, me asistencën e OSBE-së, janë organizuar takime ndërmjet përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të cilat do të vijnë dhe në të ardhmen, me synim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, evidentimin e problematikave, unifikimin e praktikave, etj. Informacionet e përftuara nga verifikimet e thelluara i janë dërguar institucioneve përkatëse për përgjegjësitë administrative, por në rastet e fshehjes apo deklaramit të rremë nga subjektet për të kaluarën e tyre kriminale, materialet i janë referuar për vlerësim/regjistrim procedimi penal prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të cilat raportojnë periodikisht pranë Prokurorisë së Përgjithshme për ecurinë e hetimeve. Me prioritet janë trajtuar dhe rastet kur ka pasur indicie apo kur subjektet sipas ligjit kanë ushtruar të drejtën e nismës për verifikim të të dhënave të formularëve.

Spektori i verifikimit të Integritetit, i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, ka krijuar një praktikë dhe vendimmarrje të konsoliduar.

Spektori i Verifikimit të Integritetit pranë Prokurorisë së Përgjithshme pas një eksperience prej rreth 3 vitesh ka krijuar një praktikë dhe vendimmarrje të konsoliduar. Për vitin 2018 janë administruar 185 raste për verifikim të thelluar, nga të cilët për 147 raste ka përfunduar procesi. Nga 147 vendime “*Për miratimin e rezultateve të verifikimit*”, të cilat u janë njoftuar institucioneve përkatëse, për 31 subjekte materialet referuese i janë dërguar për kompetence

prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm pasi ka rezultuar, se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular, duke konsumuar veprën penale të “Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve” parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutes e konsiderojmë të zbatuar këtë detyrim si për faktin se, në bashkëpunim me institucionet e interesuara dhe ato ndërkombëtare janë verifikuar në mënyrë të thelluar kërkesat për rastet përkatëse, ashtu dhe është ushtruar ndjekje penale ndaj subjekteve që kanë ushtruar funksionet publike në shkelje të këtij ligji, duke parandaluar veprimtarinë publike të mëtejshme të tyre.

x) Lidhur me rekomandimin, *“Thellimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Kontrollin e Lartë të Shtetit, ILDKPKI-në, me qëllim orientimin e një vizioni të përbashkët në politikën shtetërore që duhet të ndiqet në luftën kundër kriminalitetit në tërësi, korrupsionit e krimit të organizuar në veçanti”*, gjatë vitit 2018 rezulton se:

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe institucionet e pavarura

Prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale, është angazhuar në bashkëpunimin veçanërisht me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme në dhënien e kontributit të saj në iniciativat ligjore për përmirësimin e drejtësisë penale, hartimin e dokumenteve strategjike kombëtarë dhe raportime për përmbushjen e prioritetëve e rekomandimeve të Komisionit European për Shqipërinë në kuadër të procesit integrues të vendit. Veçojmë të përmendim këtu, angazhimin tonë në procesin screening.

Në kuadër të amendimit të ligjeve të reformës në drejtësi, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme janë angazhuar në grupin e punës të ngritur nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim dhënien e kontributit për amendimin e rregullave mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale, përkatësisht në Titullin X të Kodit të Procedurës Penale dhe në ligjin nr.10193 datë 3.12.2009 *“Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”*. Amendimi i ligjeve në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar do të përmirësojë dukshëm cilësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të ndihmës në këtë fushë. Prokuroria e Përgjithshme gjithashtu është angazhuar në grupin e punës për amendimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për Transferimin e Personave të Dënuar, *ratifikuar me ligjin nr. 98/2013*. Gjithashtu, në kuadrin e procesit të konsultimit të projektligjeve dhe projektvendimeve të Këshillit të Ministrave që zhvillon Ministria e Drejtësisë janë dërguar mendime/komente dhe sugjerime për ndryshime/plotësime edhe të: - projektligjit “Për dhënie amnistie” dhe - projektakteve normative në zbatim të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe projektakteve normative në zbatim të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Përveç sa më sipër marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë, në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja gjatë vitit 2018 kanë qenë korrekte, duke i shërbyer punës së secilit institucion dhe homologëve të huaj.

Përfaqësues të Prokurorisë kanë qenë pjesë e grupit të punës të ngritur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si për hartimin e projektligjit “*Për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare*”, ligj i cili do të rregullojë procedurën e vendosjes, zbatimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare (sanksioneve), ku përfshihen dhe çështje/fusha të tjera që mbulojnë Rezolutat e OKB dhe sanksionet autonome të BE, ashtu dhe kemi dhënë kontributet institucionale në përgjigje të kërkesave për informacion për raportimin e tretë kombëtar në kuadër të zbatimit të “Konventës kundër Torturës dhe dënimeve apo trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese”, etj.

Gjithashtu, në kuadrin e reformës në drejtësi dhe ndryshimeve rrënjësore në sistemin e organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë, me synim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V ka ngritur grupe pune të përbashkëta dhe po punohet për rishikimin dhe përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të prokurorisë, për unifikimin dhe përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale të prokurorisë në të gjitha hallkat dhe nivelet e juridiksionit të përgjithshëm, në përfaqje me standardet evropiane dhe praktikën e mira të prokurorisë në vendet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, është ngritur grup pune i përbashkët me ekspertët e EURALIUS-it që synon marrjen e ekspertizës dhe eksperiencës ndërkombëtare në çështje që lidhen me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar.

Marrëdhëniet me Policinë e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, për shkak të specifikës ligjore dhe praktike, vlerësohen të një rëndësie prioritare për prokurorinë, ashtu siç u trajtuan edhe më sipër.

Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesave, si institucione të angazhuara posaçërisht në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin dhe referuese të rëndësishme për vepra penale që lidhen me detyrën, janë ndërtuar në bazë të ligjit dhe memorandumëve të bashkëpunimit.

Sa i përket marrëdhënieve me ILDKPKI, të dy institucionet koordinojnë e raportojnë në kuadër të historikut të çështjeve penale që lidhen me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve vendorë. Prokuroria është e angazhuar në këtë bashkëpunim në arritjen e misionit të përbashkët.

Gjatë vitit 2018, bazuar në kallëzimet e paraqitura nga ILDKPKI, janë regjistruar 24 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi

për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe 14 procedime u dërguan në gjykatë. Të dhënat krahasimore në dy vite, tregojnë tendencën në rritje të numrit të procedimeve për këtë vepër, e konkretisht nga 20 procedime të regjistruara në vitin 2017, në 24 procedime të regjistruara në vitin 2018 ose e shprehur në përqindje, rritje me 20 %.

Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nënshkruan në Mars 2019, një memorandum bashkëpunimi, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Palët morën përsipër në këtë memorandum kallëzimin e hetimit me përparësi të veprave penale në fushën e zgjedhjeve dhe trajtimin e shpejtë e me prioritet të procesit të verifikimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutës e konsiderojmë të zbatuar këtë detyrimin si për faktin se, në bashkëpunim me institucionet qendrore të ekzekutivit dhe ato të pavarura, masat e marra i kanë shërbyer dhe i shërbejnë implementimit të reformës ligjore dhe ndërinstitutionale, ashtu dhe i kanë shërbyer orientimit të një vizioni të përbashkët në politikën shtetërore që është ndjekur në luftën e kriminalitetit në përgjithësi, korrupsionit dhe krimit të organizuar në veçanti.

xi) Lidhur me rekomandimin, “*Përdorimi i instituteve procedurale, si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë efektive, për ti shërbyer shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal*”, gjatë vitit 2018 rezultoi se:

Përdorimi i instituteve të reja procedurale

Për zbatimin e instituteve të reja procedurale penale të miratuara me ligjin nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, të hyra në fuqi më datë 1 Gusht 2017, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me OPDAT-in, më datë 10 Korrik 2018 ka organizuar një takim pune me gjithë drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me qëllim diskutimin teorik të këtyre instituteve dhe nxitjen e prokurorëve për një aplikim sa më të gjerë të tyre.

Në këtë kuadër aplikimi i instituteve të reja siç janë: urdhri penal dhe marrëveshja e fajësisë, si dhe i gjyqimeve të drejtpërdrejta synojnë rritjen e shpejtësisë dhe uljen e kostos së procesit penal. Më konkretisht, gjatë vitit 2018 treguesit për këto institute rezultojnë si më poshtë:

Për miratim të urdhrit penal, prokurorët kanë dërguar në gjykatë 591 kërkesa në lidhje me 619 të pandehur, prej të cilëve për 43 kërkesa gjykatat kanë vendosur refuzimin e miratimit të urdhrit penal.

Për miratim të marrëveshjes së fajësisë, prokurorët i kanë dërguar gjykatës 570 kërkesa në lidhje me 621 të pandehur, prej të cilëve për 38 kërkesa gjykata ka vendosur refuzimin e miratimit të marrëveshjes.

Gjykimi i drejtpërdrejtë nga prokurorët është kërkuar për 315 çështje me 318 të pandehur dhe rezulton se kërkesat janë pranuar nga gjykata.

Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutes e konsiderojmë të zbatuar edhe këtë detyrim, si për faktin se, këto institute të reja procedurale penale brenda një kohe relativisht të shkurtër janë kuptuar dhe aplikuar mjaftueshëm nga prokurorët, tregues inkurajues për rritjen e tyre, ashtu dhe se zbatimi i këtyre instituteve i ka shërbyer rritjes së shpejtësisë në përfundimin e këtyre procedimeve si garanci e shtuar në respektimin e të drejtave të subjekteve në procesin penal.

xii) Lidhur me rekomandimin, *“Vazhdimi i kontributit gjithëpërfshirës në drejtim të reformës në drejtësi për reformimin e kuadrit ligjor, si në aspektin material ashtu dhe atë procedural në përmbushjen e objektivave në këtë fushë”*, gjatë vitit 2018 rezulton se:

Kontributi për reformimin e kuadrit ligjor në Kuvendin e Shqipërisë

Marrëdhëniet e prokurorisë me Kuvendin e Shqipërisë janë mbështetur në raporte bashkëpunimi dhe korrekte për forcimin e kuadrit ligjor. Në kuadrin e vijimit të kontributit gjithëpërfshirës të reformës në drejtësi, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme kanë kontribuar dhe kontribojnë për reformimin e kuadrit ligjor duke u përfshirë në grupe punë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si në projektligjin “Për shtesa e ndryshime në Kodin Penal”, lidhur me veprat penale në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e bimëve, kafshëve dhe mjedisit, ashtu dhe në projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” lidhur me regjimin e posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë, dhe projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

2. Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018

Në zbatim të nenit 103 pika 3, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Rekomandimet Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018” të miratuar me vendimin nr.203, datë 11.04.2018 të Këshillit të Ministrave, u përcollën në prokurori nga Ministria e Drejtësisë dhe ju bënë të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjithë niveleve në mbledhjen e përbashkët të organizuar në datë 23.04.2018.

i) Prokurori i Përgjithshëm në zbatim të rekomandimeve dhe problematikave të konstatuara, ka nxjerrë udhëzimet e përgjithshme si vijon:

- Udhëzimi nr.1 datë 20.02.2018 “Për krijimin e seksioneve të posaçme” në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Shkodër, Lezhe, Korçë e Gjirokastrë për hetimin e veprave penale sipas kompetencave të përcaktuara në atë udhëzim, i nxjerrë në funksion të planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.3 datë 26.10.20018 “Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, me synim unifikimin dhe disiplinimin e procedurave dhe standarteve që garantojnë sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”; -krijimin, regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në prokuroritë e të gjitha niveleve; -kontrollin e marrjes, dërgimit, regjistrimit dhe shpërndarjes së informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ndërmjet institucioneve shtetërore dhe prokurorive, në zbatim të ligjit dhe të vendimeve për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”; dhe -evidentimin e shkeljeve që mund të ndodhin gjatë krijimit, regjistrimit, marrjes, dërgimit, shfrytëzimit, shumëfishimit dhe arkivimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.4 datë 26.10.20018 “Për përgjimet”, me synim për të unifikuar mënyrën e realizimit të përgjimit, si mjet i kërkimit të provës, duke garantuar liritë dhe të drejtat e njeriut, rregullat për lëvizjen, regjistrimin, ruajtjen e sekretit dhe të dokumentacionit të dalë nga procesi i përgjimit e ndalimin e publikimit të akteve dhe mënyrën e asgjësimit të materialeve të përgjimit;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.5 datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, me synim unifikimin e rregullave/udhëzime që duhet të ndiqen nga prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokurorisë gjatë ndërveprimit të tyre me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.6 datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, me synim unifikimin e zbatimit të ligjit kundër pasurisë të personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin dhe korrupsionin, etj., si dhe për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.

Prokurori i Përgjithshëm, në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, me synim për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në forcimin e ligjshmërisë dhe efektivitetin në luftën kundër kriminalitetit në fushat përkatëse, ka kërkuar informacione lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, si për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit

të Përgjithshëm, ashtu dhe për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët për çështje konkrete, me synim, që të garantojnë pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë e transparencën në veprimtarinë e prokurorive që drejtojnë.

ii) Përveç sa u trajtua më sipër lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, gjejmë me vend që t'ju bëjmë me dije masat e tjera të marra në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018 si vijon:

- *Garantimi i pavarësisë së prokurorit*

Në kuadrin e ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë dhe parapërgatitjes së procesit të zgjedhjes së anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 68 datë 23.02.2018 ka ngritur grupin e punës për hartimin e projektregullores për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe projekt urdhrin për miratimin e fletës tip të votimit në përputhje me ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të përgatitur në bashkëpunim me ekspertët e Projektit EURALIUS, për t’ia propozuar projektregulloren për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve.

Në këtë kuadër, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve/ kandidatëve, më datë 11 dhjetor 2018 Prokurori i Përgjithshëm thirri dhe organizoi Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve, e cila miratoi Rregulloren që i shërbeu realizimit të një procesi transparent dhe korrekt votimi për përzgjedhjen e kandidatëve dhe në përfundim Komisioni i Votimit shpalli fitues 6 anëtarët prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zgjedhja e të cilëve mundësoi krijimin e këtij organi/institucioni të rëndësishëm kushtetues të qeverisjes së prokurorëve që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e tyre⁸.

- *Forcimi i kapaciteteve*

Duke vlerësuar rëndësinë e rritjes së vazhdueshme profesionale në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të hetimit, në nivel institucional është bashkëpunuar me projektet që asistojnë prokurorinë për zhvillimin e trajnimeve, fokusuar kryesisht në kuptimin e ndryshimeve ligjore në kuadër të reformës në drejtësi dhe implementimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Ndërkohë, vetë prokurorët në përputhje me ligjin i kanë drejtuar kërkesat e tyre Shkollës së Magjistraturës për trajnime specifike. Për më tepër, në Shtojcën nr.1 bashkëlidhur, do të gjeni informacion të detajuar për trajnimet dhe shkëmbimet e eksperiencave në të gjitha fushat, brenda dhe jashtë vendit, gjatë vitit 2018.

Në vështirimin institucional të prokurorisë një çështje me rëndësi për t’u adresuar është zhvillimi i sesioneve trajnuese për oficerët e policisë gjyqësore. Në kuadrin e projekteve që

⁸ Shih, nenin 149 pika 1 të Kushtetutës.

asistojnë prokurorinë, veçanërisht projekti PAMECA, janë organizuar disa aktivitete trajnuese për oficerët e policisë gjyqësore. Nga ana tjetër, drejtuesit e prokurorive në disa rrethe gjyqësore kanë organizuar trajnime dhe takime/mbledhje me oficerë të policisë gjyqësore ku janë diskutuar në vazhdimësi çështje ligjore dhe praktike.

Në këtë vështrim, mendojmë/sugjerojmë se duhet të parashikohet në ligj përcaktimi i institucionit arsimor që duhet të kryejë trajnimin e policisë gjyqësore, si subjekt i rëndësishëm i Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që kjo çështje të marrë zgjidhje afatgjatë.

- Hetimi disiplinor

Në kuadrin e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve, drejtuesit e prokurorive dhe Prokurori i Përgjithshëm në përputhje me ligjin kanë mbikëqyrur respektimin e etikës së prokurorit. Drejtuesit e prokurorive brenda kompetencave që u njeh ligji, kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme në drejtim të respektimit të disiplinës në punë dhe etikës nga prokurorët.

Lidhur me hetimin disiplinor të prokurorëve, Prokurori i Përgjithshëm gjatë vitit 2018, bazuar në nenin 160 paragrafi 5 të ligjit 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” (në vijim ligji nr.96/2016), ka iniciuar 12 (dymbëdhjetë) procedime me 12 (dymbëdhjetë) prokurorë të përfshirë nën hetim disiplinor që kanë pasur si indicie mosrespektimin e rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve. Ky proces ka hasur vështirësi, duke qenë në kushtet e vakuumit ligjor të krijuar pas shfuqizimit me vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese të neneve 101, 102, 103, 104 e vijues të ligjit 96/2016 që parashikojnë llojet e shkeljeve disiplinore. Me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konstatimet dhe gjetjet do t’i vihen në dispozicion e këtij institucioni.

Në këtë kuadër, mendojmë/sugjerojmë se është nevojë emergjente plotësimi i dispozitave ligjore të ligjit 96/2016, të shfuqizuara me vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese, për të mundësuar zbatimin e tyre nga organet/institucionet kushtetuese përkatëse në zbatim të reformës në sistemin e drejtësisë.

- Respektimi i të drejtave të njeriut

Në 1 Janar 2018 hyri në fuqi ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili parashikon rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin dhe/ose të çdo mase tjetër që përfshin të miturit në konflikt me ligjin, si dhe të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Për implementimin sa më të suksesshëm të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, institucioni ynë ka dhënë kontributin e tij, në konsultimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Në kuadrin e projektit të Mbretërisë së Suedisë, përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, *“Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligj-zbatuese shqiptare për përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit- një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë”*, prokuroria ka marrë dhe po merr asistencë për rritjen e kapaciteteve, ashtu si dhe agjencitë e tjera shqiptare të zbatimit të ligjit dhe gjykatat, për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit. Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme, ka marrë e vijon me masat institucionale për zbatimin e detyrimeve të saj në kuadër të garantimit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm.

Në janar 2018 në Prokurorinë e Përgjithshme u ngrit një strukturë e posaçme për ndihmën ndaj subjekteve me status të posaçëm me përbërje prokurorë dhe ndihmës/psikologë. Të kufizuar nga numri i punonjësve në dispozicion, vetëm në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Durrës u caktuan funksionet koordinator/psikolog të viktimave. Aktualisht, pas miratimit të shtesës së numrit të punonjësve Prokurorisë së Përgjithshme me ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, në strukturën e vitit 2019 Prokurori i Përgjithshëm caktoi koordinatorë/psikologë të viktimave në gjithë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Në këtë kuadër, Prokurori i Përgjithshëm në datë 26.10.2018, ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr.5/2018 për garantimin e asistencës të miturve viktimat dhe dëshmitarë të veprave penale. Udhëzimi, i hartuar me asistencën e OPDAT, shoqërohet edhe nga disa shtojca që janë modele të unifikuara aktesh të nevojshme në zbatim të udhëzimit dhe punës së prokurorëve dhe/ose oficerëve të policisë gjyqësore. Po, kështu u miratua edhe një broshurë informative për viktimat e krimit, që u shpërnda në prokuroritë e shkallës së parë dhe u publikua edhe në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga ana tjetër, është synuar forcimi i kapaciteteve në prokurori, si në shtimin e personelit ashtu edhe në trajnimin e tyre, i cili është pasqyruar në Shtojcën 1, bashkëlidhur.

Krahas arritjeve, në zbatimin e parashikimeve ligjore të reja më sipër, në praktikë janë hasur dhe problematika që mund të sjellin pasoja për procesin, siç ishte mungesa e institucioneve që ligji/Kodi i të Miturve parashikon për vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar, mungesa e institucioneve që sigurojnë ndihmën juridike falas për të miturit në konflikt me ligjin ose viktimat, rregullimi me akt nënligjor i shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake të kryera nga prokurorët.

Një çështje tjetër problematike ligjore është konstatuar në përcaktimin e kompetencës për hetimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin apo të miturin viktimë. Pavarësisht se në gjykimin tonë, qëndrimi i prokurorisë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës në favor të asaj lëndore është i drejtë, në përputhje me ligjin dhe në frymën e qëllimit për një drejtësi miqësore për të miturin, praktika gjyqësore ka orientuar gjykimin

nga seksionet që ekzistojnë vetëm në 7 rrethe gjyqësore. Riorganizimi i rretheve gjyqësore, vlerësojmë dhe besojmë se do të shërbejë për një zgjidhje përfundimtare edhe të kësaj çështjeje ligjore.

Në kuadrin e respektimit të të drejtave të personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale dhe të kujdesit për ushtrimin e kompetencave ligjore të prokurorisë, shqetësimi institucional i Prokurorisë së Përgjithshme ka qenë dhe mbetet mungesa e institucioneve mjekësore të posaçme në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për trajtimin e personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale, ndaj të cilëve nga gjykata është vendosur mjekim i detyrueshëm në një institucion mjekësor ose shtrim i përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm.

Në zbatim të urdhërimeve ligjore të parashikuara në nenet 463, 466 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nenet 9, 12, 45 e vijues të ligjin nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar dhe nenin 28 e vijues të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, dhe të vendimit nr.255 datë 19.12.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Prokurori i Përgjithshëm me qarkoren nr.3339/1 datë 04.01.2019, drejtuar prokurorive të të gjithë niveleve me juridiksion të përgjithshëm ka udhëzuar/orientuar prokurorët që urdhri i ekzekutimit, si për kryerjen e mjekimit të detyrueshëm në institucion mjekësor, ashtu dhe për shtrimin e përkohshëm në një spital psikiatrik, sipas ligjit t’i dërgohet institucionit mjekësor të specializuar që është përcaktuar paraprakisht nga MSHMS mbi kërkesën e prokurorit.

Gjithashtu, transferimi i të dënuarve me masë mjekësore “Mjekim i detyrueshëm në institucionet mjekësore” nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Krujë dhe Institucioni i Veçantë Shëndetësor (IVSH) Tiranë në institucionet mjekësore të posaçme përbën problem shqetësues për zgjidhje, si detyrim i shtetit për të rehabilituar shëndetin e këtij grupi personash, ashtu dhe për marrjen e masave të sigurisë për të parandaluar çdo rrezik potencial që mund të përbëjë kjo kategori personash për sigurinë publike.

Për këto arsye, është kërkuar dhe sugjeruar marrja e masave dhe respektimi i afateve për transferimin e të dënuarve me masë mjekësore “Mjekim i detyrueshëm në institucionet mjekësore” nga IEVP Krujë dhe IVSH Tiranë në varësi të MD-së, në institucionet mjekësore të posaçme në ambientet e përshtatura të IVSH Tiranë dhe dy godinat 4 dhe 5 të IEVP Lezhë të kaluara në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si dhe njoftimi për përfundimin e këtij procesi dhe aktet nënligjore përkatëse.

Në analizë të përmbushjes së Rezolutës për një politikë më të butë dënimi dhe caktimi të masave të sigurimit, e konsiderojmë të zbatuar këtë detyrim për faktin se, krahas masave administrativo-penale për nxjerrjen e akteve normative të detyrueshme, për ngritjen e strukturave të specializuara dhe forcimin e kapaciteteve të tyre në garantimin e të drejtave dhe lirive të të miturve në konflikt me ligjin dhe viktimave të veprave penale, prokurorët kanë zbatuar një politikë penale më të butë në caktimin e dënimit dhe masave të sigurimit ndaj kësaj kategorie subjektesh.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe kontributi në reformimin e kuadrit ligjor**3. Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësorë të veprimtarisë së institucionit**

Gjatë vitit 2018 janë përfunduar 30615 çështje, 38,5 % janë dërguar për gjykim, 21,7 % janë pushuar, 35,6 % janë pezulluar dhe 4,2 % janë transferuar në prokurorinë kompetente.

Konkretisht në vitin 2018 janë dërguar në gjykatë 11801⁹ çështje me akuzë ndaj 13414 të pandehurve. Krahësimisht me vitin 2017 rezulton një rritje prej 2,59 % e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 4,65 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë dënuar 10246 të pandehur dhe për 211 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm.

Gjatë vitit 2018 është kërkuar gjykim i drejtëpërdrejtë për 315 çështje me 318 të pandehur.

I janë dërguar gjykatës 591 kërkesa për miratim të urdhrit penal në lidhje me 619 të pandehur dhe në 43 raste është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal.

I janë dërguar gjykatës 570 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë në lidhje me 621 të pandehur dhe në 38 raste është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes.

Gjatë vitit 2018, u dërguan në gjykatë për pushim 2605 çështje. Nga të dhënat rezulton se në 169 çështje gjykata vendosi kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ndërsa në 12 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës.


Efektiviteti i përgjimit të komunikimeve elektronike në hetimet paraprake

Gjatë vitit 2018 në sajë të kësaj teknike hetimore është arritur në arrestimin/ndalimin e 619 personave të dyshuar për krime kundër personit, vepra penale në fushën e narkotikëve,

⁹ 11 çështje me akuzë ndaj 11 të pandehurve bazuar në Kodin Penal Ushtarak


korupsion e shpërdorim detyre, trafiqe e kalim i paligjshëm i kufirit apo vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja për shtetin e shtetasit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet procedimet sipas grupveprave penale për të cilat është kërkuar përgjimi i komunikimeve elektronike në hetimet paraprake:



Në shifra të përgjithshme, gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar gjithsej 3063 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 715 procedime penale. Nga këto, 147 procedime penale kanë qenë në kuadër të hetimeve të prokurorisë për krime të rënda. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 4168 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Ecuria e këtij mjeti kërkimi prove në 3 vitet e fundit paraqitet në grafikun në vijim:



Aksesi në bazat e të dhënave shtetërore

Duke marrë parasysh rëndësinë e aksesit në bazat e të dhënave për shpejtësinë, cilësisë dhe efektivitetin e hetimeve, prokuroria për vitin 2018 ka arritur sa vijon:

Në mars të vitit 2018 një marrëveshje bashkëpunimi “Për dhënien e të drejtave të aksesit në prokurori të regjistrat elektronik të pasurive të paluajtshme” u nënshkrua me Zyrën Qendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Aktualisht i kemi dërguar ZRPP listën me emrat e punonjësve të prokurorisë (prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore) që do të jenë përdorues në këtë databazë dhe ata janë në proces të garantimit të aksesit.

Gjithashtu, në mars të 2018-s, iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me kërkesën për akses në disa module të portalit e-Albania dhe jemi lidhur me portalin, nga ku marrim akses në printimin e 5 dokumentave.

Gjatë periudhës raportuese, u nënshkrua edhe Memorandumi i Bashkëpunimit midis Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nr.3400 prot., datë 26.12.2018 “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në sistemin elektronik të prokurimeve”.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2017 për “Shkëmbimin e Informacionit Ndërmjet Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë”, është testuar me sukses lidhja midis dy sistemeve dhe së shpejti kjo ndërlidhje do të pilotohet në Prokurorinë e Elbasanit.

Track record

Në zbatim të rekomandimeve të Progres Raportit për krijimin e një historiku të hetimit e dënimit të rasteve të korrupsionit, krimit të organizuar dhe deklarimit të pasurive, prokuroria ka koordinuar e bashkëpunuar me institucionet e tjera shqiptare dhe ka përgatitur e përcjellë pranë strukturave përkatëse në muajin janar 2019 statistikat e harmonizuara dhe track record.

Sa i përket marrjes së masave për finalizimin e implementimit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, në funksion të realizimit të shortit elektronik të ndarjes së çështjeve, gjatë vitit 2018 është implementuar moduli i Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të apeleve me funksionet sipas ndryshimeve ligjore, duke përfshirë edhe kërkesën për shpërndarjen e çështjeve me short, module të cilat janë në proces testimi. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve thelbësore të Kodit të Procedurës Penale një sërë funksionesh të këtij sistemi kanë nevojë për rishikim dhe riprogramim.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT, TË DHËNA PËR NUMRIN, LLOJET, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE FORMAT E KRIMINALITETIT

2.1 VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2018¹⁰


Gjatë vitit 2018, në organin e prokurorisë janë trajtuar 57734¹¹ materiale kallëzuese që përbën një ulje prej 0,96 % në krahasim me vitin 2017. Janë ndjekur gjithsej 42814 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 4,65 % në krahasim me vitin 2017, nga të cilat 31409 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 0,23 % në krahasim me vitin 2017 dhe 486 procedime penale të rifilluara, që tregojnë ulje prej 23,34 % në krahasim me vitin 2017. Janë mbartur nga viti 2017, 10919 procedime penale me një rritje prej 24,14 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2017. Është vendosur mosfillimi për 14920 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 14,15 % në krahasim me vitin 2017.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2018 paraqitet si vijon:


¹⁰ Procedimi penal nuk njehet me veprën penale, pasi:

- 1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna **për veprën penale më të rëndë**, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
- 2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.

¹¹ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura nga viti 2017; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2018 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2018; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2018.



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike volumi i punës i prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017:



2.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2018 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 11801 procedime penale (ulje

prej 2,65 % në krahasim me vitin 2017) me 13414 të pandehur (ritje prej 4,70 % në krahasim me vitin 2017). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 12570 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal.

Nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 4787 çështje themeli (ulje prej 1,32 % në krahasim me vitin 2017) dhe 2353 raste për masat e sigurimit personal (ulje prej 23,68 % në krahasim me vitin 2017).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 14 çështje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në përqindje për çështjet e përfaqësuara në gjykatë në të tre shkallët:




2.3 TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT

Procedime të regjistruara

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2014 janë regjistruar 33894 procedime penale që do të thotë ritje prej 22 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 janë regjistruar 32497 procedime penale që do të thotë ulje prej 4 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë regjistruar 31305 procedime penale që përbën ulje prej 3,6 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 janë regjistruar 31481 procedime penale që përbën ritje prej 0,56 % krahasuar me vitin 2016 dhe në vitin 2018 janë regjistruar 31409 procedime penale që përbën ulje prej 0,23 % krahasuar me vitin 2017.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara në tre vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



Procedime në ndjekje

Nga të dhënat statistikore në vitin 2014 rezultojnë 43827 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 30 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 rezultojnë 44077 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 0,6 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezultojnë 41690 procedime në ndjekje penale që përbën ulje prej 5,4 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 rezultojnë 40911 procedime në ndjekje penale që përbën ulje prej 1,87 % krahasuar me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezultojnë 42814 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 4,65 % krahasuar me vitin 2017.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë në tre vitet e fundit:



Ndjekja penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak


Pesha specifike që zënë procedimet penale të regjistruara në bazë të Kodit Penal Ushtarak në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2018 është 0,06 %, si edhe në vitin 2017.

Grafikët në vijim paraqesin të dhënat e volumit të punës në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës, për veprat penale në fushën e zbatimit të Kodit Penal Ushtarak.



Siç vërehet nga grafiku, në vitin 2018, janë regjistruar 20 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak dhe janë mbartur 2 procedime penale.

Procedimet penale janë regjistruar për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal Ushtarak që paraqiten në grafikun në vijim:



Gjatë vitit 2018 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 11 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, me 11 të pandehur.

Në vijim të dhënave lidhen me vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, ligji nr.7895/1995 i ndryshuar.

Çështje të përfunduara

Në lidhje me **çështjet e përfunduara**¹², të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2014 ka pasur një rritje prej 36 % të çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 rezultojnë një rritje prej 5,6 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezultojnë një ulje 5,9 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezultojnë një ulje 9,3 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezultojnë një rritje prej 1,93 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me **çështjet e pushuara**, në vitin 2014 rezultojnë një rritje prej 35 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 rezultojnë një rritje prej 2 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezultojnë një ulje prej 6,6 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezultojnë një rritje prej 3,2 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezultojnë një rritje prej 1,74 % e çështjeve të pushuara¹³ në krahasim me vitin 2016.

¹² Në këtë tregues përveç çështjeve të pushuara, pezulluara dhe dërguar gjyqit mbledhen edhe çështjet e transferuara.

¹³ Në këtë tregues përfshihen çështje të pushuara nga prokurori dhe nga gjykata.

Në lidhje me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2014 rezulton një rritje prej 16 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 rezulton një rritje prej 4 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezulton një rritje e lehtë prej 0,2 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje prej 13,4 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezulton një ulje prej 2,69 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2017.


Në lidhje me **çështjet e dërguara në gjykatë**, në vitin 2014 rezulton një rritje prej 66 % e çështjeve të dërguara në gjyq në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 rezulton një rritje prej 7,7 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezulton një ulje prej 11,2 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje prej 11,6 % e çështjeve të dërguara në gjykatë¹⁴ në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezulton një rritje prej 2,59 % e çështjeve të dërguara në gjykatë¹⁵ në krahasim me vitin 2017.

Lidhur me numrin e të pandehurve të dërguar në gjykatë vërehet se në vitin 2015 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur 7 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2016 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 11,4 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 14,5 % krahasuar me vitin 2016 dhe në vitin 2018 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 4,65 % krahasuar me vitin 2017.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e pesë viteve të fundit:

¹⁴ Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprahe si dhe kërkesat për miratimin e urdhrit penal dhe marrëveshjes së fajësisë.

¹⁵ Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprahe si dhe kërkesat për miratimin e urdhrit penal dhe marrëveshjes së fajësisë.



Më poshtë paraqiten të dhëna në **lidhje me të pandehurit** sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake:




Vendimmarrja e gjykatës

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq në vitin 2014 përbën 6,7 % të çështjeve të dërguara gjyqit, në vitin 2015 përbën 2,3 %, në vitin 2016 ky tregues përbën 2,5 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2017 ky tregues përbën 8,2 % të çështjeve të dërguara në gjyq dhe në vitin 2018 ky tregues është 1,43 %.

Në lidhje me **pushimin e akuzës** për të pandehurit, në vitin 2014 rezulton se është vendosur pushimi i akuzës për 0,37 % të akuzave të ngritura, në vitin 2015 është vendosur pushimi i akuzës për 0,08 % të akuzave të ngritura, në vitin 2016 për 0,1 % të numrit të akuzave të ngritura, në vitin 2017 për 0,4 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës dhe në vitin 2018 për 0,12 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës.

Në lidhje me **vendimet e gjykatës për pafajësinë**, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2014 është dhënë pafajësi për 1,7 % të të pandehurve të dërguar në gjyq në vitin 2015 është dhënë pafajësi për 2,47 % të të pandehurve të dërguar në gjykatë, në vitin 2016 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 2,5 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2017 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 2,6 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2018 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,57 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate.

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë në pesë vite, 2014-2018:



Pezullimet


Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokuroria është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtijshëm. Pezullimi i

hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore dhe nga ana tjetër hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit.

Ky tregues për vitin 2018 përbën 36 % të procedimeve për të cilat ka përfunduar hetimi.


Të dhënat tregojnë se ndër 10882 procedime të pezulluara, 10877 prej tyre janë pezulluar për shkak se nuk njihet autori i veprës penale dhe 5 procedime janë pezulluar për shkak se i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për procedimet e pezulluara në vitet 2014-2018:



Në lidhje me procedimet e pezulluara nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2014 numri i procedimeve të pezulluara është rritur me 16,2 %, në vitin 2015 numri i procedimeve të pezulluara është rritur me 4,2 %, në vitin 2016 numri i procedimeve të pezulluara ka një rritje të lehtë prej 0,2 %, në vitin 2017 numri i procedimeve të pezulluara është ulur me 13,4 %, ndërsa në vitin 2018 numri i procedimeve të pezulluara është ulur me 2,69 %.


Për vitin 2018, procedimet penale të pezulluara sipas grup veprave penale paraqiten grafikisht si më poshtë (në grafik nuk janë përfshirë procedimet e pezulluara për grup veprat penale numri i të cilave është më i ulët se 20):



Mosfillimet

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton në vitin 2014 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 13416 referime dhe kallëzime kundrejt 8414 vendimeve të marra në vitin 2013 ose rritje prej 59 %, në vitin 2015 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14452 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 8 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2014, në vitin 2016 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 15655 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 8,3 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2015, në vitin 2017 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 17378 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 11 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2016 dhe në vitin 2018 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14920 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 14,15 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2017.

Të dhëna të detajuara gjenden në grafikun e mëposhtëm:



2.4 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2018

Në prokurorinë e shkallës së parë **Berat** janë regjistruar 952 procedime penale, që do të thotë ulje prej 12,74 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Dibër** janë regjistruar 587 procedime penale, që do të thotë një ulje prej 1,51 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Durrës** janë regjistruar 2779 procedime penale, që do të thotë rritje prej 14,69 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Elbasan** janë regjistruar 2371 procedime penale, që do të thotë rritje prej 4,27 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Fier** janë regjistruar 1803 procedime penale, që do të thotë rritje prej 15,87 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Gjirokastrë** janë regjistruar 655 procedime penale, që do të thotë ulje prej 15,37 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kavajë** janë regjistruar 528 procedime penale, që do të thotë ulje prej 14,15 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Korçë** janë regjistruar 1531 procedime penale, që do të thotë rritje prej 1,73 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Krujë** janë regjistruar 719 procedime penale, që do të thotë rritje prej 12,34 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kukës** janë regjistruar 389 procedime penale, që do të thotë ulje prej 24,47 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kurbin** janë regjistruar 450 procedime penale, që do të thotë ulje prej 15,25 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Lezhë** janë regjistruar 1177 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13,50 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Lushnje** janë regjistruar 849 procedime penale, që do të thotë ulje prej 2,41 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Mat** janë regjistruar 166 procedime penale, që do të thotë ulje prej 9,29 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Përmet** janë regjistruar 100 procedime penale, që do të thotë ulje prej 18,03 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Pogradec** janë regjistruar 507 procedime penale, që do të thotë rritje prej 5,85 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Pukë** janë regjistruar 135 procedime penale, që do të thotë ulje prej 7,53 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Sarandë** janë regjistruar 951 procedime penale, që do të thotë rritje prej 2,48 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Shkodër** janë regjistruar 2166 procedime penale, që do të thotë rritje prej 9,01 % në krahasim me vitin 2017;


Në prokurorinë e shkallës së parë **Tiranë** që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9867 procedime penale, që përbën ulje prej 3,89 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Tropojë** janë regjistruar 200 procedime penale që do të thotë ulje prej 25,37 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Vlorë** janë regjistruar 2297 procedime penale, që do të thotë ulje prej 1,33 % në krahasim me vitin 2017;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për **Krime të Rënda** janë regjistruar 210 procedime penale, që do të thotë ulje prej 35,98 % në krahasim me vitin 2017;

Më poshtë paraqiten të dhënat në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2018:



Siç vërehet nga të dhënat, edhe në vitin 2018 numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë me 31,43 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera me shifrat më të larta janë: prokuroria e shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 8,85 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 7,55 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria e shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 7,32 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria e shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 6,90 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria e shkallës së parë Fier që ka regjistruar 5,74 % të procedimeve të regjistruara dhe prokuroria e shkallës së parë Korçë që ka regjistruar 4,88 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi.

2.5 KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË BAZUAR NË SISTEMIN STATISTIKOR TË PROKURORISË


Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100.000 banorë¹⁶ në vitin 2018 është **1094** po aq sa edhe në vitin 2017. Në lidhje me koeficientet e kriminalitetit për 100.000 banorë, sipas qarqeve të dhënat statistikore rezultojnë si më poshtë:

Në qarkun Berat që përfshin prokurorinë e shkallës së parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 747; në qarkun Dibër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 622; në qarkun Durrës që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1208; në qarkun Elbasan që përfshin prokurorinë e shkallës së parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 851; në qarkun Fier që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Fier dhe Lushnjë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 890; në qarkun Gjirokastër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1199; në qarkun Korçë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 970; në qarkun Kukës që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 761; në qarkun Lezhë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Lezhë dhe Kurbini koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1283; në qarkun Shkodër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1122; në qarkun Tiranë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1176 dhe në qarkun Vlorë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1716.

Siç rezulton nga të dhënat, përqindjen më të ulët të kriminalitetit e ka qarku Dibër ndërsa përqindjen më të lartë qarku Vlorë. Sa i përket tendencës, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2018 e kanë qarku Durrës e qarku Fier, ndërsa ulje e kriminalitetit vërehet në qarkun Kukës, qarkun Gjirokastër e qarkun Berat.

Renditja paraqitet grafikisht në vijim:

¹⁶ <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>



2.6 TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë **filluar kryesisht** 109 procedime penale nga ana e prokurorisë.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1600 kallëzime, që do të thotë ulje prej 13,88 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1822 kallëzime, që do të thotë rritje prej 17,3 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1553 kallëzime, që do të thotë rritje prej 31,5 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1181 kallëzime, që do të thotë ulje prej 7,4 % në krahasim me vitin 2014 gjatë të cilit rezulton të kenë ardhur në prokurori 1275 kallëzime.

Kallëzime nga personeli mjekësor: në vitin 2018 rezulton të ketë ardhur në prokurori 1 kallëzim nga personeli mjekësor, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2 kallëzime nga personeli mjekësor, shifër e njëjtë me vitin 2016, ndërkohë që në vitin 2015 rezulton të ketë ardhur në prokurori 1 kallëzim penal, tregues me ulje kundrejt 8 kallëzimeve të ardhura në vitin 2014.

Kallëzime nga shtetasit: në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2776 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë rritje prej 1,39 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2738 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë ulje prej 1,9

% në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2789 kallëzime, që do të thotë rritje prej 34,7 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2070 kallëzime, që do të thotë ulje prej 14,5 % në krahasim me vitin 2014, në të cilin rezulton të kenë ardhur në prokurori 2420 kallëzime.

Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim: në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 179 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim që do të thotë ulje prej 35,38 % krahasuar me një vit më parë, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 277 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që do të thotë rritje prej 19,4 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 232 kallëzime, që do të thotë ulje prej 28,4 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 324 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që do të thotë ulje prej 5 % në krahasim me vitin 2014, gjatë të cilit rezulton të kenë ardhur në prokurori 341 kallëzime.

Gjatë vitit 2018 rezulton të jetë marrë njoftim për 5501 ngjarje, që do të thotë ulje prej 5,6 % në krahasim me vitin 2017, gjatë vitit 2017 rezulton të jetë marrë njoftim për 5828 ngjarje, që do të thotë ulje prej 13,7 % në krahasim me vitin 2016, gjatë vitit 2016 rezulton të jetë marrë njoftim për 6757 ngjarje, që do të thotë rritje prej 22 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 është marrë njoftim për 5535 ngjarje që përbën një ulje prej 26 % krahasuar me vitin 2014, në të cilin është marrë njoftim për 7545 ngjarje.


Gjatë vitit 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 36835 **referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera** që përbën rritje prej 2,52 në krahasim me vitin 2017, gjatë vitit 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 35929 referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera, që do të thotë rritje prej 15,7 % në krahasim me vitin 2016, gjatë vitit 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 31063 referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera, që do të thotë ulje prej 6,7 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 janë marrë 33306 referime që do të thotë rritje prej 4 % në krahasim me vitin 2014, gjatë vitit 2014 janë marrë 31949 referime, që do të thotë rritje prej 32 % në krahasim me vitin 2013, gjatë të cilit janë marrë 24215 referime.

2.7 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 urdhrat për ekzekutim të dënimeve kryesore me burgim, gjobë e dënime plotësuese, zënë 41,90 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 58,10 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Krahasuar me vitin 2017, urdhrat e ekzekutimit për dënimet me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë dhe dënime plotësuese kanë pësuar një ulje prej 1,64 %, ndërsa dënimet alternative kanë pësuar një rritje prej 30,78 %.

Gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar 8104 vendime penale të formës së prerë, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar 3916 vendime. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 3 dënime me burgim të përjetshëm, 549 vendime me burgim, 1410 vendime për dënimin me gjobë, 59 dënime plotësuese dhe 1895 dënime alternative.


Sa më sipër paraqitet në grafikun në vijim:




2.8 KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2018, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara në prokurori sipas veprave penale.



Procedime të regjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2017-2018:




Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, rezulton si vijon:

- Raporti që zënë **krimet kundër njerëzimit**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 1,73 %¹⁷;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 2,89 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 1,41 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,36 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,32 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,90 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 4,31 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0 %;
- Raporti që zënë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 33,67 %;
- Raporti që zënë **mashttrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 2,78 %;
- Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 3,97 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,36 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,11 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,61 %;

¹⁷ Përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 1,06 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,26 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 3,56 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0 %;
- Raporti që zënë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,60 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 4,75 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,79 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 2,15 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 2,87 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 23,99 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 3,83 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 2,52 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,13 %;

Këto të dhëna paraqiten grafikisht si më poshtë:



Në vijim do të analizohet në mënyrë më të detajuar secili nga seksionet e Kodit Penal:

2.9 ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

KRIME KUNDËR NJËRËZIMIT

Në vitin 2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka regjistruar 1 procedim penal në lidhje me krimet e parashikuara në Kreun I të Kodit Penal, “Krim kundër njerëzimit”, e konkretisht për nenin 73 “Gjenocidi”.

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike¹⁸ që zë ky grup veprash penale për vitin 2018 është 1,56 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2017 ky grup veprash përbënte 1,22 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 17,07, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 13,38.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun II, Seksioni I, “Krim kundër jetës të kryera me dashje”.

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj. 19	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua r
Neni 76 Vrasja ²⁰	30	16	15	19	17	30	3	17	3	13
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	39	15	14	19	15	47	10	27	16	21
Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje	5	2	1	2	3	1	1	0	2	1
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	18	7	22	10	10	25	10	19	11	13

¹⁸ “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve të regjistruara. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të mos ketë përputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.

¹⁹ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.


²⁰ Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (52 procedime regjistruar dhe 41 të pandehur regjistruar).

Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë	1	0	0	0	0	2	0	2	0	0
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	1	1	1	1	2	4	2	5	4	2
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	25	16	23	16	8	14	13	17	13	10
Neni 80	2	0	0	0	6	0	0	0	0	3
Neni 81 Vrasja e foshnjës	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	1	1	1	1	2	0	0	1	1	0
Neni 83 Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	1	4	1	4	4	2	3	2	3	0
Neni 83/a Kanosja për hakmarrje/gjakmarrje	4	1	2	1	0	11	1	2	1	1
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
Neni 84 Kanosja	257	65	147	70	27	351	66	126	79	16
Totali	385	129	228	144	95	490	109	218	134	80

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 27,27 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi një ulje prej 15,50 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re ulje përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 4,39 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 6,94 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 15,79 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 95,19 % e tyre janë meshkuj (nga të cilët 3,37 % janë të mitur) dhe 4,81 % janë femra (ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura).

Në lidhje me arsimimin e të pandehurve, rezulton se për këto grup veprash penale 2,29 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë, 50,29 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve, prej 47,42 % rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 64,34 % e të pandehurve janë të papunë, 34,88 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 0,78 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se, rreth 65,57 % e të pandehurve për këtë grup veprash janë banues në qytet dhe 43,43 % e tyre, në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vihet re se 6,32 % e tyre janë përsëritës për vepra të tjera dhe pjesa tjetër janë të padënuar më parë.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vrasja me dashje


Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2018 është regjistruar numër i njëjtë procedimesh për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, në krahasim me vitin 2017.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2018 është 6,12 %, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 7,79 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje” për vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, konkretisht 11 procedime që përbëjnë 37 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 5 procedime ose 17 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Vlorë janë regjistruar 4 procedime ose 13 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 2 procedime ose 7 % e numrit total të procedimeve dhe në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Korçë, Lezhë e Përmet është regjistruar respektivisht 1 procedim penal ose 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës, Fier, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Mat, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje” gjatë vitit 2018.

Vrasja me paramendim


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2018 është 9,59 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 10,13 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014 – 2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018, ka një rritje prej 20,51 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim” i Kodit Penal, krahasuar me vitin 2017.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vrasjes me paramendim, rezulton në

prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 8 procedime penale që përbën 17 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Shkodër janë regjistruar respektivisht nga 7 procedime penale ose 15 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 5 procedime që përbëjnë 11 % të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 4 procedime penale ose 9 % e procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Lezhë janë regjistruar respektivisht nga 3 procedime ose 6 % e procedimeve, ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Lushnje e Tropojë është regjistruar respektivisht nga 2 procedime penale. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Fier, Gjirokastrë e Mat kanë regjistruar respektivisht nga një procedim ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”.

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 5,10 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 4,68 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018, ka një rritje prej 38,89 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, krahasuar me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë ku janë regjistruar 4 procedime penale që përbëjnë 16 % të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Tiranë janë regjistruar nga 3 procedime penale që përbëjnë 12 % të totalit të procedimeve penale dhe prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Elbasan, Mat, Pukë e Shkodër kanë regjistruar nga 2 procedime penale, e shprehur në përqindje 8 % e totalit të procedimeve. Ndërkaq prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Kurbin e Lushnje kanë regjistruar nga 1 procedim penal dhe në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kavajë, Krujë, Kukës, Lezhë, Përmet, Pogradec, Sarandë e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” gjatë vitit 2018.

Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 2,86 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 6,49 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë regjistruar 14 procedime penale për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, që ndaj 25 procedimeve të regjistruara në vitin 2017, përbën ulje prej 44 %.




Kanosja

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje për procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 71,63 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 67,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë regjistruar 351 procedime penale që përbëjnë një rritje prej 36,58 % krahasuar me 257 procedime të regjistruara për vitin 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

Të dhënat për procedimet e regjistruara gjatë vitit 2018 në prokuroritë e shkallës së parë për veprën penale të kanosjes gjenden në mënyrë të detajuar në vijim:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kanosjes është në prokurorinë e shkallës së

parë Tiranë, që përbën 28 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi.

Në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Vlorë janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar rreth 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Elbasan, Sarandë, Durrës e Berat janë regjistruar respektivisht rreth 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Lushnje, Dibër e Kavajë janë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2018. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër më të vogël procedimesh (më pak se 2 %) për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni II “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	9	4	7	4	4	4	2	1	3	0
Totali	9	4	7	4	4	4	2	1	3	0

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka ulje të treguesve lidhur me “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”. Konkretisht nga 9 procedime penale me 7 të pandehur të regjistruar në vitin 2017, në 4 procedime penale me 1 të pandehur të regjistruar në vitin 2018. Procedimet e dërguara në gjykatë rezultojnë me ulje nga 4 në vitin 2017, në 2 procedime në vitin 2018, ndërkohë që nuk rezultojnë të pandehur të dënuar për këtë vepër gjatë periudhës raportuese.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2018 është 2,89 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2017 ky grup veprash përbënte 2,7 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 31,63, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 29,97.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i III “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit”:


VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. Në gjyk atë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënu ar
Neni 86 Tortura	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje	101	58	98	73	63	100	56	103	68	53
Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë 70 psikike	2	2	2	2	2	0	1	1	2	2
Neni 88/b Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	1	3	1	3	2	1	2	1	2	2
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	738	230	620	291	121	775	264	588	348	192
Neni 89/a Shitblerja e paligjshme e organeve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 90 Dëmtime të tjera	19	1	5	1	1	31	4	8	4	10
Totali	862	294	726	370	189	908	327	701	424	259

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 5,34 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit” në krahasim me vitin 2017. Tendencë në rritje paraqet edhe numri i procedimeve dërguar në gjykatë, prej 11,22 % në krahasim me vitin 2017, ndërsa numri i të pandehurve të regjistruar në vitin 2018 paraqet ulje prej 3,44 % përkundrejt këtij totali në vitin 2017.

Ndërkohë, numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë është rritur me 14,59 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 37,04 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se vetëm 2,90 % e tyre janë femra dhe pjesa tjetër 97,10 % janë meshkuj. Gjithashtu, rezulton se 5,31 % e të pandehurve janë të mitur (14-18 vjeç).

Ndër të pandehurit rezulton edhe 1 shtetas i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale 5,58 % e tyre janë me arsim të lartë, 39,08 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 69,33 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 30,33 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 0,34 % e tyre janë nëpunës shtetëror.

Rezulton se 58,75 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 41,25 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 4,05 % prej tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale, 0,5 % janë të dënuar për të njëjtën vepër penale, ndërsa 95,45 % janë të pa dënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Plagosja e rëndë me dashje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2018 është 11 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 11,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018, vihet re tendencë e lehtë ulje prej 0,99 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”, në krahasim me vitin 2019.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 21% të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, e në vijim, në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Durrës që përbëjnë respektivisht 12 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë rreth 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër që ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Berat është regjistruar respektivisht nga 5 % e numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Sarandë, Mat e Gjirokastrë rezultojnë respektivisht rreth 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Pogradec, Lezhë e Elbasan janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë rreth 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që prokuroritë e tjera të shkallës së parë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % gjatë vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”.

Plagosja e lehtë me dashje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2018 është 85,35 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 85,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Në vitin 2018, të dhënat statistikore tregojnë tendencën në rritje prej 5 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”, krahasuar me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje” për vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 30 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi. Në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 14 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Vlorë që përbëjnë respektivisht nga 8 % e 9 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë që përbën 7 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Fier ku janë regjistruar rreth 5 % e numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Lushnje e Shkodër që kanë regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Berat, Krujë e Lezhë kanë regjistruar respektivisht 3 % të numrit total të procedimeve, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kavajë, Pogradec, Sarandë, Mat, Kurbin, Gjirokastrë, Pukë, Përmet e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i IV “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”:

	2017					2018				
VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 91 Plagosja e rëndë nga pakujdesia	0	1	0	1	0	2	0	0	0	1
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	3	0	1	0	0	2	0	0	0	0
Totali	3	1	1	1	0	4	0	0	0	1

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale për “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” të regjistruara në vitin 2018 është rritur në 4, ndaj 3 procedimeve të regjistruara në vitin 2017. Për këtë periudhë nuk rezultojnë procedime të dërguara në gjykatë, të pandehur të regjistruar apo dërguar në gjykatë, ndërkohë që rezulton se është dënuar 1 i pandehur.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,41 %. Ky tregues për vitin 2017 ka qenë 0,85 %, pra vihet re rritje e tij për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 15,47, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 9,3.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në seksionin V të kreut të dytë të Kodit Penal “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës”.


VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	59	7	3	9	4	44	7	9	15	9
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	0	0	0	0	0	7	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	205	4	6	1	1	391	1	5	1	1
Totali	267	11	9	10	5	444	8	14	16	10

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 66,29 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, në krahasim me vitin 2017. Numri i procedimeve dërguar në gjykatë ka pësuar ulje në krahasim me vitin 2017 nga 11 në 8, numri i të pandehurve të regjistruar është rritur nga 9 në 14 dhe numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur nga 10 në 16. Rritje vërehet edhe në lidhje me

numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata nga 5 të pandehur në vitin 2017 në 10 të pandehur të dënuar në vitin 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit rezultojnë të moshës madhore, ku 75 % e përbëjnë meshkujt dhe 25 % femrat.

Në këtë grup veprash janë marrë si të pandehur edhe 5 shtetas i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 88,89 % e të pandehurve janë me arsim të lartë, me arsim të mesëm janë 8,33 % e të pandehurve dhe me arsim deri në 9 vjeçar, 2,78 % e të pandehurve.


Rezulton se 97,22 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet ndërsa pjesa tjetër në fshat, ndërsa në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Mjekimi i pakujdesshëm**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës” është 9,91 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 22 %.


Të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2018 për këtë vepër penale është ulur me 25,42 % krahasuar me vitin 2017.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):

**Shkaktimi i vetëvrasjes**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 88,06 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 76,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 90,73 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2017.

KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,36 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 0,32 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 3,94, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 3,5.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VI të Kodit Penal “Krime Seksuale”:


KRIME SEKSUALE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur	19	10	11	11	8	18	6	17	6	4
Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	7	2	6	3	3	11	2	7	2	2
Neni 102 Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura	16	10	11	10	9	11	3	7	3	3

Neni 102/a Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 103 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur	3	3	1	3	1	3	0	2	0	2
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 105 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 107 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 107/a Dhuna seksuale	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	21	20	19	21	14	18	13	15	15	11
Neni 108/a Ngacmimi seksual	36	19	24	20	17	51	18	27	18	13
Totali	102	64	72	68	52	113	42	75	44	35

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka rritje prej 10,78 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2017, ndërkohë që kemi ulje prej 34,38 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 4,17 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 35,29 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 32,69 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë dhe moshën për të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 98,48 % e të pandehurve (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 1,52 % janë femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve meshkuj, 4,62 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Në këtë grup veprash janë marrë si të pandehur edhe 2 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 50,77 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 40 % me arsim të mesëm dhe 9,23 % me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 70,37 % e të pandehurve janë të papunë, 18,52 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 11,11 % të punësuar në sektorin shtetëror.


Rezulton se 72,31 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 27,69 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 95,38 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 4,62 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohen.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur**


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” në vitin 2018 është 15,93, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 18,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori) :



Siç pasqyrohet në grafik, në vitin 2018 vihet re ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, prej 5,26 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë vepër penale:




Rezulton se në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 7 procedime penale ose 39 % që është edhe numri më i madh i regjistruar në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Vlorë janë regjistruar 3 procedime ose e shprehur në përqindje rreth 17 %, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Shkodër janë regjistruar 2 procedime penale ose 11 % e procedimeve dhe prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 1 procedim penal që përbën 6 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2018.

Ngacmimi seksual


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 45,13 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 35,3 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi krahasuar me vitin 2017.

Ecuria e kësaj vepre penale paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Në vitin 2018, në grupin e krimeve seksuale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal “Ngacmimi seksual”, prej 41,67 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë vepër penale:



Rezulton se në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë është regjistruar 37 % e totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër, që është edhe numri më i madh në shkallë vendi e konkretisht 19 procedime penale. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 5 procedime penale ose 10 %, në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 4

procedime penale ose 8 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Vlorë, Sarandë e Shkodër janë regjistruar respektivisht nga 3 procedime penale ose 6 % e procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Dibër, Gjirokastrë, Lezhë e Fier janë regjistruar respektivisht 2 procedime penale dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë është regjistruar 1 procedim. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal “Ngacmimi seksual”.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,27 % dhe për vitin 2017 ka qenë 0,28 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 2,93, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 3.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII “Vepra penale kundër lirisë së personit”.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Pr oc. Re gj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pan d dën uar
Neni 109 Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	4	0	0	0	8	7	0	1	0	1
Neni 109/a Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 109/b Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	38	14	24	19	29	29	15	11	21	18
Neni 109/c Zhdukja me forcë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	27	14	29	23	7	33	16	39	32	22
Neni 111 Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 112 Dhunimi i banesës	17	4	5	4	2	15	6	11	8	4
Totali	89	33	59	47	46	84	37	62	61	45

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 5,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi rritje prej 12,12 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 5,08 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 29,79 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 2,17 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë, 97,87 % e të pandehurve janë meshkuj (mbi 18 vjeç) dhe 2,13 % janë femra (mbi 18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,86 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 58,06 % me arsim të mesëm dhe 1,08 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 56,76 % e të pandehurve dhe të papunë 43,24 %.

Rezulton se 57,45 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 42,55 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 96,81 % e tyre janë të padënuar më pare, 1,06 % janë përsëritës për vepra penale të tjera dhe 2,13 % janë përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT


Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 8,33 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 4,5 %. Në vitin 2018 për këtë vepër janë regjistruar 7 procedime penale tregues ky në rritje ndaj 4 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2017.

Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 34,52 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 42,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2018 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” prej 23,68 %, në krahasim me vitin 2017.

Heqja e paligjshme e lirisë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 39,29 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 30,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”, në vitin 2018, prej 22,22 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas prokurorive për këtë vepër penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, ku janë regjistruar 13 procedime penale ose 39 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 5 procedime penale ose 15 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar nga 4 procedime penale ose 12 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lushnjë, Dibër, Sarandë, e Fier kanë regjistruar respektivisht nga 2 procedime penale ose 6 % të totalit, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Elbasan e Tropojë kanë regjistruar nga 1 procedim penal, ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,9 %, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ishte 0,8 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 9,82, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 8,97.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VIII të Kodit Penal “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjyk atë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 113 Prostitucioni	4	1	22	31	10	11	3	14	16	13
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	63	13	36	22	24	39	11	27	33	23
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	3	1	1	1	1	3	1	3	6	0
Neni 117 Pornografia	4	0	0	0	0	8	1	0	1	0
Neni 118 Dhunimi i varreve	15	5	4	7	2	17	1	3	1	1
Neni 119 Fyerja	0	0	0	0	0	3	0	1	0	1
Neni 120 Shpifja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	10	1	2	1	1	8	1	1	1	1
Neni 121/a Përndjekja	156	78	104	79	66	191	116	137	116	78
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	2	0	0	0	0	1	1	0	1	0
Totali	258	99	169	141	104	282	135	186	175	118

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 9,30 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi rritje prej 36,36 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017, rritje në lidhje me numrin e të pandehurve regjistruar për këtë grup veprash penale prej 10,06 % përkundrejt këtij totali në vitin 2017, rritje me 24,11 % të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë dhe rritje me 13,46 % të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, krahasuar me vitin 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 74,78 % janë meshkuj ndër të cilët 1,2 % të mitur dhe 25,22 % femra ndër të cilat 1,79 % të mitura.

Në këtë grupveprash rezultojnë 4 të pandehur të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 42,34 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 44,6 % me arsim të mesëm dhe 13,06 % të pandehur me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore, rezulton se nga sektori privat janë regjistruar 51,22 % e të pandehurve dhe 48,78 % rezultojnë të papunë.

Rezulton se 78,83 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 21,17 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 97,29 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2,26 % e tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 0,45 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shfrytëzimi i prostitucionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 13,83 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 24,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në vitin 2018 me 38,09 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit është regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Vlorë, konkretisht 18 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 15% të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 13 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 10 % të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 8 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Lushnje e Lezhë kanë regjistruar respektivisht rreth 5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Sarandë e Shkodër kanë regjistruar 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi e ndërkaq në prokuroritë e tjera nuk është regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”.

Përndjekja


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 67,73 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 60 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2018 janë regjistruar 22,44 % më shumë procedime penale sesa në vitin 2017 për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) për veprën penale të përndjekjes:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve për veprën penale të përndjekjes është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, konkretisht 53 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 6 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Elbasan, Shkodër, Berat e Korçë kanë regjistruar 5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Fier kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Sarandë kanë regjistruar rreth 2 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lushnjë, Pogradec, Dibër, Tropojë, Pukë, Kavajë, Krujë e Kurbin kanë regjistruar respektivisht një numër procedimesh më të ulët se 1 % të totalit. Ndërkaq në prokuroritë e shkallës së parë Përmet, Kukës e Mat nuk është regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 4,3 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 4,65 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 47 ndërsa në vitin 2017 ka qenë 50,8.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IX-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal “Vepra Penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”:

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES ²¹	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	80	18	40	18	11	62	20	33	20	12
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	43	19	33	19	18	56	19	28	21	13
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë	0	0	0	0	0	2	0	0	0	1
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	6	3	5	3	0	7	3	2	3	1
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	8	0	1	0	0	5	0	1	0	1
Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1


²¹ Veçuar nga ky grup kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit dhe trajtuar te grupveprat penale të korrupsionit, si dhe trafikimi i të miturve i cili është trajtuar në grupveprat penale lidhur me trafiket.

Neni 129 Shtytja e të miturve në krim	3	1	2	1	0	2	0	1	0	0
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë 130/a Dhuna në familje	11	4	7	4	2	6	1	2	1	5
	1310	1057	1279	1104	982	1209	1007	1195	1069	826
Totali	1462	1102	1367	1149	1013	1349	1050	1262	1114	860

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 7,73 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi ulje prej 4,72 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 7,69 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 3,05 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 15,10 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër fëmijëve martesës dhe familjes për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

92,68 % e të pandehurve janë meshkuj ku 1,27 % e përbëjnë të miturit, dhe 7,32 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë 3,22 % të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 60,88 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 36,22 % me arsim të mesëm dhe 2,90 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 1,19 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 29,33 % e të pandehurve dhe të papunë 69,48 %. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 50,51 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 49,49 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 90 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 3,86 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 6,14 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Braktisja e fëmijëve të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2018 është 4,60 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 5,47 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 22,5 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur”, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Keqtrajtimi i të miturit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2018 është 4,15 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 2,9 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 30,23 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Ndërsa tendenca në vitet 2014-2018 për këtë vepër, paraqitet si vijon:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër, të dhënat paraqiten në grafikun në vijim, ku vërehet se numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë që përbën 39 % të procedimeve të regjistruara.




Dhuna në familje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” është 89,62 % për vitin 2018 është pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2017, gjatë të cilit rezulton në masën 89,6 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë vepër në vitin 2018 është 42,12, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 45,54.

Ecuria e kësaj vepre penale, për vitet 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 7,71 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të dhunës në familje është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 36 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim sipas numrit më të madh të procedimeve të regjistruara renditen, prokuroria e shkallës së parë Fier që ka regjistruar 8 % të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar rreth 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Fier që kanë regjistruar rreth 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Korçë që ka regjistruar rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Lushnje, Berat e Vlorë që kanë regjistruar rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a “Dhuna në familje”, ku numri më i ulët për vitin 2018 rezulton në prokuroritë e shkallës së parë Kukës e Përmet.

VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e X-të të Kreut të dytë të Kodit Penal, veprat penale kundër lirisë së besimit, ku siç vërehet gjatë vitit 2018 është regjistruar e dërguar në gjykatë 1 procedim penal me 1 të pandehur për veprën penale “Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit”.

**VEPRA PENALE KUNDËR
LIRISË SË BESIMIT**

	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE
VJEDHJA E PASURISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 33,21 %, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 33,9 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 363,20, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 371.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e parë të Kreut të tretë të Kodit Penal, “Vjedhja e Pasurisë”.

	2017					2018				
VJEDHJA E PASURISË²²	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 134 Vjedhja	9514	1000	1417	1161	1056	9219	908	1209	1081	839
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	127	58	62	69	56	114	41	69	47	45
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit	13	5	4	6	3	14	4	5	5	12
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	793	547	674	522	502	918	731	625	731	504
Neni 137 /a Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0


²² Veçuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiket

Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	4	1	4	4	4	2	0	0	0	0
Neni 139 Vjedhja me dhunë	187	53	95	78	62	118	48	68	66	56
Neni 140 Vjedhja me armë	22	5	10	6	20	35	7	13	9	3
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	4	2	1	3	2	4	2	8	3	1
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	2	3	3	5	5	0	0	0	0	1
Totali	10666	1674	2270	1854	1710	10425	1741	1997	1942	1461


TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 2,26 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë dhe një rritje prej 4 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 12 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,75 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,56 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



Për vitin 2018 procedimet penale për veprat e këtij seksioni krahasuar me vitin 2017 paraqesin tendencat si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

92,44 % e të pandehurve janë meshkuj ku 10,85 % e përbëjnë të miturit, dhe 7,56 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë të jenë 16,34 % të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 62,77 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 33,82 % me arsim të mesëm dhe 3,4 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 2,1 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 14,4 % e të pandehurve dhe të papunë 83,5 %.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 21 shtetas të huaj.

Rezulton se 54,74 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 45,26 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 81,58 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 12,11 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 6,31 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vjedhja


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 88,43 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2016 ka qenë 89,2 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat vihet re se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2018 janë ulur me 3,10 % në krahasim me vitin 2016.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 37 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 9 %, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Fier janë regjistruar përkatësisht 7 % dhe 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lushnjë janë regjistruar 4 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”.

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2018 është 1,09 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues ka qenë 1,2 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore në vitin 2018 vërehet tendenca në ulje prej 10,24 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2018 për këtë veprë, rezulton si më poshtë vijon:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që përbën 33 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, në vijim prokuroria e shkallës së parë Korçë me 11 % të totalit të procedimeve dhe prokuroria e shkallës së parë Pukë me 10 % të totalit të

procedimeve të regjistruara. Prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar një numër procedimesh që përbën secila 9 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 8 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Fier kanë regjistruar respektivisht 7 % dhe 6 % të totalit të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Lushnje, Shkodër e Vlorë kanë regjistruar rreth 3 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Kavajë kanë regjistruar 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruar për këtë vepër dhe prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kurbin e Pogradec kanë regjistruar rreth 1 % të numrit total të procedimeve. Ndërkaq, prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Kukës, Lezhë, Mat, Përmet, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 135 të Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”.

Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2018 është 0,13 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues ka qenë 0,12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2018 vërehet tendenca në rritje të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit”, në krahasim me vitin 2017, nga 13 procedime në 14 procedime të regjistruara.

Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2018 është 8,81 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 7,4 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” i Kodit Penal, ka një rritje prej 15,76 % në krahasim me vitin 2017.

Vjedhja me dhunë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2018 është 1,13 % ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 1,75 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka ulje prej 36,90 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”, në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2018 për këtë vepër, rezulton si më poshtë vijon:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që përbën 36 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, në vijim prokuroria e shkallës së parë Durrës me

14 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Fier me 7 % të totalit të procedimeve të regjistruara, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Vlorë, që kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën 6 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 5 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Berat e Korçë kanë regjistruar respektivisht 4 % të totalit të procedimeve. Ndërkohë prokuroritë e shkallës së Gjirokastër, Krujë, Lezhë e Sarandë kanë regjistruar nga një numër procedimesh që përbën rreth 3 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së Lushnje e Pogradec kanë regjistruar nga një numër procedimesh që përbën rreth 2 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kavajë, Kukës, Kurbin, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar rreth 1 % të numrit total të procedimeve e prokuroritë e shkallës së parë Mat e Përmet nuk kanë regjistruar procedime penale për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”.

Vjedhja me pasojë vdekjen

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2018 është 0,038 % ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 0,037 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore të vitit 2018 vërehet se numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal “Vjedhja me pasojë vdekjen” është i njëjtë me një vit më parë, konkretisht 4 procedime të regjistruara.

MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,61 %, ndërsa në vitin 2017 është 3,1 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 28,57, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 34,3.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e II, të Kreut të Tretë të Kodit Penal “Mashtrimet”:

MASHTRIMET	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. d. Regj .	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand d dën uar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pan d. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënu ar
Neni 143 Mashtrimi	584	217	213	237	205	704	212	207	292	157
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale	3	0	0	0	0	4	0	0	0	0
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 143/a/2 Përdorimi i paaautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/3 Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paaautorizuar e tyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paaautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë	1	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 144 Mashtrimi në subvencione	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 144/a	11	0	22	15	1	4	11	22	28	12
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	355	395	286	387	478	70	83	49	86	111
Neni 146 Mashtrimi në kredi	11	5	7	10	12	13	5	7	17	9
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit	3	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale	17	4	8	4	3	19	3	3	4	0
Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	987	621	537	653	699	820	314	289	427	289

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 numri i procedimeve të regjistruara për veprat penale të mashtrimit ka një ulje prej 16,92 % krahasuar me vitin 2017 e ndërkaq kemi ulje prej 49,44 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 46,18 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 34,61 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 58,66 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Rezulton se 79,31 % e të pandehurve janë meshkuj (ndër të cilat rezulton 1 i mitur) dhe 20,69 % e të pandehurve janë femra.

Për sa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 33,83 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 50,75 % me arsim të mesëm dhe 15,42 % me arsim të lartë.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 13 shtetas të huaj.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 1,89 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror, në sektorin privat rezultojnë 34,43 % e të pandehurve dhe 63,68 % janë të papunë.

Rezulton se 66,82 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 33,18 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 3,20 % e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën vepër, 2 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, ndërsa 94,80 % janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 85,85 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 59,2 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Në këtë grup veprash penale vihet re një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, në vitin 2018, prej 20,55 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, gjatë vitit 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, edhe për këtë vepër penale numri më i madh i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 51 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Elbasan e Shkodër që kanë regjistruar respektivisht 4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Sarandë e Lezhë që kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Lushnjë, Korçë, Berat, Kavajë, Gjirokastrë, Pogradec, Kukës, Krujë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Pukë, Përmet, Dibër, Kurbin e Mat rezultojnë se janë regjistruar 1 % i numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”.

Mashtrimi në sigurime


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 8,5 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 36 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori);



Nga të dhënat statistikore vihet re ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, në vitin 2018. Koncretisht, numri i procedimeve është ulur me 80,28 % krahasuar me një vit më parë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, gjatë vitit 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të mashtrimit në sigurime është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 52 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim rezultojnë në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë që ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Shkodër që kanë regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, në prokuroritë e shkallës së parë Mat që ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Pukë, Elbasan, Kurbin që kanë regjistruar respektivisht 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Ndërkohë në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Lushnje e Krujë është regjistruar një numër procedimesh më i vogël se 1,5 % e numrit total të procedimeve penale në shkallë vendi. Në prokuroritë e tjera nuk rezultojnë asnjë procedim i regjistruar në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”.

Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit për vitin 2018 është 2,3 %, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 1,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, në vitin 2018, prej 11,76 % krahasuar me vitin 2017.

SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018, përkundërt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 3,97 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 4,2 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 43,37, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 46,3.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e III, të Kreut të III të Kodit Penal:


	2017					2018				
SHKATËRRIMI I PRONËS	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	432	49	96	61	34	514	35	78	40	28
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	704	21	42	21	17	426	24	33	24	13
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	43	1	1	0	0	51	2	4	2	1
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbytje	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera	8	0	2	0	0	7	1	3	3	0

Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	10	0	1	0	0	8	0	0	0	0
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	24	0	1	0	1	27	1	2	1	1
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes	1	0	0	0	0	5	0	1	0	0
Neni 158	2	0	1	0	0	1	0	0	0	1
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit	44	16	21	16	8	150	57	73	57	35
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore	4	0	0	0	1	3	0	0	0	0
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	56	3	11	3	7	53	2	9	3	3
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1332	90	176	101	68	1245	122	203	130	82

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka trend ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të shkatërrimit të pronës në krahasim me vitin 2017, e konkretisht ulje 6,53 %. Ndërkohë vërehet rritje 35,56 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017, rritje 15,34 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 28,71% dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,59 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit 8,33 % janë femra dhe 91,67 % meshkuj, ndër të cilët 2,3 % kanë qenë të pandehur të mitur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 51,82 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 43,80 % me arsim të mesëm dhe 4,38 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektor shtetëror janë regjistruar 1,22 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë 40,24 % e të pandehurve dhe 58,54 % janë të papunë.

Rezulton se 52,55 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 47,55 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë, 95,6 % e të pandehurve, ndërsa 4,4 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shkatërrimi i pronës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 41,29 % për vitin 2018, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 32,4 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës" në vitin 2018 është në rritje me 18,98 % në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2018, të dhëna të detajuara jepen në grafikun e mëposhtëm:




Sikurse vërehet edhe nga paraqitja grafike për këtë vepër penale numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Tiranë, 22 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi e më pas prokuroria e shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 14 % të numrit total të procedimeve. Prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 11 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat e Fier kanë regjistruar 10 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Sarandë kanë regjistruar respektivisht rreth 5 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 4 % të procedimeve, ndërsa prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më se 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 150 të Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës”.

Shkatërrimi i pronës me zjarr

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 34,22 % për vitin 2018, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 52,85 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2018, vihet re tendenca në ulje me 39,49 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, në krahasim me vitin 2017.

Shkatërrimi i pronës me eksploziv


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2018 është 4,1 %, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ka qenë 3,2 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, prej 18,6 % në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2018, të dhëna të detajuara jepen në grafikun e mëposhtëm:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që ka regjistruar 12 procedime penale ose 23 % të totalit të numrit të procedimeve dhe prokuroria e shkallës së parë Krujë që ka regjistruar 9 procedime ose 17 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 8 procedime penale, që përbëjnë 16 % të numrit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Lezhë e Shkodër kanë regjistruar 3 procedime penale ose 6 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Lushnjë, Mat, Durrës e Dibër kanë regjistruar nga 2 procedime ose 4 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Tropojë e Fier kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose rreth 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruara. Ndërkaq, prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”.

Shkatërrimi i rrjetit elektrik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 2,17 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017, pesha specifike e kësaj vepre është 1,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”, prej 12,5 %, krahasuar me vitin 2017.

Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit” është 12 % për vitin 2017, ndërkohë që në vitin 2017, pesha specifike e kësaj vepre është 3,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal, prej 3,4 herë, krahasuar me vitin 2017.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale për këtë vepër, të dhënat e paraqitura në grafikun në vijim tregojnë se, numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Tiranë, 44 procedime ose 29 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi e më pas prokuroria e shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 19 procedime ose 13 % dhe prokuroria e shkallës së parë Sarandë që ka regjistruar 13 procedime ose 9 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 10 procedime ose 7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar nga 6 procedime penale ose 4 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa prokuroria e shkallës së parë Kukës ka regjistruar nga 5 procedime penale ose 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë Lushnje, Elbasan, Krujë, Shkodër, Fier, Kavajë, Lezhë, Mat e Tropojë kanë regjistruar respektivisht më pak se 2 % të numrit total të procedimeve e ndërkaq, prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rjetit të ujësjetësit”.



VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,35 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 0,14 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 3,87, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 1,5.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IV të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare”.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave	7	0	1	0	1	10	4	2	4	2
Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme	1	0	2	0	0	0	0	0	0	0
Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme	4	2	2	3	0	3	1	1	1	1
Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	27	6	12	6	8	95	47	61	48	19
Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës	3	1	3	2	0	2	1	0	1	2
Totali	44	9	20	11	9	111	53	64	54	24

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka rritje të ndjeshme në të gjithë treguesit statistikorë në krahasim me vitin 2017 për veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare. Kështu numri i procedimeve penale të regjistruara dhe numri i të pandehurve të regjistruar është rritur respektivisht 2,5 herë dhe 3,2 herë, numri i procedimeve të dërguara në gjykatë dhe numri i të pandehurve të dërguar gjykatë është rritur respektivisht 5,9 herë dhe 4,9 herë, krahasuar me vitin 2017, ndërkohë që numri i të pandehurve të dënuar është rritur 2,7 herë përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, tregojnë se, 85,45 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 15,55 % femra, të moshës madhore.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 9,62 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 71,15 % me arsim të mesëm dhe 19,23 % të pandehur me arsim të lartë.


Lidhur me vendbanimin rezulton se 86,27 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 13,73 % prej tyre në fshat. Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Punësimi i paligjshëm


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” në vitin 2018 është 85,59 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 61 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë e lartë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”. Kështu në vitin 2018 janë regjistruar 95 procedime penale, kundrejt 27 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2017 ose 3,5 herë më shumë.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara gjatë vitit 2018:



Sikurse vërehet edhe nga paraqitja grafike për këtë vepër penale numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Shkodër, 34 % të procedimeve

penale të regjistruara në shkallë vendi e më pas prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Pukë që kanë regjistruar përkatësisht 14 % dhe 11 % të numrit total të procedimeve. Prokuroria e shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 8 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 6 %, prokuroria e shkallës së parë Berat 5 %, prokuroritë e shkallës së parë Mat, Vlorë e Tropojë kanë regjistruar nga 4 procedime penale ose 4 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lushnje e Kavajë kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 2 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Gjirokastër e Kurbin kanë regjistruar rreth 1 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,12 %, tregues pothuajse i njëjtë edhe për vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 1,29, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 1,3.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:


VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 170/c Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare	4	1	1	1	1	10	7	10	7	6
Neni 170/ç Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare	34	22	40	24	17	27	20	18	20	9
Totali	38	23	41	25	18	37	27	28	27	15

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, në vitin 2018 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare në krahasim me vitin 2017 ka pësuar një ulje me 2,63 % dhe ulje me 31,71 % të numrit të të pandehurve regjistruar.

Numri i procedimeve të dërguara gjyqit është rritur me 17,39 % ndërsa numri i të pandehurve dërguar gjyqit me 8 %, ndërkohë që të pandehurit e dënuar nga gjykata rezultojnë me ulje 16,67 % në krahasim me vitin 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore gjatë vitit 2018 vihet re se 96 % e tyre janë meshkuj madhorë dhe 4 femra.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezultojnë të 89% janë të punësuar në sektorin privat dhe 11 % të papunë.


Rezulton se 79 % e të pandehurve janë me vendbanim në qytet ndërsa 21 % e tyre me vendbanim në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, të gjithë të pandehurit rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Edhe në vitin 2018, në këtë grup veprash peshën më të madhe e ka vepra penale e parashikuar nga neni 170/ç i Kodit Penal, "Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare", që përbën 72,97 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë grup. Për këtë vepër vërehet tendenca në ulje me 20,59 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara, krahasuar me vitin 2017.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,61 %, ndërsa për vitin 2017 është 0,98 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 6,65, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 10,7.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:


KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj.	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj.	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj.	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	3	0	4	0	0	3	1	2	1	1

Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	23	8	13	13	11	27	14	26	16	18
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar	3	1	3	1	0	5	3	6	3	1
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	168	30	108	42	19	73	37	30	56	23
Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore	2	1	3	2	2	0	0	0	0	0
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	10	2	4	1	4	10	4	2	4	1
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	52	34	44	40	35	45	35	36	40	26
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	7	3	8	3	4	5	5	5	6	2
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	38	30	38	31	16	23	21	16	21	23
Neni 179/b Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 179/ç Kontrabanda e kapitenit, pilotit ose ekuipazhit	1	0	1	0	1	0	0	0	0	0
Totali	308	110	227	134	93	191	120	123	147	95

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 37,99 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi rritje prej 9,10 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 45,81 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është rritur me 9,70 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 2,15 % krahasuar me vitin 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve rezulton se 96,30 % e të pandehurve janë të rritur (mbi 18 vjeç) meshkuj dhe 3,70 % të rritur femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 18,28 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 69,35 % me arsim të mesëm dhe 12,37 % të pandehurve janë me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2018 gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 3,17 % e të pandehurve, ndërkohë të punësuarit në sektorin privat zënë 87,30 % të numrit të të pandehurve dhe 9,53 % rezultojnë të papunë.

Po kështu rezultojnë edhe 13 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2018.


Sa i përket vendbanimit, 81,35 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 18,65 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 98,45 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, vetëm 0,5 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale dhe 1,05 % përsëritës për vepra të tjera të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë**


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në vitin 2018 në grupin e krimeve në fushën e doganave është 14,14 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues ka qenë 7,5 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në vitin 2018, prej 17,39 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë sipas prokurorive të shkallës së parë ku ka pasur procedime penale të regjistruara:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra që paguhet akcizë është në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec, 7 procedime penale që përbëjnë 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Shkodër ku janë regjistruar përkatësisht 15 % dhe 11 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër dhe Tiranë kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Lezhë e Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 4 % të procedimeve në shkallë vendi ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”.

Kontrabanda me mallra të tjera


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 38,22 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 54,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re se procedimet penale të regjistruara për këtë veprë janë ulur me 56,55 %, konkretisht në vitin 2018 janë regjistruar 73 procedime penale kundrejt 168 procedimeve të regjistruara në vitin 2017 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera është në prokurorinë e shkallës së parë Durrës ku janë regjistruar përkatësisht 22 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 19 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 14 % e totalit të procedimeve penale, në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 12 % e totalit të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 7 % e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Fier e Gjirokastrë janë regjistruar 4 % e procedimeve penale, në prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Tropojë janë regjistruar përkatësisht 2 % e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Krujë, Lezhë, Lushnjë, Shkodër e Vlorë janë regjistruar përkatësisht nga 1 procedime ose rreth 1 % e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime penale gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal.

Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2018 vihet re tendenca në ulje me 13,46 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 23,56 % të procedimeve të regjistruara.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2018 vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 12,04 % të procedimeve të regjistruara.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për vitin 2018 janë regjistruar 23 procedime penale ndaj 38 procedimeve të regjistruara në vitin 2017, që përbën tendencë në ulje me 39,47 %.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,06 %, ndërsa për vitin 2017 është 0,85 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 11,60.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun III, Seksionin e VI “Veprat penale në lidhje me taksat e tatimet” i Kodit Penal.


VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	170	69	97	83	65	216	55	76	64	51
Neni 180/a	22	10	10	10	5	21	7	9	9	4
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	67	25	29	27	26	73	30	31	40	25
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	4	1	2	2	0	5	1	2	1	1
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	1	0	0	0	1	2	2	1	2	1
Neni 182/a	2	2	1	2	0	16	11	11	11	6
Totali	266	107	139	124	97	333	106	130	127	88

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 25,19 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me

taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi ulje prej 0,93 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 6,47 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 2,42 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 9,28 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit e regjistruar, të rritur (mbi 18 vjeç) janë 13,28 % femra dhe 86,72 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 14,63 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 58,54 % me arsim të mesëm dhe 26,83 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për këto vepra rezultojnë të marrë si të pandehur edhe 4 shtetas të huaj.

Lidhur me vendbanimin, rezulton se 77,63 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 22,37 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 98,02 % janë të padënuar më parë, 1,32 % janë të dënuar më parë për të njëjtën vepër dhe 0,66 % e tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Fshehja e të ardhurave


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 64,86 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 63,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore të vitit 2018 vërehet tendenca në rritje prej 27,06 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave” në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë vepër në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2018 në shkallë vendi:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të fshehjes së të ardhurave është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar 24 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër, ku janë regjistruar 15 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Berat ku janë regjistruar përkatësisht 8 % dhe 7 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Dibër, Fier e Korçë ku janë regjistruar respektivisht rreth 6 % e procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Kurbini ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Pogradec, Gjirokastrë, Durrës, Sarandë e Lushnje kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë Vlorë, Lushnje, Tropojë e Përmet kanë regjistruar më pak se 2,5 % të totalit të procedimeve penale në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Krujë, Mat e Pukë nuk kanë regjistruar procedime penale në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”.

Mospagimi i taksave dhe i tatimeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 21,92 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 25,2 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”, prej rreth 8,96 % krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2017.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundërt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,26 % po aq sa në vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 2,86, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 2,8.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu III, Seksioni VII “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” i Kodit Penal:


	2017					2018				
FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. d. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjyk atë	Nr. pand . Regj	Nr. Pand . në gjyk.	Nr. Pand dënu ar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	78	23	54	28	18	80	36	29	40	24
Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlerë	3	0	0	0	1	2	2	5	3	3
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Totali	81	23	54	28	19	82	38	34	43	27
---------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje të lehtë prej 1,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2017 dhe rritje prej 65,22 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 37,04 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 53,57 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 42 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 95,91 % janë të rritur dhe 4,08 % të mitur. Lidhur me gjininë e tyre rezulton se 91,84 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 4,08 % femra.

Për këto vepra rezultojnë të marrë si të pandehur edhe 3 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 34,04 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 55,32 % me arsim të mesëm dhe 10,64 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në lidhje me gjendjen shoqërore rezulton se 38,88 % e të pandehurve kanë qenë të papunë, 55,56 % të punësuar në sektorin privat dhe 5,56 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 76,09 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 23,91 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 10,64 % rezultojnë përsëritës për vepra penale të ndryshme, ndërsa pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i monedhave


Për vitin 2018 pesha specifike e kësaj vepre përbën 97,56 % të procedimeve të regjistruara për grupin e veprave penale “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë”, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 96,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore në vitin 2018 vërehet tendencë e lehtë rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”, prej 2,56 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 45 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Vlorë kanë regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Korçë, Krujë, Lezhë, Lushnjë e Kurbin kanë regjistruar nga 3 % të procedimeve, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Përmet, Kavajë, Sarandë e Shkodër kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 3,50 %, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 4,2 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 37,94, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 46.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII të Kreut të III të Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	650	146	209	186	171	618	141	157	182	142
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollorë	22	11	12	12	23	32	15	12	40	20
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	8	5	6	6	3	9	4	4	4	7
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	258	131	190	138	89	281	119	205	135	88
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	377	217	321	263	164	140	56	85	62	97
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile	6	3	1	3	2	6	1	2	1	2
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	3	0	0	0	0	3	2	8	5	5
Totali	1324	513	739	608	452	1089	339	473	430	361

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje të gjithë treguesve lidhur me këtë grup vepra penale, e konkretisht: ulje prej 17,75 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2017, ulje e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 33,92 %, ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 35,99 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 29,28 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,13 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të dhënat lidhur me gjininë e të pandehurve tregojnë se 83,43 % e tyre janë meshkuj dhe 16,57 % janë femra.

Në vitin 2018 rezultojnë të pandehur 48 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 24,47 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 54,68 % me arsim të mesëm dhe 20,84 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë 33,61 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin privat janë 25,28 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër prej 41,11 % e të pandehurve, rezultojnë të papunë.

Rezulton se 66,54 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 33,46 % e të pandehurve në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 94,31 % e tyre janë të padënuar më parë, 5,17 % të dënuar për vepra penale të ndryshme dhe 0,52 % rezultojnë të dënuar për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i dokumenteve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 56,75 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 49 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet ulje prej 4,92 % e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, “Falsifikimi i dokumenteve”.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 30 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Fier kanë regjistruar respektivisht 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Sarandë kanë regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër, Berat e Korçë kanë regjistruar respektivisht rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Lezhë kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Lushnje, Krujë, Kukës, Kurbin, Kavajë, Përmet, Tropojë, Dibër, Pukë e Mat kanë regjistruar në vitin 2018 një numër procedimesh më të ulët se 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.

Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i Dokumenteve” për vitin 2018 është 25,80 %, ndërkohë që vitin 2017 është 19,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2018 procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, kanë pësuar një rritje prej 8,91 % krahasuar me një vit më parë.

Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 12,86 % për vitin 2018, ndërkohë që për vitin 2017 rezulton 28,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore, në vitin 2018 vërehet ulje prej 62,86 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, në krahasim me vitin 2017.

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e IX-të të Kreut të tretë të Kodit Penal, veprat penale në fushën e falimentimit, ku siç vërehet gjatë vitit 2018 nuk është regjistruar asnjë procedim penal.

VEPRA PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 193 Falimentimi i provokuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 194 Fshehja e gjendjes së falimentimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 195 Fshehja e pasurisë pas falimentimit	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 196 Shkelja e detyrimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,60 %, ndërsa për vitin 2017 është 0,53 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 6,58, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 5,8.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e III, seksioni X i Kodit Penal “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”:

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjyk. të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pan d dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjyk. të	Nr. pand. Regj	Nr. Pan d. në gjyk. .	Nr. Pan d dënu ar


Neni 197 Organizimi i lotarive të palejuara
 Neni 197/a Paracaktimi i rezultatit në garat sportive
 Neni 197/b Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive
 Neni 198 Vënia në dispozicion e lokaleve për lojërë të palejuara
Totali

157	81	127	85	50	183	117	136	120	98
2	0	1	0	0	1	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	4	7	4	2	5	1	3	3	2
167	85	135	89	52	189	118	139	123	100

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, në krahasim me vitin 2017 me 13,17 %, rritje të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 38,82 %, rritje të numrit të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale me 2,96 % përkundrejt këtij totali në vitin 2017, rritje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 38,20 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 93,31 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit rezultojnë të gjithë meshkuj të rritur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 28,69 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 63,11 % me arsim të mesëm dhe 8,20 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Sa i përket gjendjes shoqërore, të punësuar në sektorin privat rezultojnë 59,38 % e të pandehurve dhe 40,62 % rezultojnë të papunë.

Nga treguesit vërehet se 57,35 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 42,65 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 95,56 % janë të padënuar më parë, 1,48 % e tyre rezultojnë të dënuar për të njëjtën vepër dhe 2,96 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi i lotarive të palejuara


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” është 96,83 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 94 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendencë e lehtë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i lotarive të palejuara”, në vitin 2018, me 16,56 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i lotarive të palejuara”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Korçë që përbën 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar 17 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Lushnjë ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve, ndërsa prokuroritë Tropojë e Durrës kanë regjistruar secila një numër procedimesh që përbën rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Kurbin, Pogradec, Lezhë e Fier kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të totalit të procedimeve, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Dibër, Krujë e Mat kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 2 % të numrit total të procedimeve

në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i lotarive të palejuara”, në vitin 2018.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 4,75 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues ka qenë 6,7 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 51,95, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 73,2.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin XI, të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra Penale që cenojnë regjimin juridik të tokës”.

RREGJIMI JURIDIK I TOKËS	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	10	0	1	0	0	16	3	5	3	3
Neni 199/a Ndërtimi i paligjshëm	1987	943	1505	955	519	1310	854	748	851	797
Neni 199/b Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm	2	6	15	10	10	1	3	7	11	7
Neni 200 Pushtimi i tokës	107	39	62	40	23	164	47	78	58	44
Totali	2106	988	1583	1005	552	1491	907	838	923	851

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 29,20 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës në krahasim me vitin 2017 dhe ulje prej 8,20 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 47,06 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 8,16 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 54,17 % krahasuar me vitin 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër regjimit juridik të tokës për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të gjithë të pandehurit të rritur ku 5,67 % e përbëjnë femrat dhe 94,33 % meshkujt.

Rezulton 1 shtetas i huaj i pandehur për këto vepra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,04 % janë me arsim të mesëm, 4,36 % të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër prej 55,60 % me arsim 9 vjeçar.

Në sektorin privat rezultojnë të punësuar në sektorin privat 35,57 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 1,93 % dhe pjesa tjetër e të pandehurve prej 62,50 janë të papunë.


Nga treguesit vërehet se 40,15 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 59,85 % prej tyre në fshat. Pra për këtë grup vërehet tendenca më e lartë në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë dhe rreth 1 % e të pandehurve janë të dënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Ndërtimi i paligjshëm**


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që cenojnë regjimin juridik të tokës është 87,86 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 94,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga paraqitja grafike vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm” në vitin 2018 prej 34,07 % në krahasim me vitin 2017.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Durrës që përbëjnë 16 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në vijim prokuroria e shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat e Krujë kanë regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Fier kanë regjistruar nga 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Tropojë, Lushnje, Lezhë, Korçë e Kurbin kanë regjistruar respektivisht 2 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Pogradec, Kukës, Gjirokastër, Pukë e Përmet kanë regjistruar një numër procedimesh rreth 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Mat nuk ka regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm”.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,79 %, ndërkohë që për vitin 2017 është 0,69 %. Pra vihet re rritje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 8,60, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 7,5.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 201 Ndotja e ajrit	20	13	28	17	11	62	38	50	48	40
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 203 Ndotja e ujërave	5	1	1	2	0	9	2	2	4	0
Neni 204 Peshkim i ndaluar	8	5	11	8	3	6	5	7	8	6
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	105	20	46	24	17	143	29	84	35	20
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	20	4	3	3	1	10	2	5	3	5
Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	45	0	2	0	0	12	1	1	1	1
Neni 206/b Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	13	2	6	2	0	5	1	1	3	1
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	216	45	97	56	32	247	78	150	102	73

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 14,35 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2017 dhe rritje prej 73,33 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 54,64 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 82 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me rreth 2,3 herë përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit, janë meshkuj të rritur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 56,25 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 38,39 % me arsim të mesëm dhe 5,36 % e të pandehurve janë me arsim të lartë.

Për këto vepra rezultojnë 2 shtetas të huaj të pandehur.

Të punësuar në sektorin privat rezultojnë 36,36 % e të pandehurve dhe të papunë rezultojnë të jenë 63,64 %.

Ndërsa lidhur me vendbanimin rezulton se 36,36 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 63,64 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 87,28 % janë të padënuar më parë, 11,82 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 0,9 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndotja e ajrit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 25,10 % për vitin 2018, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 9,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2018, vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit” në krahasim me vitin 2017, prej 3,1 herë nga 20 në 62 procedime të regjistruara.

Prerja e paligjshme e pyjeve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” për vitin 2018 është 57,89 %, ndërsa në vitin 2017, 48,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, në vitin 2018 prej 36,19 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Shkodër kanë regjistruar numrin më të madh të procedimeve penale për këtë vepër, 18 të tilla ose 13 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar respektivisht 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi për këtë vepër. Prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Berat e Korçë kanë regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Kukës e Tropojë kanë regjistruar respektivisht 5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Pogradec, Fier, Krujë, Mat, Gjirokastrë e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve, ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë Kavajë, Lushnjë, Përmet, Pukë dhe Vlorë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES

dhe

KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA

Pesha specifike që zënë krimet kundër rendit kushtetues dhe krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018, është 0,016 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 0,009 %.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:

KREU V - KREU VI	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Krime kundër Pavarësisë e Rendit Kushtetues	3	0	0	0	0	5	0	0	0	0
Krime që cenojnë Marrëdhëniet me Shtetet e tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	3	0	0	0	0	5	0	0	0	0

Krime kundër rendit kushtetues

Të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2018 janë regjistruar 5 procedime penale për krime kundër rendit kushtetues, e konkretisht:

1 procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 210 i Kodit Penal “Marrëveshja për dorëzim territori”.

1 procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 217 i Kodit Penal “Marrja e shpërblimeve”.

3 procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 225 i Kodit Penal “Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese”.

VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

Pesha specifike që zënë veprat me qëllime terroriste në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2018 është 0,013 %, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ka qenë 0,019.

VEPRA PENALE ME QËLLIME TERRORISTE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykat ë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pan d dënu ar
Neni 230 Vepra me qëllime terroriste	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/a Financimi i terrorizmit	3	0	0	0	0	4	0	0	0	0
Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 231 Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 232 Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/a Organizata terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/b Banda e armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	6	0	0	0	1	4	0	0	0	0

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se totali i procedimeve të regjistruara për vepra penale me qëllime terroriste në vitin 2018 është 4, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 6.

Prokuroria në vitin 2018 ka regjistruar 4 procedime penale për nenin 230/a të Kodit Penal “Financimi i terrorizmit”.

VEPRA PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR DHE ORGANIZATA KRIMINALE

Pesha specifike që zënë veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2018 është 0,13 %, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 0,054 %.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:


	2017					2018				
KRIMI I ORGANIZUAR	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. Pand. Regj	Nr. Pand. për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 333 Organizata kriminale	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Neni 333/a Grupi i strukturuar kriminal	16	7	33	45	30	41	6	70	30	51
Neni 334 Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	1	0	1	0	0	0	0	0	0	9
Totali	17	8	34	46	30	41	6	70	30	60

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë regjistruar 41 procedime penale me 70 të pandehur për vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të gjitha këto procedime të regjistruara për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”. Ndërsa në vitin 2018 rezultojnë 17 procedime të regjistruara për këto grup vepra penale.

Ndërkaq në vitin 2018, 6 procedime penale me 30 të pandehur janë dërguar në gjykatë dhe janë dënuar 60 të pandehur për këto vepra penale.

Grafikisht tendenca e veprave penale të krimit të organizuar për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit janë meshkuj, të rritur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 9,47 % janë me arsim të lartë, 84,21 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe 6,32 % me arsim 9-vjeçar.

Rezultojnë 8 shtetas të huaj ndër të pandehurit për këto grupvepra.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 11,05 % e të pandehurve, në sektorin privat janë punësuar 75,79 % e të pandehurve, ndërsa 13,16 % e tyre rezultojnë të papunë.

Lidhur me vendbanimin rezulton se 72,63 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 27,37 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 4,21 % rezultojnë përsëritës për vepra penale të ndryshme ndërsa pjesa tjetër, janë të padënuar më parë.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËRORE TË KRYERA NGA SHETASIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,98 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 1,95 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 21,60, ndërsa në vitin 2016 ka qenë 21,3.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e VIII, “Vepra penale kundër veprimtarisë shetërore të kryera nga shetasit”.


VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËRORE TË KRYERA NGA SHETASIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shetërore ose një shërbim publik	59	37	44	41	39	48	27	28	27	22
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	162	127	204	160	154	172	150	266	224	163
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	123	71	112	76	51	103	71	96	83	78
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	22	9	11	9	2	32	8	15	8	13
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik	236	162	196	176	172	257	198	221	214	120
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shetërore	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shetërore	7	3	1	3	3	0	0	0	0	1
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	5	1	2	1	3	6	1	3	1	0
Totali	614	410	570	466	424	620	455	629	557	397

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 0,98 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër veprimtarisë shetërore të kryera nga shetasit” në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi rritje prej 10,98 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në

lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje 10,35 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 19,53 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 6,37 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër autoritetit të shtetit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, rreth 2,35 % kanë qenë të pandehur të mitur. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) janë regjistruar 96,48 % meshkuj dhe 3,52 femra %.

Në këtë grup veprash janë edhe 2 të pandehur shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 46,93 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 41,63 % me arsim të mesëm dhe 11,44 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 1,22 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 28,66 % e të pandehurve dhe të papunë 70,12%.

Rezulton se 63,47 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 36,53 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve rreth 91,23 % janë të padënuar më parë ndërsa 8,77 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT


Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 7,74 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 9,6 %. Për këtë vepër gjatë vitit 2018 janë regjistruar 48 procedime ose 18,64 % më pak se në vitin 2017.

Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 27,74 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 26,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” prej 6,17 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 33 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Durrës kanë regjistruar 8 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Korçë kanë regjistruar 5 %, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 4 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Shkodër kanë regjistruar përkatësisht 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kurbin, Krujë, Kavajë, Kukës, Lushnjë, Pukë e Tropojë kanë regjistruar në vitin 2018, një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 3 % të numrit total të procedimeve, ndërkohë prokuroritë Mat, Përmet e Sarandë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

Goditjet për shkak të detyrës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” në vitin 2018 është 16,61 %.

Për këtë vepër penale rezulton tendenca në ulje prej 16,26 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 41,45 % në vitin 2018, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 38,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, në vitin 2018, prej 8,90 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 40 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 12 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Korçë kanë regjistruar respektivisht 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Dibër ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Berat kanë regjistruar përkatësisht 3 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnjë Pogradec e Mat kanë regjistruar në vitin 2018 një numër procedimesh më të vogël se 2 % të procedimeve në shkallë vendit, ndërkohë prokuroritë Përmet, Pukë, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,62 % ndërsa në vitin 2017 pesha e kësaj vepre ka qenë 2,2 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 28,60, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 24,5.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu VIII, Seksioni II, “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”:

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËTORË TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHETËTORË OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykat ë	Nr. pand. Regj	Nr. Pan d. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 248 Shpërdorim detyre	627	109	188	139	85	737	75	169	184	93
Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij	4	1	2	1	1	1	0	0	0	0
Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare	32	4	17	7	0	42	4	9	8	6
Neni 251 Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
Neni 252 Mbajtja në burg pa vendim	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazisë së shtetasve	0	0	0	0	0					
Neni 254 Shkelja e paprekshmërisë së banesës	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	1	0	0	0	0					
Neni 256 Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti	2	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 257 Përfitim i paligjshëm i interesave	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 257/a Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	20	13	12	13	11	24	14	13	14	11
Neni 258 Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike	15	2	1	4	6	14	1	0	0	0
TOTALI	704	130	221	165	103	821	94	193	207	111

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 16,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, në krahasim me vitin 2017 dhe ulje prej 27,69 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 12,67 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 25,45 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me rreth 7,77 % përkundrejt vitit 2016.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit rezultojnë të rritur (mbi 18 vjeç) ku 10,56 % femra dhe 89,44 % meshkuj.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë 91,13 % e të pandehurve. Nga këta, rreth 3 % janë funksionarë; 1 % nëpunës të nivelit të lartë; 8 % e të pandehurve janë nëpunës të nivelit të mesëm; 9 % janë nëpunës i nivelit të ulët; 70 % e të pandehurve janë punonjës të thjeshtë ose të nivelit ekzekutiv dhe 9 % punonjës policie.

Rezulton se 78,29 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 21,71 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 97,69 % e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shpërdorim detyre


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” është 89,77 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues ka qenë 89 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, në vitin 2018, prej 17,54 % në krahasim me vitin 2017.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve për këtë vepër penale e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 23 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Durrës, Lezhë, Elbasan e Shkodër kanë regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Korçë kanë regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër e Krujë kanë regjistruar përkatësisht 43 % të procedimeve penale, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Lushnje, Kukës, Kurbin, Pukë, Kavajë, Pogradec, prokuroria për krime të rënda, Përmet, Tropojë e Mat kanë regjistruar më pak se 2 % të procedimeve penale në shkallë vendi gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyrë”.

Kryerja e veprimeve arbitrare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” në vitin 2018 është 5,12 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 4,5 %. Pra ky tregues rezulton në rritje për vitin 2018.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal "Kryerja e veprimeve arbitrare" në vitin 2018, prej 31,25 % në krahasim me vitin 2017.

Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë në vitin 2018 është 2,92 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 2,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në vitet 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” ka tendencë në rritje të numrit të procedimeve e konkretisht nga 20 procedime të regjistruara në vitin 2017, në 24 procedime të regjistruara në vitin 2018 ose e shprehur në përqindje, rritje me 20 %.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në prokuroritë e shkallës së parë në vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që ka regjistruar 10 procedime

ose 42 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim prokuroritë e shkallës së parë Dibrë e Durrës kanë regjistruar 3 procedime penale ose 13 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Lezhë kanë regjistruar 2 procedime penale ose 8 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kavajë, Kurbin e Vlorë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 4 % të procedimeve gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 18,12 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 16 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 198,20, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 175.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun VIII, Seksioni III, “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjyk. të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua r
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	1	1	3	3	0	1	0	0	0	1
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	7	1	5	5	5	32	2	28	16	11
Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve	9	1	2	1	0	2	2	0	2	0
Neni 265/a Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265/b Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Kriminalitetit

Viti 2018

Neni 265/c Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0
Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	2	1	2	1	0	0	0	0	0	0
Neni 271 Disinformimi i ekipeve të urgjencës	1	0	0	0	0	1	0	0	0	1
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	33	6	13	6	4	20	10	6	10	6
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	228	54	70	54	39	257	90	95	93	82
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	62	23	48	25	14	77	41	40	56	35
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrjeve telefonike	430	37	69	38	11	432	52	57	53	22
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 277 Vetëgjyqësia	196	80	129	98	41	211	81	86	102	85
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	392	187	257	210	180	400	183	263	212	150
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	74	45	69	47	46	116	63	94	66	47
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive	47	22	34	23	19	64	42	46	43	38
Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lëndët helmuese	3	2	2	2	2	0	0	0	0	0
Neni 282 Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive	5	2	3	3	6	5	2	3	4	4
Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të tjera të rrezik.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
282/c	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0


Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/ç Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/d Prodhimi dhe tregtimi i barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge	0	0	2	0	0	2	0	2	0	0
Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave	1	0	0	0	0	5	0	2	0	0
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	0	0	0	0	0	1	1	1	1	1
Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin	10	0	2	0	0	17	2	2	2	1
Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrial dhe ushqimorë	46	11	42	12	6	48	13	28	13	12
Neni 288/b Tregtimi dhe hedhja për konsum e lëndëve djegëse në kundërshtim me standardet ligjore të cilësisë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	68	15	20	19	14	121	11	29	17	10
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	841	348	744	360	246	880	356	665	366	260
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	2570	2379	2764	2394	2154	2984	2897	3178	2907	2371
Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport	3	1	1	1	0	3	0	0	0	3
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	5	6	5	12	2	4	3	3	8	16
Neni 293/d Shitja e paautorizuar e kartave SIM	2	1	1	1	0	4	3	5	4	1
Totali	5038	3223	4287	3315	2790	5689	3854	4634	3975	3157

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” rezulton se në vitin 2018 ka një rritje të gjithë treguesve e konkretisht, rritje prej 12,92 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje prej 19,58 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundërt këtij totali në vitin 2017 prej 8,09 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë

dërguar në gjykatë prej 19,91 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13,15 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga të pandehurit, 4,31 % kanë qenë të pandehur të mitur dhe 95,69 % të rritur (mbi 18 vjeç). Të pandehurit meshkuj përbëjnë edhe për këtë grup veprash pjesën më të madhe e konkretisht 96,85 % meshkuj ndër të cilët 4,33 % të mitur dhe 3,15 % femra ndër të cilat 3,68 % të mitura.

Rezultojnë 27 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 45,00 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 45,82 % me arsim të mesëm dhe 9,18 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë rreth 1,34 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë të punësuar 31,04 % e të pandehurve dhe të papunë 67,62 %.

Rezulton se 63,49 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 36,51 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 95,78 % e tyre, 3,42 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 0,79 % përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 0,56 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 0,14 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” në vitin 2018, ku konkretisht rezultojnë 32 procedime të regjistruara kundrejt 7 të tillave në vitin 2017.

Largimi nga vendi i aksidentit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 4,52 % për vitin 2018, tregues pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2017 (5,53 %).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2017 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, në vitin 2018 janë rritur 12,72 % krahasuar me vitin 2017.

Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 7,59 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 8,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca e lehtë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, në vitin 2018, prej 0,47 % në krahasim me vitin 2017.

Vetëgjyqësia


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 3,71 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 3,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në vitin 2018, prej 7,65 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 31 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës ku janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Shkodër ku janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Fier ku janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Vlorë ku janë regjistruar respektivisht 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Lushnje e Kurbin janë regjistruar respektivisht 4 % dhe 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Krujë, Sarandë, Kavajë, Pukë, Kukës, Tropojë, Berat, Gjirokastrë, Pogradec e Mat është regjistruar një numër procedimesh më i ulët se 2 % i numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale. Ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Përmet nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 7,03 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 7,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” i Kodit Penal në vitin 2018, prej 2,04 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 23 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Elbasan janë regjistruar 10 % e procedimeve penale, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Durrës e Shkodër janë regjistruar 7 % e procedimeve penale, në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kurbin e Pogradec janë regjistruar respektivisht rreth 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Lushnje, Kukës, Kavajë, Mat, Pukë, Tropojë, Sarandë e Përmet kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2018 për nenin 278 të Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve ushtarake dhe municionit”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 2,04 %, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 1,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në vitin 2018 prej 56,76 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 45 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Fier janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 4 % e procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Lushnjë e Sarandë janë regjistruar përkatësisht rreth 3 % e procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Krujë, Mat, Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Pukë e Tropojë është regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit dhe në prokuroritë e shkallës së parë Kukës e Përmet nuk është regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në vitin 2018 është 1,12 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 0,9 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, në vitin 2018 prej 36,17 % në krahasim me vitin 2017.

Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 0,84 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 0,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 288/a i Kodit Penal “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë”, në vitin 2018, prej 4,35 % në krahasim me vitin 2017.

Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 2,13 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 1,3 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, në vitin 2018, prej 77,94 % në krahasim me vitin 2017.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 15,47 %, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 16,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në vitin 2018, prej 4,64 % në krahasim me vitin 2017. Ndërsa nëse krahasojmë të dhënat e pesë viteve rezulton vit pas viti rritje e numrit të procedimeve, ku nga viti 2014 në vitin 2018 rritja e numrit të procedimeve të regjistruara është 39 %.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 27 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Durrës janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Lezhë janë regjistruar përkatësisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Berat, Dibër, Lushnje e Kurbin janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa në prokuroritë e tjera është regjistruar një numër procedimesh më i vogël se 2,5 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2018 dhe në prokurorinë e shkallës së parë Përmet nuk është regjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2018 është 52,44 %, që përbën edhe peshën më të lartë, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ka qenë 51 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" në vitin 2018, prej 16,11 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë për vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 34 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Korçë janë regjistruar përkatësisht 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Berate Lushnje janë regjistruar përkatësisht rreth 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2018, ndërkohë që numrin më të ulët të procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Përmet.

VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,86 %, ndërsa në vitin 2017 ky

tregues ka qenë 1 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 9,37, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 11.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

PASTRIMI I PARAVE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. d. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. d. Regj.	Nr. Pand. d. në gjyk.	Nr. Pand. d. dënuar
Neni 287 Produktet e veprës penale ose veprimtarisë kriminale	309	31	38	35	8	257	17	35	30	13
Neni 287/a Llogari anonime	1	0	0	0	0	2	0	1	0	2
Neni 287/b Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale	10	5	24	17	17	10	6	14	26	12
Totali	320	36	62	52	25	269	23	50	56	27

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 15,94 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në krahasim me vitin 2017. Ndërkaq kemi ulje 36,11 %, të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar me 19,35 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është rritur me 7,69 % ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 8 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për vitet 2017-2018 paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) meshkuj 93,55 % dhe femra 6,45 %.

Janë hetuar gjithashtu edhe 5 të pandehur me shtetësi të huaj për këto vepra penale.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 29,06 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 60,47 % me arsim të mesëm dhe 10,47 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se 70,77 % e të pandehurve janë nga sektori privat, 27,69 % janë të papunë dhe 1,54 % të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 75,58 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 24,42 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 86,05 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa 13,95 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT


Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale për vitin 2018 është 95,54 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 96,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Gjatë vitit 2018 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", prej 16,83 % në krahasim me vitin 2017.




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Elbasan janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Berat janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë vërehet një numër procedimesh i barabartë me 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kurbin e Lushnje janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Korçë e Pogradec janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë 2 % të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Mat, Sarandë, Përmet e Tropojë janë regjistruar 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Nga ana tjetër, prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kukës e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprave penale, në vitin 2018 është 3,72 %, ndërsa në vitin 2017 pesha e kësaj veprë brenda grupit ka qenë 3 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Gjatë vitit 2018 vërehet i njëjti trend në numrin e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal "Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale", 10 procedime penale, po aq sa në vitin 2017.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETETËRORE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2018 është 3,83 %, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 1,9 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është, 41,84 ndërsa në vitin 2017 ka qenë 21,24.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETTIT DHE KUFIJVE SHTETËRORE	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 294 Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar	1	0	0	0	0	4	0	0	0	0
Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	572	338	596	314	260	1096	630	1082	661	477
Neni 298 Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit	35	6	22	8	20	99	27	102	44	14
Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	611	344	618	322	280	1201	657	1184	705	491

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje të konsiderueshme në të gjithë treguesit statistikorë, ku konkretisht numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është rritur 96,56 % në krahasim me vitin 2017 dhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur 90,99 % në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 91,59 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 118,94 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 75,38 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 97,88 % meshkuj, ku 0,76 % janë të mitur dhe 2,12 % femra.

Të pandehur të huaj rezultojnë 35.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 51,06 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 47,73 % me arsim të mesëm dhe 1,21 % me arsim të lartë.

Të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 3,52 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër prej 96,21 % rezulton e papunë. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale lidhen kryesisht me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 50,62 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 49,38 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 92,79 % e tyre janë të padënuar më parë, 2,71 % prej tyre është përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 4,50 % përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar

Nga të dhënat statistikore rezulton në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 294 i Kodit Penal “Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar” nga 1 në vitin 2017 në 4 procedime në vitin 2018.


Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete

Nga të dhënat statistikore rezulton i njëjti numër procedimesh të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 295/a i Kodit Penal “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” konkretisht 2 procedime.

Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2018 është 91,26 %, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ka qenë është 93,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, në vitin 2018, prej 91,61 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat lidhur me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale për këtë vepër në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 49 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Pogradec janë regjistruar respektivisht 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Korçë vërehet një numër procedimesh i barabartë me 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastër janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së Kukës janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë 2 % dhe në prokuroritë e shkallës së Elbasan, Përmet, Lezhë, Fier e Tropojë janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 1 % të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Nga ana tjetër, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kavajë, Krujë, Kurbini, Lushnjë, Mat e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” gjatë vitit 2017.

Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” për vitin 2018 është 8,24 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues ka qenë 5,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, në vitin 2018, prej 2,8 herë në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale në prokuroritë e shkallës së parë, për nenin 298 të Kodit Penal gjatë vitit 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër, 29 procedime penale që përbëjnë 30 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi e në vijim në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër ku janë regjistruar 20 procedime penale ose 20 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës ku janë regjistruar 10 procedime ose 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Tiranë ku janë regjistruar nga 9 procedime ose 9 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë Korçë janë regjistruar 4 procedime ose 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Lezhë e Vlorë janë regjistruar nga 3 procedime penale ose 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2018. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Elbasan, Sarandë, Dibër, Lushnjë e Pogradec kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2,5 % të numrit total të procedimeve e ndërkaq, prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror”.

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,42 % ndërsa për vitin 2017 ka qenë 2,25 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 26,44, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 24,6. Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e IX “Vepra penale kundër drejtësisë”:


VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 300 Moskallëzimi i krimit	27	28	132	147	127	20	29	93	136	98
Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	10	6	14	16	17	14	10	19	24	13
Neni 302 Përkrahja e autorit të krimit	3	3	7	5	8	2	1	4	8	3
Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 304 Detyrimi për të kallëzuar provën	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 305 Kallëzimi i rremë	31	28	26	32	29	66	45	60	49	35
Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit	2	0	1	0	1	2	1	1	1	2
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq.	20	15	17	17	9	11	9	16	19	12
Neni 306 Dëshmia e rreme	10	4	11	5	9	12	5	8	5	3
Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar	1	1	1	1	0	1	0	0	0	1
Neni 308 Përkthimi i rremë	0	0	0	0	0					
Neni 309 Ekspertimi i rremë	31	2	5	3	2	38	5	10	7	2
Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 311 Kanosja për të mos kallëzuar	7	3	10	3	2	6	2	4	2	2
Neni 312/a Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë	2	1	1	1	0	3	0	1	0	0
Neni 313 Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikullit	3	0	0	0	0					
Neni 313/b Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit	1	0	0	0	0	7	3	5	3	2
Neni 317 Kanosja e gjyqtarit	4	2	1	2	2	8	2	7	2	0
Neni 318 Fyerja e gjyqtarit	12	2	5	2	0	23	5	16	6	1
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës	85	17	32	17	7	138	35	44	39	21
Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës	6	1	1	1	0	6	0	0	0	2
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	92	36	73	36	24	125	76	76	70	34
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	43	24	40	23	16	45	31	44	32	24
Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim	2	1	1	1	0	1	1	1	1	0
Neni 324/a Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim	317	145	163	151	128	231	125	117	135	127
Totali	709	319	541	463	381	759	385	526	539	382

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 7,05 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2017 e ndërkaq kemi rritje prej 20,69 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 2,77 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 16,41 %, përkundrajt këtij totali në vitin 2017 dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 0,26 % krahasuar me një vit më parë.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër drejtësisë për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, vetëm 2,27 % rezultojnë të mitur dhe 97,73 % të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç). Sa i përket gjinisë së të pandehurve rezulton se 10,70 % janë femra dhe 89,30 % meshkuj.

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 3 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 53,03 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 40,10 % me arsim të mesëm dhe 6,87 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 2,5 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 35,38 % e të pandehurve dhe të papunë 62,57 %.


Sa i përket vendbanimit, vërehet se 59,77 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 40,23 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 72,35 % janë të padënuar më parë, 26,99 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,66 % përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Kallëzimi i rremë**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” është 8,70 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues përbënte 4,4 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë e lartë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal “Kallëzimi i rremë”, në vitin 2018, prej 2,13 herë ose 112,90 % në krahasim me vitin 2017.

Dëshmia e rreme

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2018 është 1,58 %, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ka qenë 1,4 %. Vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 306 i Kodit Penal “Dëshmia e rreme”, në vitin 2018, prej 20 % në krahasim me vitin 2017.

Ekspertimi i rremë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” është 5 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues përbënte 4,4 % të grupit.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal “Ekspertimi i rremë”, në vitin 2018, prej 22,58 % krahasuar me vitin 2017, e konkretisht nga 31 në 38 procedime penale.

Fyerja e gjyqtarit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” është 3,03 %, ndërsa për vitin 2017 ky tregues përbënte 1,69 % të grupit.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal “Fyerja e gjyqtarit”, në vitin 2018, prej 91,67 % krahasuar me vitin 2017, e konkretisht nga 12 në 23 procedime penale.

Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2018 është 18,18 %, tregues në rritje krahasuar me vitin 2017 gjatë të cilit pesha specifike e kësaj vepre ishte 12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, në vitin 2018, prej 62,35 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale sipas prokurorive, për këtë vepër penale në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 38 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 13 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 7 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Vlorë kanë regjistruar 5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Sarandë kanë regjistruar 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Korçë, Gjirokastrë, Mat, Përmet, Berat, Dibër, Lushnjë, Pogradec e Pukë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % dhe prokuroritë Kukës, Kurbin e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” gjatë vitit 2018.

Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2018 është 16,47 %, ndërsa në vitin 2017 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë veprë përbënte 12,98 % të totalit të grupit.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, në vitin 2018, prej 35,87 % në krahasim me vitin 2017.

Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2018 është 5,93 %, ndërsa në vitin 2017 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 6 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, në vitin 2017, prej 4,65 % në krahasim me vitin 2017.

Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim

Kjo vepër penale ka peshën specifike më të lartë në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” edhe për vitin 2018, e konkretisht 30,43 %, ndërkohë që në vitin 2017, ky tregues ishte 44,7 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2018 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, prej 27,13 % në krahasim me vitin 2017.

Treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër janë të lartë dhe rezultojnë në shifrat si më poshtë:



VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve²³”. Siç vërehet nga të dhënat, gjatë vitit 2018 janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 13 të pandehur për këto vepra dhe 3 të pandehur janë dënuar.

VEPRAT PENALE PËR ZGJEDHJET E LIRA	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhore	5	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 326 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve	20	0	67	0	0	0	2	0	13	0
Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit	5	4	4	4	2	0	0	0	0	2
Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0
Neni 328/a Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike	15	1	7	1	0	0	0	0	0	1
Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje	4	1	8	1	1	0	0	0	0	0
Neni 330 Pengimi i zgjedhësit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

²³ Veçuar nga ky grup veprat penale të korrupsionit në zgjedhje dhe trajtuar në grupveprat penale të korrupsionit

Neni 330/a Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes	0	0	0	0	0					
Neni 331/a Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit ²⁴	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak	0	0	0	0	0					
Neni 332/a Shpërdorimi i autoritetit policor	1	0	4	0	0	0	0	0	0	0
Totali	51	7	92	7	4	0	2	0	13	3

VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,55 % ndërsa për vitin 2017 ka qenë 0,87 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 6, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 9,5.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të korrupsionit:

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. d. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua r
Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat	0	0	0	0	0	1	1	2	2	0
Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat	5	1	3	1	1	2	0	0	0	0
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	124	106	129	109	111	29	24	38	33	21
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë	3	0	0	4	4	3	0	0	0	4

²⁴ Shtuar me ligjin nr.89/2017

Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike
 Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike
 Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë
 Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë
 Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit
 Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë
 Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare
 Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj
 Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja
 Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë
 Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare
 Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj
 Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja
 Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje
 Neni 328/b Korrupsioni pasiv në zgjedhje


Totali

24	14	20	27	26	23	19	21	27	22
61	14	23	18	14	74	13	42	17	13
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	2	4	2	1	6	0	1	0	2
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1	0	4	1	0	3	0	7	4	2
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	1	5	1	1	29	2	5	4	2
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
25	3	7	5	0	2	0	0	0	3
2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
273	141	196	168	158	172	231	175	203	156

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 37 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, në krahasim me vitin 2017, rritje prej 63,83 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 10,71 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 20,83 % dhe ulje e lehtë e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 0,63 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër korrupsionit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezulton se të gjithë të pandehurit janë të rritur (mbi 18 vjeç) ku, 13,67 % janë femra dhe 86,33 % meshkuj.

Rezultojnë 2 shtetas të huaj të pandehur për këto vepra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 16,79 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 40,88 % janë me arsim të mesëm dhe 42,34 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 56,16 % e të pandehurve (ndër të cilët 17,07 % janë punonjës policie), në sektorin privat rezultojnë të punësuar 30,14 % e të pandehurve, dhe 13,70 % prej tyre rezultojnë të papunë.


Rezulton se 88,24 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 11,76 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 97,06 %, janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike**


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 16,86 %, ndërsa në vitin 2017 pesha që zinte kjo vepër ka qenë 45,4 %. Pra vërehet ulje e peshës specifike të kësaj vepre në totalin e veprave penale të grupit.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Për vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, organi i prokurorisë ka regjistruar 29 procedime penale, që përbën ulje prej 76,61 % në krahasim me vitin 2017. Janë dërguar në gjykatë 24 procedime penale, ndërsa në vitin 2017 rezultojnë 106 procedime të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, krahasuar me vitin 2017 vihet re ulje nga 129 në 38 të pandehur të regjistruar dhe ulje nga 109 në 33 të pandehur dërguar në gjykatë në vitin 2018. Edhe numri i të pandehurve të dënuar në vitin 2018 është ulur nga 111 në 21.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë vepër e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që ka regjistruar 16 procedime ose 55 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Elbasan, Gjirokastër e Kurbin kanë regjistruar respektivisht nga 2 procedime penale ose 7 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Diber, Korçë, Kukës, Pogradec e Vlorë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 3,5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, gjatë vitit 2018.

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 13,37 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2018, prej 4,17 % në krahasim me vitin 2017.

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2018 është 43,02 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 22,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2018, prej 21,31 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara edhe për këtë vepër penale e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë konkretisht, 29 procedime që përbëjnë 41 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 8 procedime ose 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Korçë e Vlorë kanë regjistruar 6 procedime ose 9 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 4 procedime ose 6 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Pogradec e prokuroria për krime të rënda kanë regjistruar 2 procedime penale ose 3 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë, Kurbin e Lushnje kanë regjistruar respektivisht 1 procedim ose 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”.

Korrupsioni aktiv e pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendor

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 3 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” po aq sa në vitin 2017. Sa i përket nenit 260 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, janë regjistruar 6 procedime penale kundrejt 13 procedimeve të regjistruara në vitin 2017 për këtë vepër.


Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Për vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, organi i prokurorisë ka regjistruar 3 procedime penale me 7 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2017 rezulton 1 procedim penal me 4 të pandehur regjistruar.

Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2017 është 16,86 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”. Konkreisht organi i prokurorisë ka regjistruar 29 procedime penale me 5 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2017 janë regjistruar 14 procedime me 5 të pandehur. Janë dërguar në gjykatë 2 procedime penale me akuzë ndaj 4 të pandehurve dhe janë dënuar 2 të pandehur për vitin 2018 për këtë vepër penale.

KRIMI KIBERNETIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 është 0,37 % ndërsa për vitin 2017 ky grup veprash përbënte 0,44 % të numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 4,01, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 4,9.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale kundër krimit kompjuterik për vitet 2017 e 2018.


KRIMI KIBERNETIK	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. komp.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik	73	1	2	1	0	52	5	0	8	6
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik	16	0	0	0	1	19	3	2	4	8
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik	11	1	1	1	2	11	0	0	0	2
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike	33	2	0	2	4	31	4	3	4	2
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike	4	0	0	0	0	2	0	2	0	0
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Totali	140	4	4	4	7	115	12	7	16	18

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje 17,86 % të numrit të procedimeve të regjistruara, rritje të numrit të procedimeve dërguar në gjykatë, nga 4 procedime në vitin 2017 në 12 procedime dërguar në gjykatë në vitin 2018

(3 herë), rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2018 përkundrejt këtij totali në vitin 2017 nga 4 në 7 (75 %), rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë nga 4 në 16 (4 herë) dhe rritje e numrit të të pandehurve dënuar për vepra penale kundër krimit kompjuterik nga 7 në 18 (2,6 herë).

Grafikisht tendenca e krimit kibernetik për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë meshkuj të rritur (mbi 18 vjeç) nga të cilat 92,86 % meshkuj dhe 7,14 %.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,74 % e tyre janë me arsim të mesëm, 14,81 % me arsim të lartë, 44,44 % me arsim deri 9-vjeçar.

Rezulton se 62,96 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet dhe 37,04 % në fshat.


Ndërkohë që rezultojnë edhe 3 shtetas të huaj të pandehur.

Ndërsa lidhur me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 96,15 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 3,85 % janë të dënuar për vepra të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Mashtrimi kompjuterik**


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” për vitin 2018 është 45,22 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 52 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik” në vitin 2018, prej 28,77 % në krahasim me vitin 2017.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale për vitin 2018, paraqitet më poshtë:




Siç vërehet nga paraqitja grafike, prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar numrin më të madh të procedimeve për këtë vepër penale, 45 procedime duke përbërë 87 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 3 procedime ose 6 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Fier, Kavajë e Shkodër kanë regjistruar nga 1 procedim penal gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik”.

Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 26,96 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 23,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, me 6,06 % krahasuar me procedimet penale të regjistruara në vitin 2017.

TRAFIQET E PALIGJSHME

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,90 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 1,2 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 9,89 ndërsa në vitin 2017 ka qenë 13.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale kundër trafikëve të paligjshme.


	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
TRAFIKIMI										

Neni 110/a Trafikim i Personave të rritur	24	2	8	2	6	17	1	5	3	0
Neni 128/b Trafikimi i të miturve	6	3	3	3	1	5	1	2	3	4
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës	1	0	1	0	0	4	0	4	0	0
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	142	3	17	4	5	139	3	14	5	2
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit	5	0	2	0	0	11	3	5	3	1
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive	1	0	0	0	0	3	0	2	0	0
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	196	79	145	122	96	105	39	118	91	83
Totali	375	87	176	131	108	284	47	150	105	90

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 24,27 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikeve të paligjshme në krahasim me vitin 2017 e ndërkaq kemi ulje prej 45,98 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vërehet një ulje prej 14,78 % e të pandehurve të regjistruar, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 19,85 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 16,67 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafikeve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë të rritur ku 3 % janë femra dhe 97 % janë meshkuj.

Në vitin 2018 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 15 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1 % janë me arsim të lartë, 33,67 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 65,33 % me arsim të mesëm.

Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve rezulton se 63,96 % janë të punësuar në sektorin privat, 3,05 % të punësuar në sektorin shtetëror dhe 32,99 % janë të papunë.

Rezulton se 67,80 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 32,20 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 95,07 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, dhe 4,93 % prej tyre rezultojnë përsëritës në vepra të ndryshme penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Trafikimi i personave të rritur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2018 është 5,99 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave të rritur” në vitin 2018, prej 29,17 % në krahasim me vitin 2017, nga 24 në 17 procedime. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është ulur nga 2 procedime me 2 të pandehur në vitin 2017, në 1 procedim me 3 të pandehur për vitin 2018.

Trafikimi i të miturve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2018 është 1,76 % ndërsa në vitin 2017 ka qenë 1,6 %.


Numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, në vitin 2018 është 5, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 6, ndërkohë numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është 1 në vitin 2018, tregues në ulje krahasuar me 3 procedime penale dërguar në gjykatë në vitin 2017. Lidhur me dënimet, në vitin 2018

rezultojnë 4 të pandehur të dënuar për këtë vepër penale, ndërsa në vitin 2017 është dënuar 1 i pandehur.

Trafikimi i mjeteve motorike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” është 48,94 % për vitin 2018, ndërkohë që për vitin 2017 ka qenë 37,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”, në vitin 2018, prej 2,11 % në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale për vitin 2018:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, për këtë vepër penale numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e kanë prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Durrës përkatësisht 14 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Fier kanë regjistruar respektivisht 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Kukës ka regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë 7 % të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Lushnjë ka regjistruar një numër procedimesh që përbën 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër e Lezhë kanë regjistruar rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Sarandë e Korçë kanë regjistruar rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Elbasan, Pogradec, Dibër, Tropojë, Përmet e Berat kanë regjistruar më pak se 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Krujë, Mat e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”.

Trafikimi i armëve dhe i municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 3,87 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, është rritur nga 5 procedime penale të regjistruara në vitin 2017, në 11 procedime penale në vitin 2018.

Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 1,41 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet rritje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2018 krahasuar me një vit më parë, nga 1 në 4 procedime penale.

Trafikimi i narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2018 është 36,97 %, ndërkohë që në vitin 2017 ky tregues ka qenë 52,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”, në vitin 2018 prej 46,43 % në krahasim me vitin 2017.

VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PRODHIMIN DHE KULTIVIMIN E

NARKOTIKËVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2018 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 4,52 %, ndërsa për vitin 2017 ka qenë 5 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 është 49,44, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 54,6.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për veprat penale në lidhje me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve.

TENDENCA

	2017					2018				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE										
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	1193	596	1302	834	625	1127	447	1099	614	483
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	375	134	213	170	188	292	46	99	66	60
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	1571	730	1516	1004	813	1419	493	1198	680	543

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një ulje prej 9,68 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2017 e ndërkaq kemi ulje prej 32,47 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 20,98 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 32,27 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 33,21 % përkundrejt vitit 2017.

Grafikisht tendenca e veprave penale për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 97,24 % të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) dhe 2,76 % të mitur (14 deri 18 vjeç). Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 99,02 % meshkuj dhe 0,98 % femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 57,09 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 38,51 % me arsim të mesëm dhe 4,40 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në vitin 2018 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 24 shtetas të huaj.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 15,19 % e të pandehurve dhe të papunë 84,81 %.


Rezulton se 59,44 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 40,56 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 94,14 % e tyre janë të padënuar më parë, 0,62 % janë përsëritës për të njëjtën vepër, ndërsa 5,24 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup është 79,42 % për vitin 2018, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 75,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re se për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2018 është ulur me 5,53 % krahasuar me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2018:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 31 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Elbasan e Fier që kanë regjistruar 8 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Vlorë kanë regjistruar rreth 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Lezhë kanë regjistruar respektivisht një numër procedimesh që përbën rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat e Durrës kanë regjistruar respektivisht një numër procedimesh që përbën rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e tjera të shkallës së parë kanë regjistruar në vitin 2018, një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Kultivimi i bimëve narkotike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale këtë grup është 20,58 % për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 23,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje në vitin 2018 e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”, prej 22,13 % në krahasim me vitin 2017.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2018 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë regjistruar prokuroria e shkallës së parë Krujë që përbën 30 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 18 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Gjirokastër ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së Vlorë ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroria e Fier ka regjistruar 7 % të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Kurbin, Tiranë e Berat kanë regjistruar rreth 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Sarandë e Tropojë e Pukë kanë regjistruar rreth 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Elbasan, Kukës, Përmet, Dibër e Pogradec kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën rreth 1 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë prokuroritë Kavajë, Lushnje e Mat nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”.

2.10 PËRMBLEDHJE E TENDENCAVE TË KRIMINALITETIT SIPAS GRUPVEPRAVE PENALE

Për vitin 2018 vihen re **tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara** për veprat penale si më poshtë:

“Krimet kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi”, të regjistruara në vitin 2018 janë ulur 55,56 % në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër lirisë së personit²⁵” në vitin 2018 kanë një ulje prej 5,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes²⁶” për vitin 2018 kanë një ulje prej 7,73 % në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë²⁷” në vitin 2018 kanë një ulje prej 2,26 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale të mashtrimit²⁸” në vitin 2018 kanë një ulje prej 16,92 % krahasuar me vitin 2017;

“Veprat penale të shkatërrimit të pronës” në vitin 2018 kanë një ulje në krahasim me vitin 2017, në masën 6,53 % të numrit të procedimeve të regjistruara;

“Veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare” në vitin 2018 kanë një ulje prej 2,63 % të numrit të procedimeve të regjistruara;

“Krimet në fushën e doganave” në vitin 2018 kanë një ulje prej 37,99 % të numrit të procedimeve të regjistruara;

“Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve” në vitin 2018 kanë një ulje prej 17,75 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës” në vitin 2018 kanë një ulje prej 29,20 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale” për vitin 2018 kanë një ulje prej 15,94 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

²⁵ Veçuar trafiku i personave të rritur

²⁶ Veçuar trafiku i të miturve

²⁷ Veçuar trafiku i mjeteve motorike dhe veprave të artit

²⁸ Veçuar mashtrimi kompjuterik

“Veprat penale të korrupsionit” në vitin 2018 kanë një ulje prej 37 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër krimit kompjuterik” në vitin 2018 kanë një ulje prej 17,86 % të numrit të procedimeve të regjistruara;

“Veprat penale të trafikëve të paligjshme” në vitin 2018 kanë pësuar një ulje prej 24,27 % të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve” në vitin 2018 kanë një ulje prej 9,68 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017.

Për sa i përket veprave penale të mëposhtme, vihet re **një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara** për vitin 2018. Kështu:

“Krimet Kundër jetës të kryera me dashje” të regjistruara në vitin 2018 kanë pësuar një rritje prej 27,27 % në krahasim me vitin 2017;

“Veprat Penale kundër shëndetit të kryera me dashje” janë rritur me 5,34 % në krahasim me vitin 2017;

“Krimet kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi” të regjistruara në vitin 2018 kanë pësuar një rritje prej 33,33 %;

“Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës” në vitin 2018 kanë një rritje prej 66,29 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2017;

“Krimet seksuale” në vitin 2018 kanë pësuar një rritje prej 10,78 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit”, rezultojnë se në vitin 2018 kanë një rritje 9,30 % në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare²⁹” në vitin 2018 kanë një rritje prej 2,5 herë (152%) në krahasim me vitin 2017;

²⁹ Veçuar korrupsioni në sektorin privat

“Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në vitin 2018 kanë një rritje 25,19 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë” në vitin 2018 kanë një rritje prej 1,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara;

“Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” në vitin 2018 ka një rritje prej 13,17 % të numrit të procedimeve të regjistruara;

“Veprat penale kundër mjedisit” kanë një rritje prej 14,35 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2017 në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale” në vitin 2018 kanë pësuar një rritje prej 2,4 herë (141 %), në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit³⁰” kanë një rritje prej 0,98 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik³¹” në vitin 2018 kanë pësuar një rritje prej 16,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike³²” në vitin 2018 kanë një rritje prej 12,92 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2018 kanë një rritje prej 96,56 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2017;

“Veprat penale kundër drejtësisë” të regjistruara në vitin 2018 kanë pësuar një rritje prej 7,05 %, në krahasim me vitin 2017;

2.11 TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK

Nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraparak ka qenë si më poshtë:


³⁰ Veçuar korrupsioni

³¹ Veçuar korrupsioni

³² Veçuar veprat lidhur me narkotikët


Në vitin 2014 janë përfunduar hetimet për 18982 të pandehur nga të cilët 15806 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3176 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë. Në vitin 2015 janë përfunduar hetimet për 20148 të pandehur nga të cilët 16906 janë dërguar në gjykatë ose 84 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3242 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 16 % të të pandehurve. Në vitin 2016 janë përfunduar hetimet për 17803 të pandehur nga të cilët 14746 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3057 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve. Në vitin 2017 janë përfunduar hetimet për 16176 të pandehur nga të cilët 12808 janë dërguar në gjykatë ose 79 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3368 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 21 % të të pandehurve. Në vitin 2018 janë përfunduar hetimet për 16247 të pandehur nga të cilët 13403 janë dërguar në gjykatë ose 82 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2844 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 18 % të të pandehurve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2018:





Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në dënimin e të pandehurve

Grafiku i mëposhtëm përmban të dhëna të detajuara lidhur me numrin e të pandehurve dënuar dhe ata që kanë marrë pafajësi në pesë vitet e fundit:




Të dhëna mbi kërkesën e prokurorit dhe vendimet e gjykatës

Më poshtë paraqiten në përqindje të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës gjatë vitit 2018, lidhur me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me dënimin "Burgim i përjetshëm" për periudhën 2014-2018:



Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2017 në masën 7,69 %, në vitin 2017 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2016 në masën 45,8 %, në vitin 2016 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2015 në masën 26,3 %, në vitin 2015 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2014 në masën 18,75 % ndërkohë që në vitin 2014 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm kanë qenë 16.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2017 në masën 9 %, në vitin 2017 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2016 në masën 21,4 %, në vitin 2016 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2015 në masën 55,55 %, në vitin 2015 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë në të njëjtin nivel si në vitin 2014 e konkretisht 9 vendime.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin e të pandehurve me burgim sa maksimumi i** parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete për vitet 2014-2018:



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2018 ka një ulje prej 6,13 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2017, në vitin 2017 ka një ulje prej 48,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2016, në vitin 2016 ka një rritje prej 11,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2015 ka një ulje prej 19,77 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit, krahasuar me vitin 2014 ku vërehet se në 354 kërkesa të tij, prokurori ka kërkuar dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete.

Lidhur me vendimet e dënimit në maksimumin e masës së dënimit të parashikuar për veprën penale konkrete, gjatë vitit 2018 vërehet ulje prej 9,43 % krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2017 vërehet e njëjta shifër me vitin 2016, gjatë vitit 2016 vërehet ulje në masën 22,6 % në krahasim me vitin 2015, gjatë vitit 2015 vërehet ulje në masën 32,8 % në krahasim me vitin 2014 dhe në vitin 2014 janë dhënë 204 vendime të tilla.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e **dënimit me burgim në minimumin** e parashikuar nga ligji:



Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum, vihet re se në vitin 2018 kërkesat e prokurorit janë ulur me 27,64 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 kërkesat e prokurorit janë ulur me 15 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2016 kërkesat e prokurorit janë ulur me 27,7 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2015 kërkesat e prokurorit janë rritur me 70,52 % krahasuar me vitin 2014 dhe në vitin 2014 kërkesat e prokurorit janë rritur me 86,68 % krahasuar me vitin 2013.

Vihet re se në vitin 2018 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 18,93 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 16,7 % krahasuar me vitin 2016, në 2016 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 10,2 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2015 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë rritur me 22,23 % krahasuar me vitin 2014 dhe në vitin 2014 vendimet e gjykatës për dënimin në minimum janë rritur me 78,23 % krahasuar me vitin 2013.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar **“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”** si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se në vitin 2018 ka një rritje prej 16,28 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2017 ka një rritje prej 13 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2016 ka një ulje prej 1 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, ndërkohë që në vitin 2015 ka një rritje prej 11,63 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2014 dhe në vitin 2014 numri i kërkesave me këtë objekt ka qenë 3317.

Ndërkohë që edhe vendimet e gjykatës kanë pësuar një rritje prej 7,57 % në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2013-2017:



Të dhënat statistikore tregojnë rritje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë në vitin 2018 prej 12,98 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezultojnë ulje prej 48,4 % në krahasim me vitin 2016, po kështu vërehet ulje e kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë edhe në vitin 2016 prej 15,78 % në krahasim me vitin 2015, ndërkohë që vërehet rritje e kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë në vitin 2015 prej 30,68 % krahasuar me vitin 2014 dhe në vitin 2014 rezultojnë 2278 kërkesa për aplikimin e këtij lloji dënimi.


Sa i përket të dhënave lidhur me vendimet e dënimit me gjobë, vihet re se në vitin 2018 ka një rritje prej 13,03 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 ka një ulje prej 43 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 ka një ulje prej 18,2 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 ka një rritje prej 31,77 % në krahasim me vitin 2014 dhe në vitin 2014 rezultojnë 2187 vendime dënimi me gjobë.

2.12 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2018

Të dhëna lidhur me të pandehurit regjistruar, dërguar gjyqit dhe dënimet për **veprat penale ushtarake** gjatë vitit 2018, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Vepa penale ushtarake	Të pandehur regjistruar	Të pandehur dërguar gjyqit	Të pandehur të dënuar	Të pandehur të pafajshëm
Totali	13	11	0	0

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në hetim³³ (sipas Kodit Penal civil) në pesë vitet e fundit (2014 – 2018):



Në lidhje me të pandehurit e regjistruar në vitin 2018, nga të dhënat statistikore rezulton se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2014 janë regjistruar 18585 të pandehur, që do të thotë rritje prej 38,5 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 janë regjistruar 18076 të pandehur që do të thotë ulje prej 2,7 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë regjistruar 18264 të pandehur që do të thotë rritje prej 1 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 janë regjistruar 17022 të pandehur që do të thotë ulje prej 6,8 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 janë regjistruar 15793 të pandehur që do të thotë ulje prej 7,22 % në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me të pandehurit mbartur në hetim, duke marrë në referencë vitet 2014-2018 rezulton se:

Në 2014 janë mbartur 5295 të pandehur që do të thotë rritje prej 76 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 janë mbartur 6549 të pandehur që do të thotë rritje prej 73,7 % në

³³ Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur çështjet e të cilëve janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë.

krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë mbartur 5548 të pandehur që do të thotë ulje prej 15,3 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 janë mbartur 5226 të pandehur që do të thotë ulje prej 5,8 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 janë mbartur 6281 të pandehur që do të thotë rritje prej 20,19 % në krahasim me vitin 2017.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se:

Në vitin 2014 janë rifilluar hetimet për 149 të pandehur që do të thotë rritje prej 44,6 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2015 janë rifilluar hetimet për 162 të pandehur që do të thotë rritje prej 8,7 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë rifilluar hetimet për 161 të pandehur, shifër që është pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2015 gjatë të cilit janë rifilluar hetimet për 162 të pandehur, në vitin 2017 janë rifilluar hetimet për 105 të pandehur që do të thotë ulje prej 34,8 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 janë rifilluar hetimet për 116 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,48 % në krahasim me vitin 2017.

Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2016-2018:



Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra, në vitin 2016 raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 93,68 % meshkuj dhe 6,32 % femra, në vitin 2017

raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 93,49 % meshkuj dhe 6,51 % femra dhe në vitin 2018 raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 94,09 % meshkuj dhe 5,91 % femra.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2016-2018:




Nga të dhënat statistikore vërehet se të pandehurit me arsim deri 9 vjeçar zënë 51,61 % të të pandehurve në vitin 2016, në vitin 2017 rezultojnë 52,10 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën rritje në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezultojnë 47,34 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën ulje në krahasim me vitin 2017.

Me arsim të mesëm, në vitin 2016 rezultojnë 41,14 % e të pandehurve, në vitin 2017 rezultojnë 40,09 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën ulje krahasuar me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezultojnë 43,98 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën rritje krahasuar me vitin 2017.

Me arsim të lartë, në vitin 2016 rezultojnë 7,25 % e të pandehurve, në vitin 2017 rezultojnë 7,81% e të pandehurve me këtë nivel arsimor që tregon rritje në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2018 rezultojnë 8,68 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që tregon rritje në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitet 2016-2018:




Për sa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 3,44 % e të pandehurve, në vitin 2017 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 6,06 % e të pandehurve dhe në vitin 2018 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 5,65 % e të pandehurve.

Të pandehurit e punësuar në sektorin privat në vitin 2016 përbëjnë 28,99 % të numrit të të pandehurve , në vitin 2017 të pandehurit e punësuar në sektorin privat përbëjnë 30,92 % të numrit të të pandehurve dhe në vitin 2018 të pandehurit e punësuar në sektorin privat përbëjnë 29,49 % të numrit të të pandehurve.

Në vitin 2016 rezultojnë 67,56 % e të pandehurve si të papunë, në vitin 2017 rezultojnë 63,02 % e të pandehurve si të papunë dhe në vitin 2018 rezultojnë 64,87 % e të pandehurve si të papunë.


Pra ajo që vërehet nga të dhënat statistikore është se gjatë tre viteve të fundit më shumë se 63 % e të pandehurve janë të papunë dhe ky është një nga faktorët kryesor kriminogjenë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve për vitet 2016- 2018:



Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat, edhe për vitin 2018 ku tendencat tregojnë se 59,54 % e të pandehurve rezultojnë me vendbanim në qytet dhe 40,46 % rezultojnë me banim në fshat.

Grafiku në vijim paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2016-2018:



Për sa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2018 rezulton se 2,77 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale që do të thotë se ky tregues është rritur krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton se 2,26 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale që do të thotë se ky tregues është rritur krahasuar me vitin 2016, gjatë të cilit rezulton se 1,98 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.


Përsëritës për vepra penale të ndryshme në vitin 2018 rezulton se janë 5,00 % e të pandehurve, që do të thotë ulje krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton se janë 5,66 % e të pandehurve, që do të thotë rritje krahasuar me vitin 2016 gjatë të cilit rezulton se janë 4,33 % e të pandehurve përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo për të cilën janë proceduar.

Të pandehurit e padënuar më parë në vitin 2018 përbëjnë 92,23 % të të pandehurve, në vitin 2017 përbëjnë 92,08 % të të pandehurve dhe në vitin 2016 përbëjnë 93,69 % të të pandehurve.


Shtetësia e të pandehurve

Për sa i përket shtetësisë së të pandehurve, gjatë vitit 2018 rezulton se 95 % e tyre janë me shtetësi shqiptare dhe 1,5 % me shtetësi të huaj.

Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, në vitin 2016 janë regjistruar 143 të pandehur të huaj që përbëjnë 0,78 % të numrit total të të pandehurve të regjistruar, në vitin 2017 janë regjistruar 164 të pandehur të huaj që përbëjnë 0,96 % të numrit total të të pandehurve të regjistruar dhe në vitin 2018 janë regjistruar 241 të pandehur të huaj që përbëjnë 1,53 % të numrit total të të pandehurve të regjistruar. Ky tregues rezulton në rritje 46,95 % krahasuar me numrin e të pandehurve të huaj të regjistruar në vitin 2017.




Të pandehurit me shtetësi të huaj lidhen me procedime për veprat penale si vijon: falsifikime 21 % e të pandehurve, krime lidhur me narkotikët 16 % e të pandehurve, vjedhje e mashtrime 16 % e të pandehurve të huaj, kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror dhe ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve 15 % e të pandehurve, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt dhe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor 9 % e të pandehurve, krime në fushën e tatimeve e doganave 5 % e të pandehurve të huaj dhe grupi i strukturuar kriminal 3 % e të pandehurve. Pjesa tjetër e pandehurve me shtetësi të huaj, lidhen me vepra penale të tjera të cilat të veçuara kanë peshë specifike më të vogël se 2 % brenda totalit.



Të miturit 2018

Gjatë vitit 2018, bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 423 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin.

Konkretisht, shpërndarja e këtyre procedimeve sipas prokurorive të shkallës së parë rezulton si vijon:




Nga të dhënat rezulton se janë regjistruar 481 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Të dhënat tregojnë se 96 % e tyre janë meshkuj dhe 4 % janë femra.


Masat e sigurimit të vendosura ndaj të miturve paraqiten në grafikun më poshtë:




Lidhur me vendimmarrjen prokurorisë për çështjet e konfliktit me ligjin tregojnë se janë dërguar për gjykim 235 çështje dhe janë pushuar 128 çështje.



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shkaqet e vendimmarrjes në rastet e pushimit të çështjes:



Kriminaliteti te të miturit sipas grupveprave penale paraqitet si vijon:



Siç vihet re nga grafiku vjedhja e pasurisë përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç, e konkretisht nga 39 % e të pandehurve të mitur.

Një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 27 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”.

Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se rreth 15 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprat penale lidhur me narkotikët rezultojnë 4 % e të pandehurve të mitur. Për veprat penale lidhur me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve janë regjistruar 3,5 % e të pandehurve të mitur.

Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur gjatë vitit 2018, rezulton se është kërkuar dhe është dhënë për 80 % të të pandehurve të mitur caktimi i dënimit me burg, në 6 % të rasteve është kërkuar dënimi me gjobë dhe në 14 % të rasteve janë kërkuar dënime plotësuese.

Sa i përket viktimave të mitura, të dhënat tregojnë se janë regjistruar 451 viktima të mitura, në masën dërmuese viktima të krimeve kundër personit (273 viktima), kundër pasurisë (92 viktima) dhe rendit e sigurisë publike (81 viktima).

III. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

Lufta ndaj krimit në tërësi e veçanërisht atij të organizuar kërkon një përgjigje të koordinuar ndërkombëtare. Ndaj, në strategjinë afatmesme 2018-2020 të miratuar prej saj, Prokuroria ka përcaktuar si objektiv forcimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe, jo vetëm nëpërmjet përgjigjes së saj në kohë e në mënyrë efikase lidhur me trajtimin e letërkërkesave të autoriteteve të huaja, por edhe në nivel operacional. Synimet kryesore në bashkëpunimin ndërkombëtar do të arrihen nëpërmjet këtyre masave:

1. Rritjes së shpejtësisë, cilësisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar:

- Koordinimin efikas ndërmjet prokurorive;
- Vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me institucionet homologe;
- Krijimin e kanaleve të sigurta të komunikimit;
- Sugjerime për përmirësimin e legjislacionit shqiptar në lidhje me Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë në çështjet penale, në përputhje me standardet ndërkombëtare, veçanërisht për skuadrat e përbashkëta hetimore, mbrojtjen e të dhënave personale në rastet me karakter ndërkufitar etj.;
- Realizimin e trajnimeve, takimeve, konferencave të përbashkëta.

2. Rritjen e bashkërendimit me institucionet dhe agjencitë e huaja ligjzbatuese:

- Ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore;
- Organizimin e trajnimeve për krijimin dhe funksionimin e skuadrave të përbashkëta hetimore.

3. Rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për të identifikuar, ngrirë, sekuestruar e konfiskuar asetet kriminale:

- Organizimi i trajnimeve për njohjen me instrumentet ndërkombëtare në këtë fushë;
- Shkëmbimin e eksperiencave më të mira.

Në kuadër të përmbushjes së masave të parashikuara në Strategjinë Afatmesme të Prokurorisë për periudhën 2018-2020, më poshtë paraqesim treguesit sasiorë dhe cilësorë në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale për vitin 2018, sipas fushave përkatëse.

3.1. Ekstradime

i. Ekstradime nga jashtë

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur gjithsej 171 kërkesa ekstradimi për shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të tjera pasi janë shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat shqiptare.

Krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2018 vërehet ulje e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e shtetasve nga jashtë në masën 11,8 %, për shkak se gjatë kësaj periudhe është ulur numri i shtetasve shqiptarë të arrestuar jashtë vendit.

Më poshtë paraqesim në formë tabelore dhe grafike të dhënat për periudhën 2015-2016-2017-2018:


	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Nr. kërkesave për ekstradim	107	132	194	171



Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2018, numri më i madh i kërkesave për ekstradim vijon t'i jetë paraqitur autoriteteve italiane, greke, gjermane, britanike, franceze përkatësisht me nga 47, 26, 19 14 dhe 11 kërkesa; 6 kërkesa janë paraqitur për autoritetet gjyqësore amerikane, hungareze dhe spanjolle, si dhe 5 Zvicrës, 3 kërkesa Kosovës etj.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*), si dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

Shteti	Viti 2017	Viti 2018
Kosovë	5	3
Zvicër	9	5
Spanjë	8	6
Hungari	1	6
SH.B.A	6	6
Francë	3	11
Angli	6	14
Gjermani	27	19
Greqi	55	26
Itali	38	47




ii. Ekstradime për jashtë

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2018 janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimin drejt shteteve të tjera 128 shtetas (shqiptarë apo të huaj), një tregues ky i cili rezulton me ulje në masën 11,7% krahasuar me vitin 2017.

Ekstradime për jashtë		
Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
99	145	128

Vlen të theksohet se, ashtu sikurse edhe vitet e kaluara për disa subjekte të arrestuar me qëllim ekstradimi në Itali, autoritetet italiane kanë paraqitur kërkesa për njohjen e vendimeve penale duke konvertuar kështu, procedurën e ekstradimit me atë të njohjes me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të dhënë nga këto autoritete në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Sikurse paraqitet në grafikun e mëposhtëm për sa i takon volumit të ekstradimeve për jashtë gjatë periudhës 2017-2018, rezulton se viti 2017 zë 53 % të volumit në raport me periudhën 2-vjeçare, ndërsa viti 2018 përbën 47 %.



Gjatë vitit 2018 numri më i lartë i kërkesave të ekstradimit për shtetasit shqiptarë ose të huaj, të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur nga Italia me 71 kërkesa, Kosova 8 kërkesa, Gjermania dhe Zvicra me nga 6 kërkesa, Austria, Kroacia, Mali i Zi me nga 4 kërkesa etj.


Sa më sipër, paraqitet grafikisht:

Shteti	Viti 2017	Viti 2018
Austri	5	4
Kroaci	3	4
Mali i Zi	1	4
Gjermani	6	6
Serbi	4	2

Zvicër	4	6
Maqedoni	7	1
Kosovë	5	8
Itali	91	71

Ekstradime për jashtë

■ Viti 2018 ■ Viti 2017



Në kuadër të paraqitjes së kërkesave nga autoritetet e huaja për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuuese apo për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë, theksojmë se, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë gjatë vitit 2018 i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në **30 raste**, zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së

këtyre shtetasve, brenda objektit të nenit 3, pika 1/d (*fusha e zbatimit*) dhe nenin 8/1 (*verifikimet paraprake*) të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

3.2. Letërporositë

i. Letërporositë nga jashtë


Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2018 janë transmetuar 668 letërporosi, tregues i cili rezulton me ulje në masën 9,1 % krahasuar me vitin 2017, vit në të cilin janë transmetuar 735 letërporosi.



Duke iu referuar të dhënave statistikore konstatohet se, numri më i lartë i kërkesave ka ardhur nga shtetet kufitare si, Greqia me 169 letërporosi, Kosova me 71, Portugalia 57, Maqedonia 53, Italia 41, Gjermania 38, Hungaria dhe Sllovenia nga 26, Mali i Zi, Turqia dhe Holanda kanë dërguar 25 letërporosi etj.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Letërporosi nga Jashtë



Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar në Shqipëri kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- **63 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **trafikeve të paligjshme**, ndër janë dërguar nga shtete si Kosova, Italia etj.;
- **98 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **falsifikimit të dokumenteve**, ndër janë dërguar nga shtete si Portugalia, Holandë, Slloveni, Mali i Zi, Hungari etj.;
- **20 letërporosi** për vepra penale të kryera nga **organizata kriminale**, ndër të cilat 6 kanë ardhur nga Itali, 4 nga Franca etj.;

- **12 letërporosi** për veprën penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**, nga shtete si Holanda, Mbretëria e Belgjikës, Franca, Kosova, Polonia etj.;
- **9 letërporosi** për veprën penale të **mashtimit**;
- **2 letërporosi** për veprat penale të **terrorizmit**;
- **2 letërporosi** për veprat penale të **krimin kibernetik**;
- **1 letërporosi** për veprën penale të **dhunës në familje**;

ii. Letërporositë për jashtë

Gjatë vitit 2018, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore i kanë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 782 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të ushtrimit në vendin tonë të ndjekjes penale ndaj shtetasve shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2017.

Letërporosi për jashtë	
Viti 2017	Viti 2018
512	782



iii. ***Letërkërkesat sipas veprave penale të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda***

Gjatë vitit 2018, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- **206 letërporosi për autoritetet e huaja (ose 26 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **trafiqeve të paligjshme**, përfshirë këtu trafikimin e femrave, të të miturve, personave të rritur, trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e mjeteve motorike;
- **175 letërporosi (ose 22 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprës penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**;
- **59 letërporosi (ose 8 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **krimit kibernetik**, të cilat i janë drejtuar shteteve si, SHBA, Britani e Madhe, Nigeri, Gjermani, Suedi etj.;
- **97 letërporosi (ose 12 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **falsifikimit të dokumenteve**;
- **33 letërporosi (ose 4 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **mashtimit**;


- **29 letërporosi (ose 4 % e totalit të letërporosive)** në kuadër të procedimeve për kryerjen e **krimeve kundër jetës të kryera me dashje**;
- **8 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **dhunës në familje**;
- **4 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **korupsionit** aktiv apo pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, apo korupsionit të personave që ushtrojnë funksione publike;
- **40 letërporosi** drejtuar autoriteteve amerikane të drejtësisë në kuadër të veprës penale të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatave kriminale;

3.3 Njohjet e vendimeve penale

i. Njohjet e vendimeve penale të huaja

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, për vitin 2018 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 48 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues ky i cili rezulton me ulje në masën 17 % krahasuar me vitin 2017, në të cilin është kërkuar njohja e vendimeve penale në 58 raste.


Njohje Vendimesh Penale të Huaja




Sikurse vërehet në tabelën e mëposhtme por edhe në të dhënat e tjera statistikore rezulton se, Italia, Greqia dhe Kosova kanë vijuar të zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje, etj., ndërsa shtete si Belgjika, Mal i Zi, Maqedonia, Rumania, Spanja, Turqia dhe Zvicra kanë paraqitur secila nga një kërkesë për njohjen me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të dhënë prej tyre në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Njohje vendimesh penale të huaja

	Viti 2017	Viti 2018
Kosovë	5	7
Itali	42	29
Greqi	4	5

ii. *Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit*

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2018 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 11 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, tregues me ulje krahasuar me vitin 2017, në të cilin u paraqitën 19 kërkesa.



Në tabelën e mëposhtme, shihet qartë se numri më i lartë i kërkesave i është dërguar autoriteteve kosovare me 7 të tilla, duke vijuar më pas me nga 1 kërkesë drejtuar Greqisë, Turqisë, Maqedonisë dhe Kroacisë.


Njohje vendimesh penale shqiptare jashtë vendit		
	Viti 2017	Viti 2018
Kosovë	12	7
Greqi	0	1
Turqi	0	1
Maqedoni	1	1
Kroaci	0	1
Gjermani	2	0
Totali	19	11

3.4 Transferimet e procedimeve penale

i. Transferimet e procedimeve penale

Gjatë vitit 2018 është kërkuar në 20 raste transferimi i procedimeve penale nga jashtë me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, duke konstatuar rritje të këtij treguesi

krahasuar me vitin 2017, në të cilin është kërkuar transferimi në 13 raste, ndërsa janë transferuar nga Shqipëria gjithsej 14 procedime penale.



Më konkretisht, autoritetet e huaja gjyqësore kanë paraqitur kërkesa për transferimin në Shqipëri të procedimeve penale të cilët në terma sasiorë paraqiten përkatësisht, Çekia 1, Greqia 1, Kroacia 1, Serbia 1, Sllovenia 1, Mal i Zi 7 dhe Kosova 8.

Ndërsa, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore shqiptare kanë vendosur transferimin e 7 procedimeve penale drejt Kosovës, 5 drejt Italisë, 1 Suedisë dhe Belgjikës.

3.5 Transferimet e personave të dënuar

i. *Transferimet nga jashtë vendit të personave të dënuar*


Gjatë vitit 2018 janë paraqitur 4 kërkesa për transferimin e subjekteve të dënuar nga jashtë, e më konkretisht nga Anglia 2 kërkesa, Italia dhe Suedia nga 1 kërkesë.

Viti	2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Transferimi i të dënuarve nga jashtë	56	33	9	4



ii. *Transferimet për jashtë vendit të personave të dënuar në Shqipëri*

Në vitin 2018 janë paraqitur 10 kërkesa për transferimin jashtë vendit të subjekteve të dënuar nga autoritetet shqiptare, duke konstatuar rritje krahasuar me vitin 2017, në të cilin është kërkuar transferimi në 9 raste.




3.6 Urdhrat e arrestit ndërkombëtar

Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2018 Prokuroria Shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 256 shtetas (shqiptarë apo të huaj) të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë ose ndaj tyre me vendim Gjykate është caktuar një masë

sigurimi personal “Arrest në burg”. Ky tregues ka pësuar ulje në masën 1.5 % krahasuar me vitin 2017, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 260 persona.

Gjithashtu, Prokuroria ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 63 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar, kjo për shkaqe të ndryshme si, arrestimi i tyre në territorin shqiptar apo shuarja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit të dhënë me vendim të formës së prerë.



Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka trajtuar në kohë reale gjatë vitit 2018 edhe **401 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

3.7 Skuadrat e përbashkëta hetimore

Gjatë vitit 2018 janë nënshkruar 3 Marrëveshje për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, në kuadër të çështjeve penale të regjistruara për veprën penale të “*Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*”.

Objekti i veprimtarisë së skuadrave të përbashkëta hetimore, përfshin kryerjen e veprimeve hetimore në territoret e dy Shteteve Palë të Marrëveshjes, ndër të cilat përmenden:

- Identifikimi i aktiviteteve dhe strukturave të organizatave kriminale;
- Identifikimi i roleve përkatëse të anëtarëve të organizatës, furnizuesve të lëndëve narkotike dhe pritësve të tyre;

- Identifikimi i vendeve të kultivimit dhe depozitimit të lëndëve narkotike si dhe mjetet dhe mënyrat e përgatitjes dhe maskimit/fshehjes;
- Verifikimi i mënyrës së transportit dhe gatishmërisë së mjeteve që përdoren për transportin e tyre;
- Verifikimi i ekzistencës së financuesve eventuale të trafikut të lëndëve narkotike si dhe mënyrat e riinvestimit të të ardhurave të mëdha të siguruara, duke treguar dhe emra përkatës.

Gjithashtu është në proces nënshkrimi një marrëveshje e katërt për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore me Italinë, e cila do të koordinohet nga Eurojust. Po ashtu, dy nga skuadrat e cituara më lart janë ngritur dhe do të realizojnë aktivitetet e miratuara me mbështetjen e Eurojust.

EUROJUST

Në datë 05.10.2018 Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i Eurojust nënshkruan në Tiranë Marrëveshjen për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust. Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, lehtësimin dhe bashkërendimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale që mbulojnë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të BE, për zhvillimin e një bashkëpunimi të ngushtë dhe dinamik për të përballuar sfidat e së tashmes dhe të ardhshme që paraqiten nga kryerja e veprave penale nga krimi i organizuar dhe terrorizmi. Autoritet kompetent për zbatimin e Marrëveshjes është Prokuroria e Përgjithshme, e cila në të ardhmen e afërt do të caktojë një Prokuror ndërlidhës të atashuar në Eurojust.

Memorandume

Në vitin 2018, **Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë** ka nënshkruar një **Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme të Bullgarisë** me qëllim forcimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit, si dhe mirëkuptimin e tyre të ndërsjellët mbi nevojën për bashkëpunim të efektshëm.

IV. GARANTIMI INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE


“Sektori i Verifikimit të Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në Prokurorinë e Përgjithshme ka filluar funksionimin pas hyrjes në fuqi të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 17/2016. Ky sektor vijon të jetë pjesë e Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe në përbërje ka prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore.

Në vijim të punës së këtij sektori për vitin 2018, janë administruar, **185 raste për verifikim të thelluar**.

Departamenti i Administratës Publike ka kërkuar verifikim të thelluar për **137 subjekte**.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar verifikim të thelluar për **5 subjekte**.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2018, ka kërkuar verifikim për **43 subjekte vetëdeklaruese**.
(Shiko grafikun me poshtë).




5.1. Për vitin 2018, në total për **147 subjekte vetëdeklaruese** është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit. Kërkesat e tjera prej 30 rastesh vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në Ligjin Nr. 138/2015 dhe vendimin Nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Ndërkohë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, **8 praktika ka vendosur t'u ndërprerë procesin e verifikimit pasi ka rezultuar që nuk kanë qenë më subjekte vetëdeklarimi sipas ligjit Nr. 138/2015.**

5.2 Për **39** subjekte, Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme ka vendosur se përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015 si dhe Vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016.

- Për 8 subjekte ose 20.5 % të rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa a) të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Për 1 subjekt ose 2.5 % të rasteve, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa b) të ligjit 138/2015.
- Për 8 subjekte ose 18 % të rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa c) të ligjit 138/2015.
- Për 14 subjekte ose 36 % e rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa ç) të ligjit 138/2015.
- Për 8 subjekte ose 20.5 % të rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të të Vendimit Nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë për arsye të mosdeklarimit të të dhënave në lidhje me dënimet penale.

Grafiku më poshtë paraqet në përqindje, vendimmarrjen për subjektet që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit Nr. 138/2015 për vitin 2018.




Për 108 subjekte, pasi ka kryer një verifikim të plotë e të thelluar Sektori i Verifikimit të Integritetit, ka vendosur se nuk përfshihen në fushën e ndalimeve sipas ligjit 138/2015.

5.3. Subjektet e përcjellë për verifikim, për të cilët është marrë vendim, janë të kategorizuar sipas nivelit hierarkik si më poshtë:

- Nëpunës të nivelit ekzekutiv, 27 subjekte ose 18.4 % e rasteve;
- Nëpunës, të nivelit të mesëm drejtues, 45 subjekte ose 30.6 % e rasteve;
- Nëpunës të nivelit drejtues, 30 subjekte ose 20.4 % e rasteve;
- Zyrtarë të Lartë, 45 subjekte ose 30.6 % e rasteve;

Gjatë vitit 2018 ka përfunduar verifikimi për 45 zyrtarë të lartë. Nga të cilët, për 44 prej tyre, është vendosur se nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, ndërsa për 1 prej tyre pas verifikimit të të dhënave kanë rezultuar se përfshihet në fushën e veprimtimit sipas ligjit 138/2015.

Grafiku më poshtë paraqet në përqindje, subjektet të kategorizuara sipas nivelit hierarkik.



5.3 Të dhënat lidhur me referimet pranë Prokurorive

Nga 147 vendime “Për miratimin e rezultateve të verifikimit” të cilat ju janë njoftuar institucioneve përkatëse, 31 materiale referuese, i janë dërguar për kompetencë Prokurorive të Juridiksioneve përkatëse pasi kanë rezultuar, se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular duke konsumuar veprën penale të “Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve” parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

V. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORIVE PËR VITIN 2018

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kanë sanksionuar se Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- ç) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2018, numri i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve ishte 336. Shpërndarja³⁴ e tyre në prokurori sipas niveleve ka qenë, 291 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 29 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 16 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 323.

Në vitin 2018 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për çdo prokurori paraqitet si vijon:

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë	Prokurorë		Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	77	76	41	41	60	60	178	177
Berat	6	6	3	3	7	7	16	16
Dibër	6	6	2	2	6	6	14	14
Durrës	26	25	13	13	18	18	57	56

³⁴ Janar 2018

Elbasan	25	25	10	10	14	14	49	49
Gjirokastrë	5	5	2	2	9	9	16	16
Fier	14	14	7	7	14	14	35	35
Korçë	13	11	6	6	16	16	35	33
Krujë	6	5	3	3	5	5	14	13
Kukës	4	3	2	2	6	6	12	11
Lushnje	7	7	3	3	8	8	18	18
Lezhë	10	10	5	5	9	9	24	24
Mat	3	3	2	2	3	3	8	8
Përmet	2	2	1	1	3	3	6	6
Pukë	3	2	2	2	3	3	8	7
Pogradec	4	4	2	2	5	5	11	11
Sarandë	5	5	2	2	5	5	12	12
Shkodër	19	19	10	10	13	13	42	42
Tropojë	3	3	1	1	3	3	7	7
Vlorë	20	18	9	9	15	15	44	42
Kavajë	7	6	3	3	6	6	16	15
Kurbin	4	4	2	2	5	5	11	11
Prokuroria për Krime të Rënda	22	20	15	15	25	25	62	60

Prokuroritë pranë gjykatave të apelit	Prokurorë		Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	9	9	1	1	8	8	18	18
Durrës	5	5			5	5	10	10
Gjirokastrë	2	2			2	2	4	4
Vlorë	5	5			3	3	8	8
Shkodër	4	4			4	4	8	8
Korçë	2	2			4	4	6	6
Apeli për Krime të Rënda	2	2			6	6	8	8

Prokuroria e Përgjithshme	Prokurorë		Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	16	15	21	21	69	69	106	105


Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa analizohet në vijim. Vlen të theksohet se numri i çështjeve nuk është treguesi i vetëm i ngarkesës së punës së një prokurori. Komplexiteti dhe volumi i akteve hetimore në çështje të lidhura me krimin e organizuar, terrorizmin, trafiket, krimin ekonomik, pastrimin e parave dhe korrupsionin, është shumë i lartë.

I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë

I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi

Gjatë vitit 2018, në organin e prokurorisë janë trajtuar 57734³⁵ materiale kallëzuese. Janë ndjekur gjithsej 42814 procedime penale, nga të cilat 31409 janë procedime penale të regjistruara dhe 486 procedime penale të rifilluara. Janë mbartur nga viti 2017, 10919 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 14920 referime dhe kallëzime penale. Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2018 paraqitet si vijon:




Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2018 sipas prokurorive të shkallës së parë është si më poshtë:

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë ndjekur 1898 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë ndjekur 987 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë ndjekur 5152 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë ndjekur 3788 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë ndjekur 2871 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë ndjekur 1483 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë ndjekur 1047 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë ndjekur 2791 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë ndjekur 1172 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë ndjekur 699 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbini janë ndjekur 899 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë ndjekur 2127 çështje;

³⁵ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura nga viti 2017; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2018 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2018; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2018.


Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë ndjekur 1617 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë ndjekur 360 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë ndjekur 214 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë ndjekur 1034 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë ndjekur 230 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë ndjekur 1849 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë ndjekur 3357 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë ndjekur 18924 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë ndjekur 447 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë ndjekur 4121 çështje;
Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda janë ndjekur 667 çështje;

Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:



Në vitin 2018 volumi i punës që ka pasur çdo prokuror³⁶ sipas prokurorisë ku ushtron funksionet është mesatarisht si më poshtë:

³⁶ Mesatarja është përlogaritur si raport i volumit në hetim me numrin faktik të prokurorëve, përfshirë drejtuesit dhe zëvendës drejtuesit.




I.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2018 është si vijon:


Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 952 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 587 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2779 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 2371 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 1803 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 655 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 528 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 1531 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 719 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 389 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 450 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 1177 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 849 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë regjistruar 166 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 100 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 507 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë regjistruar 135 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 951 procedime penale;

Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 2166 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9867 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë regjistruar 200 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 2297 procedime penale;
 Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda janë regjistruar 210 procedime penale.


Grafiku më poshtë paraqet të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2018:



Ndërkohë, numri i të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë, paraqitet në grafikun më poshtë:



Mesatarisht³⁷ prokurorët kanë ndjekur sipas prokurorive ku ushtrojnë funksionet një numër procedimesh të regjistruara si vijon:



II. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të apelit

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka shqyrtuar 505 çështje themeli dhe 256 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar 127 çështje themeli dhe 111 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka shqyrtuar 247 çështje themeli dhe 158 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar 972 çështje themeli dhe 307 çështje lidhur me masat e sigurimit;


Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka shqyrtuar 2155 çështje themeli dhe 958 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shqyrtuar 668 çështje themeli dhe 333 çështje lidhur me masat e sigurimit;


³⁷ Mesatarja është përlogaritur si raport i numrit të procedimeve të regjistruara me numrin faktik të prokurorëve, përfshirë drejtuesit dhe zëvendës drejtuesit.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ka shqyrtuar 113 çështje themeli dhe 230 çështje lidhur me masat e sigurimit.

Grafikisht të dhënat paraqiten si vijon, ku siç vërehet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe për vitin 2018 ka pasur ngarkesën më të madhe:



Raporti i numrit të çështjeve³⁸ me numrin e prokurorëve sipas prokurorisë përkatëse paraqitet në grafikun në vijim:



³⁸ Përlogaritje mesatare e raportit të totalit të çështjeve të trajtuara me numrin faktik të prokurorëve.

III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 14 çështje.

III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2018 kanë marrë **45** vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore.

III.3 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2018, ka trajtuar:

- Ekstradime nga jashtë - 171 kërkesa;
- Ekstradime për jashtë - 128 shtetas;
- Letërporositë nga jashtë - 668 letërporosi;
- Letërporositë për jashtë - 782 letërporosi;
- Njohjet e vendimeve penale të huaja - 48 kërkesa;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit - 11 kërkesa;
- Transferimet e procedimeve nga jashtë- 20 raste;
- Transferimet e procedimeve për jashtë - 14 procedime penale;
- Transferimet e personave të dënuar nga jashtë - në 4 raste;
- Transferimet e personave të dënuar për jashtë - 10 kërkesa.

Gjatë vitit 2018 prokuroria ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej **256 shtetas** dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e **63 subjekteve** nga listat e kërkimit ndërkombëtar.

Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka trajtuar në kohë reale gjatë vitit 2018 edhe **401 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

III.4 Përgjimet

Gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar gjithsej 3063 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 715 procedime penale. Nga këto, 147 procedime penale kanë qenë në kuadër të hetimeve të prokurorisë për krime të rënda. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 4168 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

III.5 Dekriminalizimi

Sektori i Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2018, ka administruar 185 raste për verifikim të thelluar.

Gjatë kësaj periudhe, për 147 subjekte vetëdeklaruese është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 30 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.


IV. Kompetenca të tjera

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë marrë 45 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore.

Një kontribut i rëndësishëm i prokurorisë gjatë periudhës raportuese ka qenë ai i ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve. Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka dorëzuar 83 raporte të vlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit kalimtar, deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në muajin dhjetor 2018.

IV. Ngarkesa në pesë vitet e fundit

Volumi në hetim në shkallë vendi në pesë vitet e fundit, ku numri organik i prokurorëve ka qenë 336, paraqitet grafikisht në vijim:



Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2014	2015	2016	2017	2018
Berat	Volumi në hetim	2120	1986	1962	2122	1898
	Numri i prokurorëve	6	7	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	353.3333	283.7143	327	353.6667	316.3333
Dibër	Volumi në hetim	889	855	798	1228	987
	Numri i prokurorëve	5	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	177.8	142.5	133	204.6667	164.5
Durrës	Volumi në hetim	4481	4750	4104	4678	5152
	Numri i prokurorëve	28	26	26	26	26
	Mesatarja për prokuror	160.0357	182.6923	157.8462	179.9231	198.1538
Elbasan	Volumi në hetim	4577	4451	4023	3815	3788
	Numri i prokurorëve	23	25	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	199	178.04	160.92	152.6	151.52
Fier	Volumi në hetim	3073	3141	2688	2621	2871
	Numri i prokurorëve	15	16	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	204.8667	196.3125	192	187.2143	205.0714
Gjirokastrë	Volumi në hetim	1419	1245	1442	1577	1483
	Numri i prokurorëve	6	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	236.5	249	288.4	315.4	296.6
Kavajë	Volumi në hetim	1269	1096	1203	1171	1047
	Numri i prokurorëve	7	6	7	7	7

Korçë	Mesatarja për prokuror	181.2857	182.6667	171.8571	167.2857	149.5714
	Volumi në hetim	2842	2485	2346	2465	2791
	Numri i prokurorëve	13	15	13	13	13
Kr. e Rënda	Mesatarja për prokuror	218.6154	165.6667	180.4615	189.6154	214.6923
	Volumi në hetim	544	769	671	722	667
	Numri i prokurorëve	17	16	20	22	22
Krujë	Mesatarja për prokuror	32	48.0625	33.55	32.81818	30.31818
	Volumi në hetim	1190	1196	1229	1051	1172
	Numri i prokurorëve	7	7	7	6	6
Kukës	Mesatarja për prokuror	170	170.8571	175.5714	175.1667	195.3333
	Volumi në hetim	956	1008	912	781	699
	Numri i prokurorëve	4	5	4	4	4
Kurbini	Mesatarja për prokuror	239	201.6	228	195.25	174.75
	Volumi në hetim	980	1021	874	919	899
	Numri i prokurorëve	4	5	4	4	4
Lezhë	Mesatarja për prokuror	245	204.2	218.5	229.75	224.75
	Volumi në hetim	2560	2179	1894	1868	2127
	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	10
Lushnje	Mesatarja për prokuror	256	217.9	189.4	186.8	212.7
	Volumi në hetim	1648	1730	1702	1791	1617
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
Mat	Mesatarja për prokuror	235.4286	247.1429	243.1429	255.8571	231
	Volumi në hetim	486	477	522	445	360
	Numri i prokurorëve	4	5	3	3	3
Përmet	Mesatarja për prokuror	121.5	95.4	174	148.3333	120
	Volumi në hetim	187	217	279	240	214
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
Pogradec	Mesatarja për prokuror	93.5	108.5	139.5	120	107
	Volumi në hetim	768	879	924	947	1034
	Numri i prokurorëve	5	5	4	4	4
Pukë	Mesatarja për prokuror	153.6	175.8	231	236.75	258.5
	Volumi në hetim	465	434	322	280	230
	Numri i prokurorëve	3	4	3	3	3
Sarandë	Mesatarja për prokuror	155	108.5	107.3333	93.33333	76.66667
	Volumi në hetim	1833	1624	1605	1761	1849
	Numri i prokurorëve	6	5	5	5	5
Shkodër	Mesatarja për prokuror	305.5	324.8	321	352.2	369.8
	Volumi në hetim	3440	4047	4526	3654	3357
	Numri i prokurorëve	18	19	19	19	19
Tiranë	Mesatarja për prokuror	191.1111	213	238.2105	192.3158	176.6842
	Volumi në hetim	17359	17868	18452	19541	18924
	Numri i prokurorëve	70	73	78	77	77
Tropojë	Mesatarja për prokuror	247.9857	244.7671	236.5641	253.7792	245.7662
	Volumi në hetim	484	622	415	431	447
	Numri i prokurorëve	2	4	3	3	3
Vlorë	Mesatarja për prokuror	242	155.5	138.3333	143.6667	149
	Volumi në hetim	3675	4449	4458	4183	4121
	Numri i prokurorëve	22	20	20	20	20
	Mesatarja për prokuror	167.0455	222.45	222.9	209.15	206.05

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2014	2015	2016	2017	2018
Durrës	Volumi	1248	1205	1143	1182	761
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	249.6	241	228.6	236.4	152.2
Gjirokastrë	Volumi	416	418	389	318	238
	Numri i prokurorëve	1	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	416	209	194.5	159	119
Korçë	Volumi	439	537	355	469	405
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	219.5	268.5	177.5	234.5	202.5
Shkodër	Volumi	854	949	1279	1110	1279
	Numri i prokurorëve	3	3	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	284.6667	316.3333	319.75	277.5	319.75
Tiranë	Volumi	2931	4197	3919	3200	3113
	Numri i prokurorëve	10	8	9	9	9
	Mesatarja për prokuror	293.1	524.625	435.4444	355.5556	345.8889
Vlorë	Volumi	1379	1524	1436	1261	1001
	Numri i prokurorëve	4	4	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	344.75	381	287.2	252.2	200.2
Krimet e Rënda	Volumi	395	382	434	394	343
	Numri i prokurorëve	3	2	2	2	2

Mesatarja për prokuror	131.6667	191	217	197	171.5
------------------------	----------	-----	-----	-----	-------

Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2014	2015	2016	2017	2018
Berat	Volumi në hetim	2120	1986	1962	2122	1898
	Numri i prokurorëve	6	7	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	353.3333	283.7143	327	353.6667	316.3333
Dibër	Volumi në hetim	889	855	798	1228	987
	Numri i prokurorëve	5	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	177.8	142.5	133	204.6667	164.5
Durrës	Volumi në hetim	4481	4750	4104	4678	5152
	Numri i prokurorëve	28	26	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	160.0357	182.6923	164.16	187.12	206.08
Elbasan	Volumi në hetim	4577	4451	4023	3815	3788
	Numri i prokurorëve	23	25	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	199	178.04	160.92	152.6	151.52
Fier	Volumi në hetim	3073	3141	2688	2621	2871
	Numri i prokurorëve	15	16	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	204.8667	196.3125	192	187.2143	205.0714
Gjirokastrë	Volumi në hetim	1419	1245	1442	1577	1483
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	283.8	249	288.4	315.4	296.6
Kavajë	Volumi në hetim	1269	1096	1203	1171	1047
	Numri i prokurorëve	7	6	7	6	6
	Mesatarja për prokuror	181.2857	182.6667	171.8571	195.1667	174.5
Korçë	Volumi në hetim	2842	2485	2346	2465	2791
	Numri i prokurorëve	12	14	12	11	11
	Mesatarja për prokuror	236.8333	177.5	195.5	224.0909	253.7273
Kr. e Rënda	Volumi në hetim	544	769	671	722	667
	Numri i prokurorëve	16	16	20	20	20
	Mesatarja për prokuror	34	48.0625	33.55	36.1	33.35
Krujë	Volumi në hetim	1190	1196	1229	1051	1172
	Numri i prokurorëve	7	7	7	5	5
	Mesatarja për prokuror	170	170.8571	175.5714	210.2	234.4
Kukës	Volumi në hetim	956	1008	912	781	699
	Numri i prokurorëve	4	4	4	3	3
	Mesatarja për prokuror	239	252	228	260.3333	233
Kurbini	Volumi në hetim	980	1021	874	919	899
	Numri i prokurorëve	3	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	326.6667	255.25	218.5	229.75	224.75
Lezhë	Volumi në hetim	2560	2179	1894	1868	2127
	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	10
	Mesatarja për prokuror	256	217.9	189.4	186.8	212.7

Lushnje	Volumi në hetim	1648	1730	1702	1791	1617
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	235.4286	247.1429	243.1429	255.8571	231
Mat	Volumi në hetim	486	477	522	445	360
	Numri i prokurorëve	3	5	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	162	95.4	174	148.3333	120
Përmet	Volumi në hetim	187	217	279	240	214
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	93.5	108.5	139.5	120	107
Pogradec	Volumi në hetim	768	879	924	947	1034
	Numri i prokurorëve	4	5	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	192	175.8	231	236.75	258.5
Pukë	Volumi në hetim	465	434	322	280	230
	Numri i prokurorëve	3	4	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	155	108.5	161	140	115
Sarandë	Volumi në hetim	1833	1624	1605	1761	1849
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	366.6	324.8	321	352.2	369.8
Shkodër	Volumi në hetim	3440	4047	4526	3654	3357
	Numri i prokurorëve	18	19	19	19	19
	Mesatarja për prokuror	191.1111	213	238.2105	192.3158	176.6842
Tiranë	Volumi në hetim	17359	17868	18452	19541	18924
	Numri i prokurorëve	70	73	77	76	76
	Mesatarja për prokuror	247.9857	244.7671	239.6364	257.1184	249
Tropojë	Volumi në hetim	484	622	415	431	447
	Numri i prokurorëve	2	4	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	242	155.5	138.3333	143.6667	149
Vlorë	Volumi në hetim	3675	4449	4458	4183	4121
	Numri i prokurorëve	22	20	20	18	18
	Mesatarja për prokuror	167.0455	222.45	222.9	232.3889	228.9444

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2014	2015	2016	2017	2018
Durrës	Volumi	1248	1205	1143	1182	761
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	249.6	241	228.6	236.4	152.2
Gjirokastrë	Volumi	416	418	389	318	238
	Numri i prokurorëve	1	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	416	209	194.5	159	119

Korçë	Volumi	439	537	355	469	405
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	219.5	268.5	177.5	234.5	202.5
Shkodër	Volumi	854	949	1279	1110	1279
	Numri i prokurorëve	3	3	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	284.6667	316.3333	319.75	277.5	319.75
Tiranë	Volumi	2931	4197	3919	3200	3113
	Numri i prokurorëve	10	8	8	9	9
	Mesatarja për prokuror	293.1	524.625	489.875	355.5556	345.8889
Vlorë	Volumi	1379	1524	1436	1261	1001
	Numri i prokurorëve	3	4	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	459.6667	381	287.2	252.2	200.2
Krimet e Rënda	Volumi	395	382	434	394	343
	Numri i prokurorëve	3	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	131.6667	191	217	197	171.5

VI. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS FINANCIARE DHE

ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL PËR VITIN 2018

Raporti i monitorimit 2018

Në mbështetje të ligjit nr.109, date 30.11.2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore" si dhe udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.2, datë 19.01.2018, "Për zbatimin e Buxhetit për vitin 2018", më poshtë po paraqesim të përmbledhur raportin e monitorimit për vitin 2018, për Prokurorinë e Përgjithshme.

Buxheti i akorduar për programin "Menaxhim, Administrim, Planifikim" i Prokurorisë së Përgjithshme ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2018-2020. Në zbatim të ligjit nr.109, date 30.11.2017 "Për Buxhetin e vitit 2018" dhe korrespondencës me Ministrinë e Financave, është miratuar çelja e fondeve buxhetore për vitin 2018 për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme. Fondet e akorduara dhe realizimi faktik për funksionimin e aktivitetit të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas zërave (në 000/leke), për vitin 2018 paraqiten si më poshtë:

000/leke					
Emërtimi	Plani Fillestar 2018	Ndryshimet	Plani Përfundimtar	Realizimi Faktik	Realizimi Në %
Paga	1,012,000	+4,500	1,016,500	1,014,511	99.8
Sigurime Shoqërore	188,000	-42,600	145,400	143,741	98.8
Shpenzime Operative	348,905		348,905	342,914	98.2
Transferta me Jashtë	95	-	95	83	87.3
Fondi i Veçantë	0	0	2,819	2,819	100
Investime	130,000	-38,065	91,935	90,640	98.5
TOTALI:	1,679,000	0	1,605,654	1,594,769	99.3

Siç vërehet fondi i akorduar nga buxheti i shtetit (fondi i rishikuar) për **shpenzime personeli** është 1.161.900 (mijë lekë) që përbën 72,3 % të totalit të buxhetit të të gjithë prokurorisë.

Numri i punonjësve i miratuar me ligjin nr.109, date 30.11.2017 "Për Buxhetin e vitit 2018" ishte 863 por nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij. Kështu në fund të vitit

2018 rezultuan 26 vende vakante për prokurorë të cilët në bazë të ndryshimeve ligjore, duhet të emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2018 për **shpenzime për mallra dhe shërbime** të tjera është 348.905 (mijë lekë), që përbën **21,7** % të totalit të buxhetit të rishikuar. Ky fond në fund të vitit është realizuar 98,2 %.

Gjatë vitit 2018 janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e faturave të papaguara në afat për ekspertë mjeko-ligjore dhe MNZ (rreth 119,898 mijë lekë). Fondet kanë qenë të mjaftueshme për likuidim të të gjitha detyrimeve në afat.

Fondi i **investimeve** akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2018 ka qenë 130.000 (mijë lekë) dhe realizimi paraqitet në masën 98,5 %.

Gjatë vitit 2018 janë rialokuar disa prej fondeve duke shfrytëzuar kursimet nga tenderat e përfunduar. Ky realizim paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emri i produktit	Sasia e Planifikuar në mijë lekë	Sasia e Realizuar në mijë lekë
Rikonstruksion godine	3.319	3.297
Pajisje kompjuterike	35.093	34.366
Kolaudatore supervizore	122	74
Pajisje e orendi zyre	2.967	2.748
Blerje dhe instalim kondicioneri	1.648	1.507
Blerje pajisje sigurie e kamera	2.804	2.708
Blerje pajisjeve të përgjimit	45.622	45.622
Blerje të tjera pajisje teknike	360	318
TOTALI:	91.935	90.640

Kërkesat në projektbuxhetin 2019

Nisur nga dinamika gjithmonë në rritje të numrit të procedimeve dhe hapave organizative që synon të ndërmarrë Prokuroria e Përgjithshme për t'ju përshtatur ndryshimeve të fundit ligjore me infrastrukturë operacionale dhe kapacitete njerëzore, është kërkuar në kuadër të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2019-2021 shtimi i organikës me 105 punonjës, ndërkohë janë miratuar 65 punonjës shtesë.

Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

Për vitin 2018, sipas kalendarit vjetor të auditimeve, janë miratuar nga ana e titullarit, 12 angazhime auditimi gjithsej, nga të cilat 11 të kombinuara dhe 1 auditim pjesor (pajtueshmërie e të tjera), ndërkohë që janë kryer gjithsej 9 misione auditimi nga të cilat 8 misione të kombinuara dhe një tematik.

Subjektet që u audituan janë prokuroritë e shkallës së parë Sarandë, Lezhë, Durrës, Kurbin, Shkodër, Pogradec, Apeli Durrës, Apeli Shkodër si dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Në fazën e planifikimit të angazhimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të mesëm, dhe aty është fokusuar auditimi.

Mbështetur në përvojën e audituesve, në analizat e detajuara të problematikave të hasura përgjatë angazhimeve si dhe specifikave të aktivitetit në njësitë vartëse, fokusi i fushave prioritare, mbi të cilat janë fokusuar e materializuar programet e auditimit, kanë qenë si më poshtë:

- Prokurimet e fondeve publike dhe zbatimi i kuadrit rregullator për investimet;
- Në fushën e investimeve publike me financim të brendshëm;
- Administrimi i vlerave materiale e monetare;
- Shkelje, shpërdorime dhe mungesë dokumentacioni justifikues për shpenzimet e kryera për udhëtime e dieta;
- Zbatimi i rregullave të kontabilitetit publik, ruajtja dhe administrimi i pronës;
- Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimi i aseteve dhe burimeve nga subjektet e audituara etj.

Nga misionet e ushtruara në subjekte janë përcaktuar risqet kryesore të identifikuar dhe janë marrë masa për analizimin dhe trajtimin e këtyre risqeve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e komponentëve të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar Publik.

Nga misionet e auditimit për vitin 2018 në subjektet e audituara, janë dhënë 50 rekomandime gjithsej, të strukturuar sipas kësaj tipologjie:

- a) 2 rekomandime për arkëtim të shumave që janë përfituar padrejtësisht;
- b) 44 rekomandime për masa të karakterit të ndryshëm.

Zbatimi i ligjit për shërbimin civil

Në zbatim të ligjit 152/2013 “për nëpunësin civil” i ndryshuar gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 3 konkurse për praninë në shërbimin civil në pozicionet: specialist prokurimi, specialist arkivi dhe specialist përkthyes.

Gjithashtu është zhvilluar një konkurs ngritje në detyrë për pozicionin përgjegjës sektori.

Gjatë vitit 2018, 2 punonjës në periudhë prove ndoqën programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA.

VII. PRIORITETET NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT

PËR VITIN 2019

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Me synim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale, ngritjes dhe përfaqësimit të çështjes/akuzës në gjyq për krime të rënda dhe me tendenca në rritje, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit në procesin penal, prioritetet e prokurorisë për vitin 2019, janë si më poshtë:

i) Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet:

- Rritjes së hetimeve proaktive dhe teknikave speciale të hetimit.
- Hetimeve pasurore dhe rritjes së numrit të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.
- Forcimit të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese vendase dhe të huaja.
- Cilësisë hetimore në rritje.
- Ashpërsimit të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit.
- Trajnimeve të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore që hetojnë veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

ii) Garantimi i pavarësisë së prokurorëve, integritetit dhe profesionalizmit të tyre në ushtrimin e funksioneve Kushtetuese e ligjore. Prokurorët duhet të kenë kapacitetin, mbështetjen dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar funksionet e ngarkuara me ligj.

-Në kuadrin e reformës në drejtësi, zbatimi i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kërkon marrjen e masave të nevojshme për krijimin e kushteve dhe shtimin e kapaciteteve njerëzore mbështetëse në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

-Në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtarë të prokurorëve janë krijuar (*aktualisht 21 prokuror janë shkarkuar nga detyra dhe/ose janë të pezulluar*) dhe po krijohen mungesa të prokurorëve në të gjitha nivelet e prokurorisë, dhe në mungesë të planifikimit të magjistratëve që nxjerr Shkolla e Magjistraturës deri në vitin 2021, për të përballuar ngarkesën në rritje në veprimtarinë e prokurorëve që ushtrojnë funksionet, krahas masave në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe ndryshimeve strukturore në sistemin e prokurorisë, shtrohet si nevojë emergjente marrja e masave për shtimin e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të numrit në administratën ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

-Ndërkohë, në bashkëpunim me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës kërkohet të merren masat e duhura, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm

-Nuk mund të pretendohet për të rritur efektivitetin e ndjekjes penale dhe për të pasur një prokurori efikase/fortë me numër prokurorësh të pamjaftueshëm, për të përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore të tyre.

iii) **Rritja dhe forcimi i bashkërendimit ndërinstitucional i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale, për të rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale**, si kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që përbëjnë sfidën kryesore në prag të organizimit dhe funksionimit të SPAK-ut, ashtu dhe kundër fenomeneve kriminale, tradicionale, siç janë vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje, etj., krimi ekonomik dhe krimet e tjera të rënda me tendenca në rritje që cenojnë rendin dhe sigurinë publike.

-Forcimi dhe rritja e mëtejshme e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për thellimin dhe intensifikimin e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimeve në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë, si të krimit të organizuar dhe ekonomik brenda vendit dhe të lidhjeve të tij jashtë vendit, ashtu dhe të korrupsionit në nivele qendrore e vendore dhe lidhjet e tij me krimin, duke sekuestruar pasuritë dhe produktet e veprimtarisë kriminale të tyre.

-Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në gjitha fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor me autoritetet gjyqësore të huaja, si për të shkëmbyer informacion lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit. .

-Në kuadrin e bashkëpunimit me aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë penale, situata aktuale vlerësojmë se kërkon edhe hartimin e strategjive të një politike procedimi dhe dënimi më të studiuar dhe më të unifikuar, si në nivel rrethi gjyqësor, në nivel apeli dhe në shkallë vendi, duke garantuar respektimin e parimeve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

iv) **Ngritja e strukturave të posaçme pranë prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe forcimin e kapaciteteve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore** për ushtrimin efikas të ndjekjes penale dhe hetimit pasuror për çështjet që do jenë në kompetencë lëndore e tyre me krijimin e SPAK-ut.

v) Marrja e masave për të adresuar e rekomanduar zgjidhje lidhur me ngarkesën që krijohet në prokurori nga referimet jo cilësore mbi kërkesat e viktimës akuzuese, të cilat proceduralisht duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës³⁹.

³⁹ Është vendosur mosfillimi për 14920 referime dhe kallëzime penale. Ndër to, 1916 ose rreth 13 % e vendime mosfillimi, lidhen me vepra penale të cilat ndiqen me ankim të viktimës akuzuese, në kompetence të drejtpërdrejtë në gjykatë, sipas nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale.

vi) Rritja e përdorimit të instituteve procedurale të reja si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë më efektive për t'i shërbyer shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal.

vii) **Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe nëpunësve civil në prokurori** me qëllimin rritjen e mëtejshme të aftësive profesionale të tyre.

viii) **Nxjerrja e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme me natyrë administrative dhe procedurale, në bashkëpunim me misionin/projektin EURALIUS V, me synim qartësimin e kuptimit dhe zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor përkatës dhe mbikëqyrja e zbatimit tyre**, si më poshtë:

-Rregullorja standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, për të siguruar efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori.

-Udhëzimi “Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet e tij me drejtuesin e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, për të unifikuar, të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me drejtuesin e prokurorisë si prokuror më i lartë dhe informimin e koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për të siguruar mbikëqyrjen, efikasitetin, ligjshmërinë e transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur.

-Udhëzimi “Për informimin e publikut lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale”, për të unifikuar mënyrën e shpërndarjes së informacionit për publikun lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe për të garantuar ruajtjen e sekretit të hetimeve dhe ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale nga prokurori dhe/ose oficerët e policisë gjyqësore.

-Udhëzimi për të unifikuar dhe orientuar prokurorët në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit personal e pasuror dhe për caktimin e masave të dënimit, si në ashpërsimin e politikës së dënimit për disa grupvepra penale dhe krime të rënda të evidentuara me tendencë në rritje, ashtu dhe për zbutjen e politikës së dënimit për disa grupvepra penale të lehta me tendencë në ulje për vitin 2018.

ix) Në bashkëpunim me strukturat e reja që ligji parashikon ngritjen e tyre, implementimin me përgjegjësi dhe efikasitet të kuadrit të pritshëm ligjor për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore.

-Sigurimin e bashkëpunimit, koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë, me të gjitha institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese që kanë shërbime të policisë gjyqësore.

x) **Garantimi i respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale**, nëpërmjet mbikëqyrjes nga prokuroria të respektimit të të drejtave dhe lirive Kushtetuese dhe në ligj të shtetasve, me synim për të siguruar mbrojtjen e lirive dhe drejtën

e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të personave të arrestuar, ndaluar, paraburgosur apo dënuar.

xi) **Përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori** dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë.

Ju faleminderit!

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Shkëmbimi i eksperiencave Rritja e kapaciteteve

2018



I. Trajnimi vazhdues

Shkolla e Magjistraturës kryen trajnimin vazhdues të prokurorëve. Gjatë vitit 2018, prokurorë dhe ndihmës ligjorë kanë marrë pjesë në aktivitetet e mëposhtëme të Shkollës së Magjistraturës:

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 8-9 Janar 2018, me temë: “Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështirim krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale” (24 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 8-9 Janar 2018, me temë: “Masat e sigurimit personal. Roli i gjykatës në kërkesat e bëra për zëvendësimin e tyre në raport me mendimin e prokurorit; Zbatimi i më shumë se një mase sigurimi personal dhe i dënimeve alternative me qëllim uljen e rasteve të zbatimit të masës së sigurisë “arrest me burg” dhe dënimit me burgim; Përzgjedhja dhe zbatimi i masave të Sigurimit Personal, ndaj të miturve në konflikt me ligjin analizë e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit; Seanca e vlerësimit për masën e sigurimit.” (21 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12 Janar 2018, me temë: “Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale. Konventat ndërkombëtare lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale. Vështirim i Shkurtër mbi Konventën e Varshavës, Palermos e Vjenës; Legjislacioni procedural penal mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive; Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe risitë e tij; Prezumimi i regjistrimit të remë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përfshirë në veprat penale përkatëse; Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e veprës penale të pastrimit të parave; Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shenjestrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal.” (31 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12 Janar 2018, me temë: “Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike. Kuadri ligjor lidhur me njoftimet me fokus në nenet 133 - 142/a të Kodit të Procedurës Penale; Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë; Njoftimi i të pandehurit person juridik; Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet.” (20 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 15-16 Janar 2018, me temë: “Caktimi i dënimit penal nga gjykata. Kriteret e caktimit të dënimit me fokus në nenin 47 dhe vijues të Kodit Penal. Trajtesa teorike dhe praktika gjyqësore lidhur me caktimin e dënimit penal nga gjykata; Caktimi i dënimit për veprën penale të mbetur në tentativë, për personat e dehur dhe ata me probleme të shëndetit mendor; Personat me probleme të shëndetit mendor; mirëqenia

mendore: kuptimi; promovimi i mirëqenies mendore; stresi dhe menaxhimi i tij; Caktimi i dënimit në rastin e njohjes së një vendimi të një gjykate të huaj.” (21 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 18-19 Janar 2018, me temë: “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Trajtimi integral i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm; Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës së Strasburgut dhe Luksemburgut në planin e përgjithshëm. Detyrat e vëna për Shqipërinë në veçanti. Kontrolli gjyqësor mbi ekzekutimet; Masat e sigurimit civil të padisë. Praktika gjyqësore dhe ajo unifikuese në lidhje me masat e sigurimit të padisë. Ankimi në rastin e rrëzimit të masës së sigurimit; Aplikimi për rastet e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e kontratave të kredive bankare; Veçimi i pjesës së debitorit bashkëpronar në fazën e ekzekutimit të detyrimeve dhe problemet e lindura në praktikën gjyqësore.” (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 19 Janar 2018, me temë: “Procesverbali i seancës gjyqësore në një procedim penal. Transkriptimi; Pavlefshmëritë e akteve. Analizë e dispozitave procedurale penale me fokus në nenet 115-117; 122-130 të Kodit të Procedurës Penale.” (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 22-23 Janar 2018, me temë: “Roli i alternativave të dënimit me burgim dhe shërbimi i provës. Risitë e Kodit Penal lidhur me alternativat e dënimit me burgim. Ligji "Për shërbimin e provës" dhe dispozitat procedurale penale; Lirimi me kusht si një nga alternativat e dënimit me burgim; Praktika gjyqësore; Marrëdhëniet e shërbimit të provës dhe prokurorisë.” (20 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 22-23 Janar 2018, me temë: “Drejtësia për të miturit dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit. Komunikimi në rastet e drejtësisë për të mitur dhe hartimi i vendimeve/aktgjykimeve në rastet e drejtësisë për të mitur.” (22 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 24-25 Janar 2018, me temë: “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmëritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kësaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake; Dita e dytë: Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.” (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 30-31 Janar 2018, me temë: “Bashkëpunimi ndërinstitucional në procesin e hetimit dhe gjykimin të veprave penale. Roli i Policisë Shkencore; Bashkëpunimi i gjyqësorit dhe prokurorisë me Policinë Shkencore.” (28 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 1-2 Shkurt 2018, me temë: “Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi. Dallimi mes grupit të strukturuar kriminal me bashkëpunimin e thjeshtë dhe organizatën kriminale. Problemet e praktikës gjyqësore; Kufijtë e shtrirjes së përgjegjësisë penale individuale. Problematikat pas daljes së Vendimit Unifikues nr. 4, datë 15.04.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.” (29 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 5-6 Shkurt 2018, me temë: “Masat e sigurimit personal. Roli i gjykatës në kërkesat e bëra për zëvendësimin e tyre në raport me mendimin e prokurorit; Zbatimi i më shumë se një mase sigurimi personal dhe i dënimeve alternative me qëllim uljen e rasteve të zbatimit të masës së sigurisë “arrest me burg” dhe dënimit me burgim; Përzgjedhja dhe zbatimi i masave të Sigurimit Personal, ndaj të miturve në konflikt me ligjin analizë e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit; Seanca e vlerësimit për masën e sigurimit.” (26 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 7-8 Shkurt 2018, me temë: “Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit me fokus: Trafikimin e qenieve njerëzore. Specifikat që paraqesin subjektet e veçanta. Teknikat e hetimit proaktiv, trajtimin e viktimave gjatë gjithë procedimit penal si dhe trafikimi i fëmijëve, duke u përqendruar te format e reja të këtij trafikimi. Dallimi mes kësaj figure vepr penale dhe veprave të tjera të ngjashme me to, p.sh.: shfrytëzimi i fëmijëve për lypje etj.; Trafikimin e armëve e municioneve luftarake; Trafikimin e mjeteve motorike dhe veprave të artit e të kulturës; Rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional mes institucioneve ligjzbatuese.”. (19 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9 Shkurt 2018 me temë “Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike. Kuadri ligjor lidhur me njoftimet me fokus në nenet 133 - 142/a të Kodit të Procedurës Penale; Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë; Njoftimi i të pandehurit person juridik; Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet.” (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12 Shkurt 2018 me temë “Martesat nën moshë dhe roli i gjykatës në lejimin e këtyre martesave 'për shkaqe me rëndësi”, (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12 -13 Shkurt 2018 me temë “Teknikat e posaçme të hetimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor shqiptar. Trajtesë teorike dhe praktike. Metodot speciale të hetimit; Veprimet simuluese; Roli i punonjësit të infiltruar të

policisë dhe Jurisprudenca e GJEDNJ-së; Bashkëpunëtori i drejtësisë dhe dëshmitari me identitet të fshehur.” (24 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13 Shkurt 2018 me temë “Përgjegjësia Civile dhe Penale e organeve të shoqërisë tregtare në funksionin e tyre të brendshëm dhe të jashtëm. Çështje të teorisë dhe praktikës gjyqësore.” (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 19-20 Shkurt 2018 me temë “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmeritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kësaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake. Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.” (18 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 19-20 Shkurt 2018 me temë “Krimi ndërkufitar dhe trafiqet e paligjshme. Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme. Rritja e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-së. Bashkëpunimi ndërkufitar dhe hetimet e përbashkëta si element kyç i luftës ndaj këtij fenomeni.” (10 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21-22 Shkurt 2018 me temë “Drejtësia penale për të mitur. Standardet ndërkombëtare lidhur me parimet e drejtësisë miqësore për të miturit dhe risitë e legjislacionit shqiptar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Pozita procedurale e të miturit në dhe gjatë procesit penal sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Mbrojtja e të drejtave të të miturit dëshmitar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur) Integrimi social dhe rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin.” (5 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Shkurt 2018 me temë “Etika e komunikimit dhe llojet e tij. Komunikimi me shkrim. Ndërtimi i tekstit për të lidhur rrjedhshmërinë me përmbajtjen. Komunikimi verbal dhe ai joverbal në gjykatë. Komunikimi me popullata të veçanta. Ndërtimi i besimit nëpërmjet gjuhës së folur, efekteve kulturore, efekteve sociale dhe ekonomike. Shprehitë e komunikimit efektiv: të dëgjuarit; komunikimi joverbal; komunikimi verbal; empatia etj.” (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Shkurt 2018 me temë “Gjykimi në mungesë. Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor në praninë e

të pandehurit në gjykim. Legjislacioni shqiptar dhe probleme të praktikës gjyqësore shqiptare.”. (11 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28 Shkurt 2018 me temë “Regjimi pasuror martesor dhe interferimi i ligjit 7501 “Për tokën” në regjimin pasuror martesor. Mbarimi i regjimit pasuror i bashkësisë ligjore. Krahاسimi i likuidimit të regjimit pasuror të bashkësisë ligjore me gjykimin e posaçëm civil për pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi (të përbashkëtat dhe dallimet).”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28 Shkurt 2018 me temë “Parimet në dhënien e kompensimit në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes.”. (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 1-2 Mars 2018 me temë “Drejtësia penale për të mitur. Standardet ndërkombëtare lidhur me parimet e drejtësisë miqësore për të miturit dhe risitë e legjislacionit shqiptar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur); Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Pozita procedurale e të miturit në dhe gjatë procesit penal sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Mbrojtja e të drejtave të të miturit dëshmitar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Integrimi social dhe rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin.”. (15 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet zhvilluar në datë 5-6 Mars 2018 me temë “Masat e sigurimit personal. Roli i gjykatës në kërkesat e bëra për zëvendësimin e tyre në raport me mendimin e prokurorit; Zbatimi i më shumë se një mase sigurimi personal dhe i dënimeve alternative me qëllim uljen e rasteve të zbatimit të masës së sigurisë “arrest me burg” dhe dënimit me burgim; Përzgjedhja dhe zbatimi i masave të Sigurimit Personal, ndaj të miturve në konflikt me ligjin analizë e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Seanca e vlerësimit për masën e sigurimit.”. (17 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet zhvilluar në datë 7-8 Mars 2018 me temë “Gjykimi në mungesë. Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor në praninë e të pandehurit në gjykim. Legjislacioni shqiptar dhe probleme të praktikës gjyqësore shqiptare.”. (16 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet zhvilluar në datë 9 Mars 2018 me temë “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal. Roli i viktimës në seancën paraprake. Roli i viktimës gjatë gjykimit; Riviktimizimi. Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në

qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?” (33 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9 Mars 2018 me temë “Zbatueshmëria e parimit kushtetues së të drejtës për të mos u gjykuar dy herë (ne bis in idem) në këndvështrimin kushtetues, KEDNJ-së (neni 4 i Protokollit nr.7).” (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12-13 Mars 2018 me temë “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake. Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmeritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kesaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake. Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.” (15 prokurorë dhe 4 ndihmës ligjorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 15-16 Mars 2018 me temë “Trajtesa ligjore dhe praktike me efekt në aftësimin profesional në fushën e tatimeve. Veprat penale në fushën e tatimeve. Bashkëpunimi i autoriteteve tatimore me sistemin e drejtësisë. Procedurat e ankimimit të akteve administrative tatimore: a) shqyrtimi i ankimeve për dënimet administrative për kundravajtjet administrative; dhe b) ankimi kundër vendimeve të Drejtorisë së Apelitit Tatimor.” (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 15-16 Mars 2018 me temë “Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. Përdorimi i përgjimit. Vendimi për Lejimin e Përgjimit si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. Problemet e dala në praktikën gjyqësore shqiptare për vlerësimin e kësaj prove. Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës së Lartë.” (23 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 19-20 Mars 2018 me temë “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Trajtimi integral i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm. Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës së Strasburgut dhe Luksemburgut në planin e përgjithshëm. Detyrat e vëna për Shqipërinë në veçanti. Kontrolli gjyqësor mbi ekzekutimet. Masat e sigurimit civil të padisë. Praktika gjyqësore dhe ajo unifikuese në lidhje me masat e sigurimit të padisë. Ankimi në rastin e rrëzimit të masës së sigurimit. Aplikimi për rastet e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e kontratave të kredive bankare. Veçimi i pjesës së debitorit bashkëpronar në fazën e ekzekutimit të detyrimeve dhe problemet e lindura në praktikën gjyqësore.” (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21 Mars 2018 me temë “Marrëdhëniet gjyqtarë - prokurorë - avokat mbështetur në standardet e Këshillit të Evropës.”. (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 23 Mars 2018 me temë “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal. Roli i viktimës në seancën paraprake. Roli i viktimës gjatë gjyqimit; Riviktimizimi. Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjyqimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?” (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 23 Mars 2018 me temë “Vepra penale në fushën e falimentimit. Roli i ligjit të ri të falimentimit në parandalimin e fshehjes së të ardhurave/pasurisë së debitorit nëpërmjet procedurës së falimentimit.”. (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Mars 2018 me temë “Analiza e provave dhe teoritë e të provuarit. Hetimi i fakteve dhe natyra e provave në kontekstin ligjor. Parimet e të provuarit dhe teoria Wigmore. Metodatat e analizës dhe logjika. Probabiliteti, pesha dhe forca e provës.”. (8 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Mars 2018 me temë “Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja. Ekstradimi. Arresti i përkohshëm. Njohja e vendimit penal të huaj për të gjykuarin në mungesë “in absentia” nga Autoriteti Gjyqësor i Huaj.”. (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28 Mars 2018 me temë “I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së.”. (5 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28 Mars 2018 me temë “Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale. Konventat ndërkombëtare lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale. Vështrim i Shkurtër mbi Konventën e Varshavës, Palermos e Vjenës. Legjislacioni procedural penal mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe risitë e tij. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përfshirë në veprat penale përkatëse. Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e veprës penale të pastrimit të parave. Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit

nëpërmjet shenjësimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal.”. (28 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 30 Mars 2018 me temë “Liria e shprehjes në fokusin e miradministrimit të drejtësisë dhe kufijtë e ushtrimit të saj për profesionistët e drejtësisë (gjyqtarët, prokurorët, avokatët); Ankimi ndaj vendimeve të autoriteteve rregullatore të çështjeve që lidhen me të.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 30 Mars 2018 me temë “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal. Roli i viktimës në seancën paraprake. Roli i viktimës gjatë gjykimit. Riviktimizimi. Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?” (18 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 4-5 Prill 2018 me temë “Gjykimi në mungesë. Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor në praninë e të pandehurit në gjykim;Legjislacioni shqiptar dhe probleme të praktikës gjyqësore shqiptare.”. (16 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13 Prill 2018 me temë “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal. Roli i viktimës në seancën paraprake. Roli i viktimës gjatë gjykimit. Riviktimizimi. Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?”. (21 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 11-12 Prill 2018 me temë “Risitë e legjislacionit shqiptar me ndikim mbi statusin, organizimin dhe veprimtarinë e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit. Ligji për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë nr. 115/2016. Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nr. 96/2018. Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë nr. 98/2016”. (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 11-13 Prill 2018 me temë “Shkenca dhe ligji. Llojet e ekspertizave dhe roli i ekspertit në procesin gjyqësor civil. Llojet e ekspertizave dhe roli i ekspertit në procesin gjyqësor familjar. Llojet e ekspertizave dhe roli i ekspertit në procesin gjyqësor penal.”. (12 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12-13 Prill 2018 me temë “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprahe. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprahe. Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprahe. Pavlefshmeritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kësaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprahe. Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.”. (26 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13 Prill 2018 me temë “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal. Roli i viktimës në seancën paraprahe. Roli i viktimës gjatë gjykimit; Riviktimizimi. Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?”. (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 16-17 Prill 2018 me temë “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile. Risitë e Kodit të Procedurës Civile. Urdhri i ekzekutimit; Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv; Kundërshtimi i veprimeve përmbarimor; Pezullimi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë; Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore shqiptare; Pasojat nga prishja e vendimit të dhënë me ekzekutim të përkohshëm me fokus në nenet 319 të Kodit të Procedurës Civile; Kuptimi i nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile dhe rastet në të cilat vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm; Momenti i parashtrimit të kërkesës për dhënien me ekzekutim të përkohshëm; Kuptimi i nenit 319 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me pasojat që vijnë nga prishja e vendimit të dhënë me ekzekutim të përkohshëm; Rregullimi i pasojave të ardhura nga dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i tij nga shërbimi përmbarimor.”. (10 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 18-19 Prill 2018 me temë “Teknikat e posaçme të hetimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor shqiptar. Trajtesë teorike dhe praktike. Metodatat speciale të hetimit; Veprimet simuluese; Roli i punonjësit të infiltruar të policisë dhe Jurisprudenca e GJEDNJ-së; Bashkëpunëtori i drejtësisë dhe dëshmitari me identitet të fshehur.”. (21 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 20 Prill 2018 me temë “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal. Roli i viktimës në seancën paraprake. Roli i viktimës gjatë gjykimit. Riviktimizimi. Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?” (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 23-24 Prill 2018 me temë “Dëmi jashtëkontraktor që lidhet me dinjitetin dhe jetën private. Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me kryqëzimin dhe balancimin e të drejtave që kanë të bëjnë me jetën private, dinjitetin dhe personalitetin e personit, si dhe lirinë e shprehjes. Kompensimi i dëmit në raste të shkeljeve të tilla.”. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 24-25 Prill 2018 me temë “I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë. Pozicioni procedural i të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë si “dëshmitar” në proces. Rëndësia dhe roli i dëshmitarit me identitet të fshehur në procedimin penal. Vlera provuese e deklarimeve.”. (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Prill 2018 me temë “Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështirësi krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale.”. (8 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 27 Prill 2018 me temë “Legjislacioni për shpronësimin në interes publik dhe problemet e hasura në praktikën gjyqësore.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 30 Prill 2018 me temë “Risitë e ligjit “Për tregtarët e shoqëritë tregtare; Riorganizimi i shoqërive tregtare (bashkimi, ndarja, likuidimi).” (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 3-4 Maj 2018 me temë “Risitë e kuadrit të ri ligjor për administratën publike; Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”; Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore me fokus në administratën publike.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 3-4 Maj 2018 me temë “I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë. Pozicioni procedural i të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë si

"dëshmitar" në proces. Rëndësia dhe roli i dëshmitarit me identitet të fshehur në procedimin penal. Vlera provuese e deklarimeve.”. (11 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 8 Maj 2018 me temë “I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së.”. (7 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9-10 Maj 2018 me temë “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Trajtimi integral i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm. Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës së Strasburgut dhe Luksemburgut në planin e përgjithshëm. Detyrat e vëna për Shqipërinë në veçanti. Kontrolli gjyqësor mbi ekzekutimet; Masat e sigurimit civil të padisë. Praktika gjyqësore dhe ajo unifikuese në lidhje me masat e sigurimit të padisë. Ankimi në rastin e rrëzimit të masës së sigurimit; Aplikimi për rastet e procedurave përmbartimore për ekzekutimin e kontratave të kredive bankare; Veçimi i pjesës së debitorit bashkëpronar në fazën e ekzekutimit të detyrimeve dhe problemet e lindura në praktikën gjyqësore.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 14-15 Maj 2018 me temë “Dialogu gjyqësor dhe roli i vendimeve të Gjykatave Europiane në planin e brendshëm (GJEDNJ dhe GJDBE) Dialogu i gjyqtarëve kombëtarë me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut; dhe Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Europian . Kompetencat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Vendimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe rendesia në planin kombëtar. Kompetencat e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së. Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së dhe rëndësia në planin kombëtar. Raporti i KEDNJ dhe Kartës së të drejtave themelore të BE”.; (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 16-17 Maj 2018 me temë “Veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Hetimet paralele financiare kriminale për identifikimin dhe ngrirjen e produkteve ose pasurisë që rrjedh nga kjo veprimtari. Efektet në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave nëpërmjet dënimit të autorëve të këtyre veprave dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale.”. (21 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21-22 Maj 2018 me temë “Kriteret për vlerësimin e efektivitetit të mjeteve ankimore në reflektim të jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe vendimmarrjeve në çështjet kundër Shqipërisë. Zhvillime të rëndësishme në kuadër dhe të ndryshimeve kushtetuese e ligjore. Metodologjia e interpretimit pajtues të ligjeve me Kushtetutën sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë. Problematika të shënuara nga GJEDNJ-ja në vendimet kundër shtetit shqiptar. Mundësia e korrigjimit të shkeljeve nëpërmjet masave të përgjithshme jo vetëm nëpërmjet iniciativave ligjore, por edhe me përshtatjen e praktikave gjyqësore dhe administrative.”. (3 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 23-24 Maj 2018 me temë “Mbrotjtja nga dhuna në familje në aspektin civil dhe penal. Problemet e praktikës ligjore në rastet e urdhrit të mbrotjtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrotjtjes; Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrotjtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrotjtura nga neni 130/a të Kodit të Familjes; Trajtimi i rrethanave cilësuese të nenit 130/a të Kodit Penal. Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar. Elemente bazë të komunikimit me fëmijët: njohuri për gjyqtarët e seksionit familjar kronologji e zhvillimit të komunikimit gjatë procesit të rritjes së fëmijës; zhvillimi i empatisë te fëmijët; dy modele prindërimi (ndërtues apo shkatërrues)? disiplina: ndëshkimi (time-out); Shprehitë e komunikimit efektiv: të dëgjuarit; komunikimi joverbal; komunikimi verbal; empatia etj. Dhuna në familje ndaj fëmijëve: neglizhenca dhe sindroma të keqtrajtimit të fëmijëve: Sindroma e bebes së shkundur; Sindroma Munchause.”. (5 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 24-25 Maj 2018 me temë “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase. Risitë e ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Problematikat e hasura në praktikën gjyqësore; Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e tij. Llojet e vendimeve që merr ATP-ja dhe ndarja e kompetencave mes gjykatave civile dhe administrative; Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lidhen me vendimet e dhëna nga ish-KKP-ja dhe ish-AKKP-ja; Parime të përgjithshme të njohjes dhe shpërblimit të drejtë të vuajtjeve të shkaktuara nga marrja dhe mbajtja e padrejtë e pronës; Metodologjia e vlerësimit të kompensimit.”. (6 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28-29 Maj 2018 me temë “Mbrotjtja e të dhënave private dhe privatësia në raport me lirinë e shprehjes dhe zhvillimet teknologjike.”. (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28-29 Maj 2018 me temë “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmëritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kësaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake; Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara. Përqasja e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e sigurimeve nga kompanitë e sigurimeve. Problemet në jurisprudencën shqiptare. Praktika e GJED-së në këtë fushë.”. (8 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 30-31 Maj 2018 me temë “Krimi kibernetik. Evidentimi i krimit kibernetik. Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike; Të

ardhurat nga krimi online. Përdorimi i internetit për qëllime terroriste.”. (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 31 Maj -1 Qershor 2018 me temë “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase. Risetë e ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Problematikat e hasura në praktikën gjyqësore; Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e tij. Llojet e vendimeve që merr ATP-ja dhe ndarja e kompetencave mes gjykatave civile dhe administrative; Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lidhen me vendimet e dhëna nga ish-KKP-ja dhe ish-AKKP-ja; Parime të përgjithshme të njohjes dhe shpërblimit të drejtë të vuajtjeve të shkaktuara nga marrja dhe mbajtja e padrejtë e pronës; Metodologjia e vlerësimit të kompensimit.”. (6 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 6-7 Qershor 2018 me temë “Natyra e mjeteve ligjore administrative. Natyra e ankimit administrativ; Procedura e shqyrtimit nga organi kompetent dhe organi epror. Dallimi ndërmjet tyre; Objekti i kundërshtimit administrativ, si risi në legjislacionin administrativ. Rishikimi: një mjet i ri ligjor në procesin administrativ. Natyra e ankimit administrativ dhe efekti reformatio in pejus në procesin administrativ sipas KPA-së.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 6-7 Qershor 2018 me temë “Rishikimi i vendimit të formës së prerë në Procesin Penal. Risetë e Kodit Procedural Penal (neni 449, 450, i ndryshuar i KPP-së); Zbatimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si shkak i domosdoshëm për rigjykimin e çështjes dhe rishikimin e vendimit të formës së prerë penale.”. (21 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 7-8 Qershor 2018 me temë “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase. Risetë e ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Problematikat e hasura në praktikën gjyqësore; Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e tij. Llojet e vendimeve që merr ATP-ja dhe ndarja e kompetencave mes gjykatave civile dhe administrative; Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lidhen me vendimet e dhëna nga ish-KKP-ja dhe ish-AKKP-ja; Parime të përgjithshme të njohjes dhe shpërblimit të drejtë të vuajtjeve të shkaktuara nga marrja dhe mbajtja e padrejtë e pronës; Metodologjia e vlerësimit të kompensimit.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 11-12 Qershor 2018 me temë “Mbrojtja nga dhuna në familje në aspektin civil dhe penal. Problemet e praktikës ligjore në rastet e urdhrin të mbrojtjes dhe urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes; Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a të Kodit të Familjes;

Trajtimi i rrethanave cilësuese të nenit 130/a të Kodit Penal. Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar. Elemente bazë të komunikimit me fëmijët: njohuri për gjyqtarët e seksionit familjar kronologji e zhvillimit të komunikimit gjatë procesit të rritjes së fëmijës; zhvillimi i empatisë të fëmijët; dy modele prindërimi (ndërtues apo shkatërrues)? disiplina: ndëshkimi (time-out); Shprehitë e komunikimit efektiv: të dëgjuarit; komunikimi joverbal; komunikimi verbal; empatia etj. Dhuna në familje ndaj fëmijëve: neglizhenca dhe sindroma të keqtrajtimit të fëmijëve: Sindroma e bebes së shkundur; Sindroma Munchausen.” (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12-13 Qershor 2018 me temë “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjisllacionit dhe praktikës vendase.” (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13-14 Qershor 2018 me temë “I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë. Pozicioni procedural i të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë si "dëshmitar" në proces. Rëndësia dhe roli i dëshmitarit me identitet të fshehur në procedimin penal; Vlera provuese e deklarimeve.”. (8 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 14 Qershor 2018 me temë “Risitë e ligjit “Për falimentimin.”. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 18-19 Qershor 2018 me temë “Padia civile në procesin penal. Risitë e Kodit të Procedurës Penale lidhur me padinë civile në procesin penal. Problematika e praktikës gjyqësore lidhur me padinë civile në procesin penal.”. (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 18-19 Qershor 2018 me temë “Krimi kibernetik. Evidentimi i krimit kibernetik. Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike. Të ardhurat nga krimi online. Përdorimi i internetit për qëllime terroriste.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 18-19 Qershor 2018 me temë “Arsyetimi dhe gjykimi. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore si standard kushtetues - Efekti i jurisprudencës së GJK-së të gjykatat. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore dhe standardi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me këtë aspekt.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 20-21 Qershor 2018 me temë “Hetimet proaktive në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Forcimi i koordinimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit; Zvogëlimi i kërcënimeve të terrorizmit nëpërmjet vlerësimit të rrezikut, duke bashkëpunuar me strukturat e shtetit të angazhuara në këtë fushë; Bashkëpunimi ndërkombëtar në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Luftëtarët terroristë të huaj, Standardet ndërkombëtare lidhur

me kriminalizimin e veprave penale të kryera prej tyre; Vështrim krahasues me legjislacionin penal shqiptar; Metodologjia hetimore dhe problemet e ndeshura në praktikë.”. (8 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 20-21 Qershor 2018 me temë “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në Shqipëri.”. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 25-26 Qershor 2018 me temë “I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 25-26 Qershor 2018 me temë “Zbatimi i së drejtës europiane nga gjykatat kombëtare. Natyra dhe parimet e së drejtës së BE-së sipas jurisprudencës së GJDBE-së. Procedurat paragjykimore. Kush e bën referimin? Kuptimi i termit gjykatë apo tribunal. Faza e gjykimit kur mund të bëhet referimi. Cilat janë detyrat kryesore që kryen gjyqtari kombëtar (forma dhe cilësia e pyetjeve, radha dhe forma e tyre etj.); Detyrat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përkthimi dhe komunikimi me palët. Institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare. Faza me shkrim dhe me gojë. Roli i avokatit të përgjithshëm. Rëndësia e vendimeve të GJDBE-së.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 27-28 Qershor 2018 me temë “Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi. Dallimi mes grupit të strukturuar kriminal me bashkëpunimin e thjeshtë dhe organizatën kriminale. Problemet e praktikës gjyqësore. Kufijtë e shtrirjes së përgjegjësisë penale individuale. Problematikat pas daljes së Vendimit Unifikues nr. 4, datë 15.04.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.” (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 27-28 Qershor 2018 me temë “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në Shqipëri.” (6 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28-29 Qershor 2018 me temë “Inteligjenca emocionale dhe procesi i vendimmarrjes. Kuptimi i inteligjencës emocionale; Rëndësia e inteligjencës emocionale; Analiza e komponentëve kryesorë të inteligjencës emocionale: Vetëndërgjegjësimi, vetëmenaxhimi; ndërgjegjësimi social; shprehjet sociale; teknika/strategji për të përmirësuar inteligjencën emocionale.”. (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 28-29 Qershor 2018 me temë “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake. Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmëritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kësaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake; Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi

mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.”. (31 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 29 Qershor 2018 me temë “Raporti i gjykatës dhe prokurorisë me median. Roli i magjistratit të shtypit në balancimin e interesit të palëve në proces dhe interesit publik për të marrë informacion. Kufijtë etikë dhe profesionalë.”. (16 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 29 Qershor 2018 me temë “Res iudicata” (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 2-3 Korrik 2018 me temë “Analiza e provave dhe teoritë e të provuarit. Hetimi i fakteve dhe natyra e provave në kontekstin ligjor; Parimet e të provuarit dhe teoria Wigmore; Metodatat e analizës dhe logjika; Probabiliteti, pesha dhe forca e provës.”. (8 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 2-3 Korrik 2018 me temë “Caktimi i dënimit penal nga gjykata. Kriteret e caktimit të dënimit me fokus në nenin 47 dhe vijues të Kodit Penal. Trajtesa teorike dhe praktika gjyqësore lidhur me caktimin e dënimit penal nga gjykata; Caktimi i dënimit për veprën penale të mbetur në tentativë, për personat e dehur dhe ata me probleme të shëndetit mendor; Personat me probleme të shëndetit mendor: mirëqenia mendore: kuptimi; promovimi i mirëqenies mendore; stresi dhe menaxhimi i tij; Caktimi i dënimit në rastin e njohjes së një vendimi të një gjykate të huaj.”. (8 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 4-5 Korrik 2018 me temë “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake. Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmëritë e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kësaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake. Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 6 Korrik 2018 me temë “Standardet e etikës profesionale për prokurorët/ rregullimi etik në fuqi dhe rregullimet e pritshme në kuadër të organizimit të ri kushtetues e ligjor të institucionit të akuzës. (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9 Korrik 2018 me temë “Standardet e GJEDNJ ne lidhje me azilin dhe migracionin e paligjshëm.” (6 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 10 Korrik 2018 me temë “Standardet e GJEDNJ ne lidhje me azilin dhe migracionin e paligjshëm.” (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 11-12 Korrik 2018 me temë “Risitë lidhur me aksesin në gjykimin kushtetues. Qasja e gjykatave dhe e subjekteve pjesëmarrëse (roli i gjykatës gjatë procesit, kur palët ngrenë probleme antikushtetutshmërie; vonesat gjatë gjykimit etj.); Kontrolli incidental kushtetues.”. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 8 Tetor 2018 me temë “Liria e shprehjes dhe medias – Standarde të parashikuara në KEDNJ dhe jurisprudencë e GJEDNJ-së dhe aplikimi i tyre në kontekstin shqiptar”. (12 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9 Tetor 2018 me temë “Liria e shprehjes dhe medias – Standarde të parashikuara në KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe aplikimi i tyre në kontekstin shqiptar.”. (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 15-16 Tetor 2018 me temë “Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin.”. (15 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 22 Tetor 2018 me temë “Respektimi i të drejtës së autorit për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, por dhe institucionet e tjera zbatuese.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 25-26 Tetor 2018 me temë “Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit.”. (11 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26 Tetor 2018 me temë “Investigimi i rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve (workshop tematik për prokurorë përfshirë përfaqësues të ligjit).”. (12 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 31 Tetor 2018 me temë “Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.”. (15 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 1-2 Nëntor 2018 me temë “Eficienca gjyqësore dhe menaxhimi aktiv i çështjeve me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile. Sfidat me të cilat përballen gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit ligjor dhe pjesëmarrësit e tjerë në gjykim përsa i përket efijencës së proceseve gjyqësore.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 1-2 Nëntor 2018 me temë Mbi disa amendime të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (Ligji antimafia). (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 1-2 Nëntor 2018 me temë Jurisprudenca e GJEDNJ-së kundër Shqipërisë.”. (7 kandidatë për prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 5-6 Nëntor 2018 me temë “Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore.”. (15 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 7-8 Nëntor 2018 me temë “Zhvillimi i një procesi gjyqësor dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. Kohëzgjatja e paarsyeshme e procedurave të gjykitimit dhe të procesit administrativ, si dhe e ekzekutimit të vendimeve; Pritshmëritë nga ndryshimet në ligjet materiale dhe procedurale. (procedurat civile dhe penale, ligji për Gjykatën Kushtetuese etj.; Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me afatin e arsyeshëm); Kërkimi dhe zbatimi i mjeteve efektive për parandalimin e shkeljeve që lidhen me gjykimin në afat; Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me afatin e arsyeshëm. Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykitimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Gjykitimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Shqyrtimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe masa e dëmshpërblimit sipas kriterëve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.”. (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 7-8 Nëntor 2018 me temë “Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit.”. (13 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9 Nëntor 2018 me temë “Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 9 Nëntor 2018 me temë “E drejta e marrjes së informacionit – si po zbatohet ligji në praktikë?”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12-13 Nëntor 2018 me temë “Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve. (15 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 12-13 Nëntor 2018 me temë “Provat dhe papërdorshmëria e provave të marra në kundërshtim me ligjin. Raporti i aktit të pavlefshëm

me përdorshmërinë e provës së marrë nëpërmjet tij. Këndvështrim krahasues me doktrinën dhe jurisprudencën e huaj.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13-14 Nëntor 2018 me temë “Etika e komunikimit dhe llojet e tij . Komunikimi me shkrim; Ndërtimi i tekstit për të lidhur rrjedhshmërinë me përmbajtjen. Komunikimi verbal dhe ai joverbal në gjykatë; Përmirësimi i komunikimit të bashkëbisedimit gjatë gjykimit. Roli i gjyqtarit dhe sjellja e aktorëve të tjetër procedural: prokurori, mbrojtësi, i pandehuri, viktimë. Rëndësia e një komunikimi korrekt, sjellja etike, efektet e bashkëbisedimit në dhënien e një drejtësie sa më objektive dhe rritja e performancës së organeve të drejtësisë. Komunikimi me popullatën të veçanta. Ndërtimi i besimit nëpërmjet gjuhës së folur, efektet kulturore, efektet sociale dhe ekonomike. Shprehitë e komunikimit efektiv: Të dëgjuarit; komunikimi joverbal; komunikimi verbal; empatia etj.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 14-15 Nëntor 2018 me temë “Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. Kujdesi për ruajtjen e balancës me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Rezultatet e përgjimit dhe vlera provuese. Praktika gjyqësore dhe standardet ndërkombëtare.”. (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 15-16 Nëntor 2018 me temë “Efiçenca gjyqësore dhe menaxhimi aktiv i çështjeve me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile. Sfidat me të cilat përballen gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit ligjorë dhe pjesëmarrësit e tjerë në gjykim përse i përket efiçencës së proceseve gjyqësore.”. (9 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 15-16 Nëntor 2018 me temë “Parashkrimi shues dhe dekadencia. Kuptimi; Arsytet dhe rëndësia e institutit të parashkrimit; Kushtet e ekzistencës së faktit juridik të parashkrimit të padisë; Kufijtë e zbatimit të parashkrimit; Afatet e parashkrimit; Pezullimi i parashkrimit; Ndërprerja e përshkrimit; Pasojat juridike të parashkrimit të padisë; Dallimi i parashkrimit nga prekluziviteti ose dekadencia; Parashkrimi në të drejtën procedurale; Dallimi i regjimit juridik të parashkrimit të padisë në procesin administrativ dhe procesin civil; Ndryshimet e KPC në vitin 2017 mbi prapësimet në kuptimin e ngushtë dhe praktika gjyqësore.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 16 Nëntor 2018 me temë “Kufijtë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe roli i Gjykatës së Lartë në praktikën gjyqësore.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 16 Nëntor 2018 me temë “Liria e shprehjes dhe interneti.” (14 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 19 Nëntor 2018 me temë “Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.”. (5 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 20-21 Nëntor 2018 me temë “Përfundimi i marrëdhënieve të punës. Kodi i Punës dhe problemet e evidentuara nga praktika gjyqësore. Legjislacioni në marrëdhënien juridike të punësimit për punëmarrësit e punëdhënësit, në mënyrën e shkaqet e zgjidhjes së kontratave të punës me ose pa afat të caktuar. Të drejtat që gëzojnë mbrojtje ligjore në rrugë gjyqësore. Legjislacioni për parandalimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës: problemet e evidentuara nga praktika gjyqësore.”. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21 Nëntor 2018 me temë Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21 Nëntor 2018 me temë ”Neni 10 i KEDNJ-së dhe evolucioni i përgjegjësisë civile sipas GJEDNJ-së dhe ndryshimeve në Kodin Civil.”. (5 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21-22 Nëntor 2018 me temë “Integriteti i zyrtarëve të agjencive ligjzbatuese dhe lufta kundër korrupsionit. Korrupsioni i funksionarëve të lartë të drejtësisë dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë. Korrupsioni si një çështje etike v si një vepër penale. Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare. Problemet e praktikës gjyqësore, në lidhje me hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale. Standardet e kërkuara në marrëdhëniet profesionale midis gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe gjyqtarëve/prokurorëve dhe avokatëve.”. (11 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 23 Nëntor 2018 me temë “Tatimi i vlerës së shtuar - diskutim i rasteve praktike; tatimi mbi të ardhurat - raste praktike.”. (1 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Nëntor 2018 me temë “Zhvillimi i një procesi gjyqësor dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. Kohëzgjatja e paarsyeshme e procedurave të gjyimit dhe të procesit administrativ, si dhe e ekzekutimit të vendimeve. Pritshmëritë nga ndryshimet në ligjet materiale dhe procedurale. (procedurat civile dhe penale, ligji për Gjykatën Kushtetuese etj.; Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me afatin e arsyeshëm); Kërkimi dhe zbatimi i mjeteve efektive për parandalimin e shkeljeve që lidhen me gjykimin në afat. Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me afatin e arsyeshëm. Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjyimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv. Gjyrimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Shqyrtimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe masa e

dëmshpërblimit sipas kriterëve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.”. (5 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 26-27 Nëntor 2018 me temë “E drejta e konsumatorit . Zhvillimet në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve në kuadrin e BE-së dhe çështjet më me rëndësi lidhur me praktikën e tregtisë së pandershme dhe kushtet e tilla në një kontratë. Përkufizimet e konsumatorit dhe tregtarit, fushëveprimi i mbrojtjes së konsumatorit; Dispozitat kryesore të Direktivës së të Drejtave të Konsumatorit (CRD) (2011/83 / BE); Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve të konsumatorëve (Direktiva 2013/11 /BE); Zgjidhja e mosmarrëveshjeve online të konsumatorëve (Rregullorja 524/2013); Praktikën e pandershme tregtare (Direktiva 2005/29 / EC): rregullat kryesore dhe rastet praktike; Kushtet e papërshtatshme të kontratës (Direktiva 93/13 / EEC): rregullat kryesore dhe rastet praktike.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 3-4 Dhjetor 2018 me temë “Mbi disa amendime të Kodit të Procedurës Penale – “gjyqtari i seancës paraprake”. Roli i gjyqtarit të seancës paraprake, risitë dhe ecuria e praktikës gjyqësore. Seanca paraprake, si një nga risitë e sjella në Kodin e Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017, në Kodin e Procedurës Penale. Veçoritë e seancës paraprake dhe të drejtat e palëve. Vendimi për plotësimin e hetimeve. Ndryshimi i akuzës në seancën paraprake. Paraqitja e kërkesës për gjykim të Shkurtuar në seancën paraprake dhe roli që ka gjyqtari i seancës paraprake në shqyrtimin e saj. Llojet e vendimeve që merr gjyqtari në përfundim të seancës paraprake. Elementet e vendimit të seancës paraprake dhe fashikulli i gjyqimit.”. (18 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 3-4 Dhjetor 2018 me temë “Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me pyetjen e të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si provë në procesin penal. Risitë e ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. [dita e dytë me OSBE-në me këtë temë] Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risitë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.”. (12 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 4-5 Dhjetor 2018 me temë “Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 5-6 Dhjetor 2018 me temë “Gjykimi në mungesë: Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor praninë e të pandehurit në gjykim; Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare. Pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017.”. (11 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 7 Dhjetor 2018 me temë “Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.”. (7 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13-14 Dhjetor 2018 me temë “Zhvillimi i një procesi gjyqësor dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. Kohëzgjatja e paarsyeshme e procedurave të gjykimit dhe të procesit administrativ, si dhe e ekzekutimit të vendimeve. Pritshmëritë nga ndryshimet në ligjet materiale dhe procedurale. (procedurat civile dhe penale, ligji për Gjykatën Kushtetuese etj.; Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me afatin e arsyeshëm); Kërkimi dhe zbatimi i mjeteve efektive për parandalimin e shkeljeve që lidhen me gjykimin në afat. Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me afatin e arsyeshëm. Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv. Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Shqyrtimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe masa e dëmshpërblimit sipas kriterëve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.”. (11 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 13-14 Dhjetor 2018 me temë “Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit.”. (4 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 17-18 Dhjetor 2018 me temë “Shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Udhëzime praktike për unifikimin e metodologjisë në shkrimin e vendimeve dhe shmangien e problemeve që janë evidentuar nga praktika lidhur me trajtimin e balancuar të të gjithë elementeve të vendimit gjyqësor.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 17-18 Dhjetor 2018 me temë “Inteligjenca emocionale dhe procesi i vendimmarrjes. Kuptimi i inteligjencës emocionale. Rëndësia e inteligjencës emocionale; Analiza e komponentëve kryesorë të inteligjencës emocionale: Vetëndërgjegjësimi; vetëmenaxhimi; ndërgjegjësimi social; shprehitë sociale; teknika/strategji për të përmirësuar inteligjencën emocionale.”. (3 prokurorë pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 19-20 Dhjetor 2018 me temë “Të Drejtat e Njeriut dhe biomjekësia. Njohuri të përgjithshme mbi Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenieve Njerëzore lidhur me standardet e zbatimit të arritjeve të biologjisë dhe mjekësisë. Kërkimi shkencor, jeta private, konfidencialiteti dhe e drejta për informim. Eutanazia. Testet gjenetike dhe ADN-ja e njeriut. Ndalimi i klonimit të qenieve njerëzore. Transplanti i organeve dhe membranave (indeve) me origjinë njerëzore. Aspekte etike dhe ligjore të dhurimit të organeve. Jurisprudenca ndërkombëtare lidhur me bioetikën. Ligji i zbatueshëm për detyrimet jashtë-kontraktore. Rregullorja Rome II e BE-së dhe ballafaqimi me të drejtën tonë materiale përkatëse. Interpretimi me qëllim zbatimin korrekt të

legjislacionit shqiptar të së drejtës ndërkombëtare private. Ballafaqimi i Rregullores me legjislacionin e brendshëm.”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues zhvilluar në datë 21 Dhjetor 2018 me temë “Pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit sipas standardeve të GJEDNJ-së Drejtësia duhet jo vetëm të bëhet, por edhe të shihet.”. (3 prokurorë pjesëmarrës);

II. Një ndihmesë të rëndësishme për institucionin e prokurorisë kanë dhënë dhe vijnë të japin edhe projektet/misionet ndërkombëtare

Kështu, *OPDAT* ka organizuar në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës gjatë vitit 2018, një seri tryezash të rrumbullakëta, me temë “Të drejtat e viktimave të veprave penale”. Po kështu, përfaqësues të prokurorisë kanë marrë pjesë në aktivitete lidhur me mbrojtjen e viktimave të krimit të organizuar nga *OPDAT* Kroaci.

Euralius V, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës gjatë vitit 2018 ka organizuar tre trajnime lidhur me amendimet e disa ligjeve të rëndësishëm si ligji antimafia, Kodi i Procedurës Penale dhe ligji për ndihmën juridike.

Pameca V, ka dhënë kontribut në forcimin e kapaciteteve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Ndër aktivitetet e organizuara nga ky projekt përmendim, zhvillimin në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, të tre sesioneve trajnuese lidhur me seancën paraprake ligjin antimafia si dhe trajnime të tjera si më poshtë:

Trajnim “Krimi kibernetik, provat dixhitale dhe roli i rrjeteve sociale”, organizuar në Mars 2018;

Trajnim “Ekipet e Përbashkëta Hetimore. Kuadri ligjor, struktura, kompetenca dhe funksionimi”, organizuar në Prill 2018;

Konferenca “Për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave” organizuar në Korrik 2018;

Tre trajnime rajonale “Për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikut të drogës. Hetimet financiare kundër krimit të organizuar” mbajtur në Tiranë, Shkodër dhe Korçë;

Workshop “Mbi bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar me fokus në ekipet e përbashkëta hetimore”, organizuar në Nëntor 2018.

Pameca V, ka organizuar gjithashtu dy aktivitete me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Instat, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë, me fokus “Standardizimin dhe Institucionalizimin e Statistikave të Kriminalitetit”.

Programi i Bashkëpunimit i Mbretërisë së Suedisë, përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, “Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligj-zbatuese shqiptare për përbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit- një qasje

gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë” ka mbështetur prokurorinë në rritjen e kapaciteteve, për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit. Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara, përmendim trajnimet me temë “Pritja dhe Komunikimi me Shkrim e me Gojë në Çështje të drejtësisë penale për të mitur”, “Zbatimi i masës së shmangies dhe dënimet për të miturit në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit”, “Aplikimi i masave të sigurimit, shmangies dhe arsyetimi për caktimin e dënimeve penale ndaj të miturve”, zhvilluar në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës si dhe vizita studimore në Suedi.

III. Trajnime, vizita të prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë jashtë vendit

Gjatë vitit 2018 Institucioni i Prokurorisë ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare si, trajnime, vizita, konferenca, takime operative etj, duke u përfaqësuar me prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe ndihmës ligjorë.

Takime, vizita të Prokurorit të Përgjithshëm

Prokurorja e Përgjithshme e Republikës Znj.Arta Marku dhe një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme morën pjesë në Takimin e 10^{-të} të Rrjetit të Prokurorëve ose Institucioneve ekuivalente në Gjykatën Supreme të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian që u zhvillua në datat 16 - 18 Maj 2018 në Paris, Francë.

Prokurorja e Përgjithshme e Republikës Znj.Arta Marku dhe një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme zhvilluan një vizite zyrtare në Zagreb, Kroaci në datat 23 - 25 Maj 2018 organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Konferenca mbi forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe roli i EUROJUST në këtë fushë, aktivitet i organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme e Malit të Zi me mbështetjen e Projektit IPA 2017 – Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor u zhvillua në datë 11 Qershor 2018, në Podgoricë, Mal i Zi. Në këtë aktivitet mori pjesë një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme që përbëhej nga Znj.Arta Marku, Prokurori i Përgjithshëm dhe 1 prokuror.

Prokurorja e Përgjithshme e Republikës, Znj.Arta Marku dhe një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme zhvilluan një vizitë zyrtare në datat 10 – 12 Shtator 2018, në Romë, Itali, në Ministrinë e Drejtësisë, në Prokurorinë Kombëtare të Antimafia-s, në Drejtorinë kundër Terrorizmit dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor italian. Përveç përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme, në këtë vizitë morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

Prokurori i Përgjithshëm Znj.Arta Marku zhvilloi një vizitë zyrtare në datat 25 – 27 Shtator 2018, në Sofje, Bullgari në Prokurorinë e Përgjithshme Bullgare, me qëllim nënshkrimin e

një Memorandumi Mirëkuptimi, që ka si objektiv forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy Zyrave në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, terrorizmit, etj. (4 prokurorë pjesëmarrës).

Forumi i 19-të Ndërkombëtar i Prokurorëve në Luftën Krimit të Organizuar Ndërkufitar, në datat 2 – 4 Tetor 2018, në Lisbonë, Portugali aktivitet i cili organizohej nga Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit, TAIEX) të Komisionit Evropian. Në këtë aktivitet mori pjesë Prokurori i Përgjithshëm Znj.Arta Marku dhe një delegacion i prokurorisë.

Me ftesë të Prokurorit të Përgjithshëm pranë Gjykatës Supreme të Greqisë Z. Xenia Dimitriou Vasilopoulou, Prokurorja e Përgjithshme e Republikës, Znj.Arta Marku dhe një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare, me temë “Krijimi i Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (EPPO)”, e cila u zhvillua në Athinë, Greqi, në datat 23 - 25 Nëntor 2018.

Me ftesë të Prokurorit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Apelit të Aix-en-Provence, Francë Prokurorja e Përgjithshme e Republikës, Znj.Arta Marku dhe një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme morën pjesë në Konferencën e Parë të Unionit të Prokurorëve të Përgjithshëm të vendeve të Detit Mesdhe, e cila u zhvillua në Francë, në datat 3 - 4 Dhjetor 2018.

Aktivite të tjera ndërkombëtare

Trajnim me temë: “*Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i veprave penale që lidhen me kontrollin oficer i policisë gjyqësore*”, i organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë i zhvilluar në datat 25 - 27 Qershor 2018 në Valletta, Maltë (1 Prokuror pjesëmarrës);

Trajnim me temë “*Monedhat virtuale*”, i organizuar nga Zyra për Programin e Krimit Kibernetik në Këshillin e Europës (C-PROC), në kuadër të Projektit iPROCEEDS dhe në bashkëpunim me Kolegjin Ndërkombëtar të Hetimit Financiar (ICOFI) – Qendra e Trajnimeve Ndërkombëtare i zhvilluar në datat 5 - 7 Nëntor 2018 në Budapest, Hungari (1 prokuror pjesëmarrës);

Konferencë me temë “*Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në çështjet e krimit kibernetik*” i zhvilluar në datat 7 - 8 Mars 2018 në Hagë, Hollandë, (1 prokuror pjesëmarrës);

Trajnim vazhdues: “*Ballkani – Një qasje tjetër për bashkëpunimin ndërkombëtar në Sektorin e Drejtësisë*” i zhvilluar në datën 17 Prill 2018 në Sarajevo, Bosnje-Herzegovinë (1 prokuror dhe 1 oficer i policisë gjyqësore pjesëmarrës);

Dialog Strategjik Rajonal për tregtinë e paligjshme në Europën Juglindore, i organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Sirakuzës për Drejtësinë Penale dhe të Drejtat e Njeriut zhvilluar në datat 5 - 6 Dhjetor 2018 në Sirakuza, Itali. Dialogu Strategjik Rajonal ka si qëllim të bashkojë Ministrat dhe zyrtarë të lartë nga mbarë Europa Juglindore për të diskutuar sfidat e përbashkëta dhe mundësitë strategjike në luftën kundër tregtisë së paligjshme. (1 prokuror pjesëmarrës);

Takim ndërmjet përfaqësuesve të Institucioneve Shqiptare dhe ekspertëve të Komitetit MONEYVAL zhvilluar si sesion raportues në datat 20 - 22 Mars 2018 në Strasburg, Francë. (3 prokurorë pjesëmarrës);

Vizitë studimore Peer-to-peer mbi praktikat dhe standardet për recuperimin e aseteve, e organizuar nga Projekti Rajonal Anti-Korrupsion (RAI) dhe Këshillit për të drejtat individuale në Europë, me mbështetjen e Zyrës së Punëve të Jashtme dhe Komonuelthit, si dhe Fondacionit Konrad Adenauer zhvilluar në datat 4 - 6 Dhjetor 2018 në Bukuresht, Rumani. (1 prokuror pjesëmarrës);

Samiti Ndërkombëtar kundër Trafikimit të Personave, Skllavërisë Moderne, Krimin të organizuar dhe Shfrytëzimit për Punë në Europë u zhvillua në datat 21 - 23 Shkurt 2018 në Londër, Mbretëri e Bashkuar;

Vizitë studimore e organizuar nga Zyra e Bashkimit European për Zgjerimin, TAIEX Instrument, me temë “*Mbi sistemin e menaxhimit të çështjeve në Prokurori*” zhvilluar në datat 9 - 10 Janar 2018 në Talin, Estoni. (3 specialistë IT pjesëmarrës);

Konferenca e Ekspertëve dhe Ndërministriale për mobilizimin kundër financimit të terrorizmit, e cila u mbajt në Selinë e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik në datë 25 Prill 2018 në Paris, Francë, (2 prokurorë pjesëmarrës);

Vizitë studimore e organizuar nga Zyra e Bashkimit European në datat 17 - 18 Prill 2018 në Strasburg, Francë, me temë: “*Forcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe median në Europën Juglindore*”. (1 prokuror pjesëmarrës);

Takimi i 156^{të} i Grupit të Punës Juglindor mbi luftën kundër Trafikimit të Drogës, i organizuar me mbështetjen e Zyrës së Policisë Kriminale të Bavarisë (BKLA) dhe Seksionit të Luftës kundër Drogës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (DEA) u zhvillua në datat 18 - 20 Shtator 2018, në Furth/Gjermani. (1 prokuror pjesëmarrës);

Trajnimi i organizuar nga UNODC në dy sesione, përkatësisht në datat 24-25 Shtator dhe 24-27 Shtator, me temë “*Matja dhe vlerësimi i krimin të organizuar në Ballkanin Perëndimor: treguesit mbështetës – bazuar në politikëbërje*” u zhvillua në datat 24 - 27

Shtator 2018 në Becici, Mali i Zi. (1 oficer i policisë gjyqësore dhe 1 specialiste statistike pjesëmarrës);

Në datat 27 - 28 Shtator 2018 në Bruksel, Belgjikë u zhvillua takimi shpjegues në kuadër të procesit screening për Kapitullin negociues 23 të MSA-së *“Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore të Njeriut”*. (2 prokurorë dhe 1 oficer i policisë gjyqësore pjesëmarrës);

Forumi Rajonal për mashtrimin online, i organizuar nga Zyra për Programin e Krimit Kibernetik në Këshillin e Europës në bashkëpunim me Akademinë Gjyqësore për Krimin Kibernetik të Republikës së Kroacisë u zhvillua në datat 4 - 5 Tetor 2018 në Zagreb, Kroaci. (1 prokuror pjesëmarrës);

Një delegacion me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme zhvilluan një vizitë zyrtare në Mbretërinë e Hollandës, me qëllim njohjen dhe diskutimin nga afër të sfidave të krimit të organizuar, azilkërkimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore si dhe bashkëpunimi i autoriteteve qendrore dhe lokale. Vizitat u zhvilluan në Amsterdam, Rotterdam, Hagë, etj.. në datat 7 – 8 Shkurt 2018. (1 prokuror pjesëmarrës);

Në kuadër të Projektit të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, të titulluar *“Mbështetja e Mbretërisë së Bashkuar ndaj Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri dhe institucioneve të tjera përkatëse për implementimin më të mirë të Marrëveshjes dypalëshe për Transferimin e Personave të Dënuar”* u zhvillua një vizitë studimore në datat 20 – 24 Shkurt 2018, në Londër, Mbretëri e Bashkuar. (3 prokurorë pjesëmarrës dhe 1 oficer i policisë gjyqësore);

Simpoziumi ndërkombëtar me temë *“Përvjetori i 150-të i Gjykatës së Kasacionit”*, ku ishin ftuar të marrin pjesë kryetarët e Gjykatave të Larta dhe Prokurorët e Përgjithshëm të vendeve të ndryshme u zhvillua në datat 6 – 7 Mars 2018, në Ankara, Turqi, u zhvillua. Në këtë aktivitet mori pjese një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme;

Seminar me përfaqësues të Shoqatave të Prokurorëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor i zhvilluar në datat 13 – 14 Mars 2018, në Shkup, Maqedoni. Ky aktivitet u organizua nga Shoqata e Prokurorëve të Maqedonisë me mbështetjen e GIZ. (1 Prokuror pjesëmarrës);

Një delegacion me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme zhvilluan Në datat 21 Maj – 24 Maj 2018 një vizitë zyrtare në Mbretërinë e Hollandës, në kuadër të Reformës në Drejtësi në Shqipëri dhe kontributit Hollandë/BE. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Brendshëm do të parashtrojnë sukseset dhe sfidat e Shqipërisë në çuarjen përpara të axhendës së reformës në drejtësi. Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte të diskutohej mbi reformën në drejtësi duke pasur parasysh

përqasjen me kapitujt 23 dhe 24 të Aquis të BE. Takimet u zhvilluan kryesisht në Hagë dhe Rotterdam Kroaci. (1 prokuror pjesëmarrës);

Konferencë “*Projekti i Bashkëpunimit 2*”, financuar nga OLAF, në kuadër të Programit HERCULE III, si një iniciativë anti-mashtim e Komitetit për Parandalimin e Mashtimit në BE dhe Guardia di Finanza u zhvillua në datat 7 – 8 Qershor 2018, në Romë, Itali Kroaci. (1 prokuror pjesëmarrës);

Seminar Rajonal me temë “*Lufta ndaj terrorizmit dhe radikalizimi në Evropën Juglindore*”, i organizuar nga Atasheu Policor për Kroacinë pranë Ambasadës Franceze në Republikën e Kroacisë, Koordinatori Rajonal për Ballkanin Perëndimor, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe gjithashtu organizatave ndërkombëtare u zhvillua në datat 19 – 20 Qershor 2018, në Podgoricë, Mali i Zi. (1 prokuror pjesëmarrës);

Takim ekspertësh mbi grupet e krimit të organizuar me qëllim shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet prokurorëve dhe hetuesve i zhvilluar në datë 20 Qershor 2018, në Bruksel, Mbretëri e Belgjikës. Një nga çështjet me interes ishte kthimi i aseteve dhe eksperiencia me pastrimin e parave në Shqipëri nga këndvështrimi i prokurorëve. (1 prokuror pjesëmarrës);

Konferenca e Krimit Kibernetik në datat 18 – 20 Shtator 2018, në Singapor organizuar nga Europol dhe Inteprol, në kuadër të Projektit iPROCEEDS, që ka si objektiv produktet e veprës penale nga Interneti në Evropën Juglindore dhe Turqi;

Programi i Trajnimit Ndërkombëtar mbi *Dhunën me Bazë Gjinore* u zhvillua në datat 12 – 22 Nëntor 2018, në Vienë, Austri, aktiviteti i cili organizohej nga Autoriteti Suedez Policor në bashkëpunim me Fondacionin Kvinna till Kvinna dhe financohej nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit (SIDA). (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktiviteti me temë “*Ushttrim simulimi i një çështjeje rajonale lidhur me hetimet financiare dhe të krimit kompjuterik (Regional case simulation exercise on cybercrime and financial investigations)*” u organizua nga Zyra e Programit të Krimit Kompjuterik të Këshillit të Evropës, në kuadër të Projektit iPROCEEDS në datat 12 – 15 Nëntor 2018, në Bukuresht, Rumania. (1 prokuror pjesëmarrës);

Takimi i 20-të Plenar mbi Komitetin për Konventën e Krimit Kibernetik (T-CY) në datat 27 – 29 Nëntor 2018, në Strasburg, Francë, (T-CY përfaqëson shtetet anëtare palë në Konventën e Budapestit mbi Krimin Kibernetik). Bazuar në nenin 46 të Konventës së Budapestit, konsultimi i Komitetit ka si qëllim përdorimin dhe implementimin efektiv të Konventës, shkëmbimin e informacionit dhe marrjen në konsideratë të amendamenteve të ardhshme. (1 prokuror pjesëmarrës);

Projekti për shënjestrimin e të ardhurave nga krimi në internet në Evropën Juglindore dhe në Turqi organizoi një Takim rajonal me temë: *“Bashkëpunimi ndërkombëtar në krimin kibernetik dhe provat elektronike”* në datat 3-4 Maj 2018, në Kiev, Ukrainë. (1 prokuror pjesëmarrës);

Një delegacion shqiptar mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në datat 24 - 25 Maj 2018, në Gjenevë, Zvicër, për shqyrtimin e Raportit mbi zbatimin e Konventës së OKB-së *“Për zhdukjet me Forcë”*. (1 prokuror pjesëmarrës);

Takim bilateral me temë *“Prezantimi i urdhërrëfyesit për qeverisje të mirë për institucionet e Shipërisë dhe Kosovës”* i zhvilluar në datat 5 - 6 Dhjetor 2018 në qytetin e Prishtinës, Kosovë. (1 specialiste pjesëmarrëse);

Trajnim me temë *“Hetimi i trafikimit të armëve të zjarrit dhe lidhjet e tij me format e tjera të krimit të organizuar”* i zhvilluar në datat 4 - 5 Dhjetor 2018, në Vjenë, Austri. (1 prokuror pjesëmarrës);

Seminar rajonal në datat 20 -21 Nëntor 2018, në Athinë, Greqi, me objektiva operacionale me temë *“Lufta kundër trafikut të drogave në vendet e Ballkanit Perëndimor”*, i organizuar nga Atasheu i Sigurisë së Brëndshme pranë Ambasadës Franceze në Greqi. (1 prokuror pjesëmarrës);

Aktivitet trajnues në datat 26 - 28 Nëntor 2018, në Paris, Francë, i organizuar nga UNESCO dhe Bashkimi Evropian me temë *“Trajnimi i gjyqtarëve evropian dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pronës kulturore.”* (1 prokuror pjesëmarrës);

Seminari rajonal me temë *“Lufta kundër trafikut të armëve dhe eksplozivëve në vendet e Ballkanit perëndimor”* i zhvilluar në datat 2 - 3 Tetor 2018, në Shkup, Maqedoni. (1 prokuror pjesëmarrës);

Konferencë Rajonale në kuadër të Projektit të BE-së *“Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale: Forcimi i Mbrojtjes së Dëshmitarëve në Luftën kundër Krimit të Organizuar, Terrorizmit dhe Korrupsionit”* i zhvilluar në datën 12 Shtator 2018, në Shkup, Maqedoni. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Trajnim me temë *“Identifikimi i Sfidave dhe Shkëmbimi i Praktikave të Mira në Hetimin dhe Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Armëve të Zjarrit Kundër Trafikimit”* u zhvillua në datat 29 - 30 Maj 2018, në Vjenë, Austri. (1 prokuror pjesëmarrës);

Vizitë studimore me temë “*Bashkëpunimi Operacional në lidhje me kërcënimin e armëve të zjarrit*”, i organizuar nga TAIEX në datat 5 – 6 Qershor 2018, në Shkup, Maqedoni. (1 prokuror pjesëmarrës);

Forumi Rajonal mbi Bashkepunimin Penal Gjyqesor, Instrumentet, Standartet dhe Praktika, i zhvilluar në datat 5-7 Dhjetor 2018, në Mal të Zi. (1 oficer i policisë gjyqësore pjesëmarrës);

Takimi shpjegues në kuadër të procesit screening për Kapitullin negociues 24 të MSA-së “*Drejtësia, Liria dhe Siguria*” në datat 12 - 14 Nentor 2018 në Bruksel, Belgjikë. (1 prokuror dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore pjesëmarrës);

Në datë 26 Korrik 2018, në Bari/Itali u zhvillua një takim dypalësh midis Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe homologëve italiane të Prokurorisë pranë Gjykatës së Barit/Itali Seksionit DDA, me qëllim nënshkrimin e një marrëveshje për krijimin e një skuadre të përbashkët hetimore. (3 prokurorë dhe 1 oficer i policisë gjyqësore pjesëmarrës);

Takimi i 156 i Grupit të Punës Juglindor mbi luftën kundër Trafikimit të Drogës, me mbështetjen e Zyrës së Policisë Kriminale të Bavarisë (BKLA) dhe Seksionit të Luftës Kundër Drogës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (DEA) i zhvilluar në datat 18-20 Shtator 2018, në Furth/Gjermani. (1 prokuror pjesëmarrës);

Në datat 2 - 6 Korrik 2018, në Strasburg, Francë, një delegacion shqiptar mori pjesë gjatë diskutimit të Raportit të Vlerësimit të Shqipërisë në Seancën Plenare të Komitetit të Moneyval. (2 prokurorë pjesëmarrës);

Takim me përfaqësues të Prokurorisë Shqiptare në datë 9 Janar 2018, në Bukuresht, Rumani, pranë Drejtorisë së Shërbimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit, organizuar nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme Rumune. (3 prokurorë pjesëmarrës).